

Majlinda Ziu



LIBËR PËR MËSUESIN

Gjeografia

12

pegi

Majlinda Ziu

**LIBËR PËR MËSUESIN
GJEOGRAFIA 12
(bërthamë)**



Shtëpia botuese & shtypshkronja



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara © Pegi 2011

Të gjitha të drejtat lidhur me këtë botim janë ekskluzivisht të zotëruara nga shtëpia botuese "Pegi" sh.p.k. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar pjesërisht ose tërësisht pa miratimin paraprak nga botuesi.

Shtëpia botuese: Tel: 042 374 947 cel: 069 40 075 02 pegi@icc-al.org

Sektori i shpërndarjes: Tel/Fax: 048 810 177 Cel: 069 20 267 73

Shtypshkronja: Tel: 048 810 179 Cel: 069 40 075 01 shtypshkronjapegi@yahoo.com

PËRMBAJTJA

I. Çfarë na kërkon programi i lëndës?.....	5
II. Plani mësimor i lëndës Gjeografia 12.....	7
III. Harta e koncepteve.....	17
IV. Përsëritje.....	79
V. Disa modele pyetjesh që mund të përdoren gjatë minitesteve ose në testimet e kapitujve.....	84

I. ÇFARË NA KËRKON PROGRAMI I LËNDËS?

Programi i lëndës **Gjeografia e Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare** realizohet në 68 orë mësimore vjetore, prej të cilave afërsisht **70%** e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e **njohurive të reja lëndore** dhe **30%** e tyre janë për **përpunimin e njohurive** (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- Punët praktike;
- Vëzhgimet në terren;
- Përsëritjen brenda një kapitulli ose më tepër, të njohurive-bazë të tij (konceptet themelore);
- Testimin e njohurive-bazë;

Format, metodat, strategjitë dhe teknikat e të mësuarit duhet të jenë të shumta e të larmishme. Ato zgjidhen në përshtatje me përmbajtjen lëndore, por dhe me nivelin e nxënësve, gjendjen e bazës didaktike etj. Gjatë orëve të ndryshme të mësimit në lëndën Gjeografia e Republikës së Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare, vëmendja e veçantë e mësuesit duhet drejtuar te lidhja organike e metodave të veçanta që ai përdor brenda një ore mësimi. Mësues/i,-ja mund të përdorë metoda të cilat janë të efektshme për të krijuar aftësi dhe qëndrime gjatë përpunimit të njohurive, të tilla si:

- Diskutimi në klasë
- Debati
- Projektet në grupe
- Ekskursioni
- Eseja,
- Etj...

Punët praktike dhe projektet kurrikulare lëndore

Meqenëse punët praktike janë pjesë e programit dhe kanë rëndësi të veçantë për realizimin me sukses të tij, rreth 8% e orëve të përgjithshme të planifikuara në klasë, u lihen këtyre veprimtarive. Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë *detyra tematike* dhe *projekte kurrikulare* (me karakter individual ose grupi) dhe për realizimin e tyre, nxënësit kanë mundësi të përdorin teknologjinë, në mënyrë të veçantë pajisjet dhe kompjuterat.

Vlerësimi

Vlerësimi i nivelit dhe cilësisë së arritjes së objektivave të përmbajtjes lëndore nga nxënësit mund të bëhet:

- *sistematik* (për çdo temë mësimore);
- *periodik* (në përfundim të çdo kapitulli ose me shumë kapituj);
- *semestral dhe vjetor*.

Ai mund të jetë përmbledhës ose formues, i planifikuar që në fillim të vitit ose i rastësishëm, në varësi të problemeve në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve. Vlerësimi mund të jetë: *vlerësim me gojë* dhe *vlerësim me shkrim* (përmes veprimtarisë praktike, testimit, eseve, projekteve etj).

II. PLANI MËSIMOR I LËNDËS “GJEOGRAFI 12”

SYNIMI I LËNDËS “GJEOGRAFI 12”

Programi i lëndës Gjeografia e Republikës së Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare synon që nxënës/i-ja:

- të fitojë njohuri mbi diversitetin natyror dhe human të trevave shqiptare; veçoritë natyrore, social-ekonomike, kulturore e mjedisore të rajoneve dhe ndërveprimin midis tyre;
- të zhvillojë aftësi për të parashikuar perspektivën e zhvillimit të trevave shqiptare dhe të bashkëpunimit midis tyre, si dhe bashkëpunimin e integrimin në nivel rajonal, evropian e global.

OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Në përfundim të këtij programi, nxënës/i, -ja do:

- të analizojë e vlerësojë modelet dhe diversitetin e sistemeve natyrore dhe humane të trevave shqiptare; faktorët, kushtet, shkaqet që kanë kushtëzuar këto modele dhe diversitete;
- të vlerësojë lidhjet dhe marrëdhëniet ekonomike, kulturore dhe mjedisore ndërmjet trevave shqiptare dhe vendeve ku ato ndodhen, me Bashkimin Evropian dhe vende të tjera të botës;
- të shpjegojë ndikimin e zhvillimeve aktuale globale në botën shqiptare;
- të përcaktojë dallimet rajonale, duke përdorur konceptet rajon, nënrajon, zonë, etj;
- të përdorë metodat dhe mjetet e kërkimit gjeografik për mbledhjen, vlerësimin, organizimin dhe interpretimin e informacionit;
- të zhvillojë, përmes studimit të gjeografisë kombëtare, aftësitë qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre për në jetë, në punë dhe në shoqëri.

PROGRAMI SINTETIK

34 javë x 2 orë = 68 orë

Njohuri të reja - 49 orë

Punë praktike - 5 orë

Përsëritje - 4 orë

Projekte kurrikulare - 7 orë

Teste - 3 orë

Nr	Linja	Objektiva të linjës	Blloku tematik	Nr	Tema
1.	I. Vendndodhja gjeografike (4 orë)	Në përfundim të kësaj linje, nxënësi/ja do të jetë i/e aftë: Objektiva minimale: - të përshkruajë objektin e studimit të Gjeografisë 12, vendin që ajo zë në studimet gjeografike dhe rëndësinë e studimit të saj; - të diferencojë përbërjen e trevave shqiptare (Republika e Shqipërisë, Kosova, trevat shqiptare në Serbi, në Maqedoni, në Greqi dhe në Malin e Zi). Objektiva mesatare: - të evidentojë pozitën gjeografike të trevave shqiptare në Ballkan, Mesdhe, Evropë dhe më gjerë; - të vlerësojë rolin e kësaj pozite në veçoritë natyrore gjeografike, në popullimin e trevave dhe zhvillimin ekonomik, dhe pasojat e kësaj pozite në copëtimin e trevave shqiptare; Objektiva maksimale: - të analizojë ndryshimet që ka pësuar në kohë dhe në hapësirë harta politike e trevave shqiptare; - të realizojë një projekt kërkimor me karakter krahasues mbi ndryshimet në kohë të hartës politike të trevave shqiptare.	I. Hapësira gjeografike e trevave shqiptare (4 orë) Njohuri të reja: 3 orë Projekt: 1 orë	1. 2. 3. 4.	Objekti i gjeografisë së trevave shqiptare dhe rëndësia e studimit të saj Pozita gjeografike dhe përbërja e trevave shqiptare Harta politike e trevave shqiptare Projekt- Tema: Ndryshimet e hartës politike të trevave shqiptare

5.	II. Sistemet fizike (14 orë)	<p>Në përfundim të kësaj linje, nxënësi/ja do të jetë i/e aftë:</p> <p>Objektiva minimale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë varietetin e peizazheve dhe hartën e mozaikut të tyre; - të përshkruajë raportin njeri-mjedis në peizazhet e larmishme të trevave shqiptare (peizazh lumor, malor, fushor, kodrinor, karstik dhe bregdetar); - të identifikojë pasurinë e madhe hidrografike të trevave shqiptare; <p>Objektiva mesatare:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të evidentojë tiparet kryesore të klimës së trevave shqiptare; - të evidentojë faktorët e formimit të relievit, sistemet kryesore të tij; - të evidentojë kushtet dhe faktorët e formimit të tokave të larmishme të trevave shqiptare; - të evidentojë larminë e botës së gjallë të trevave shqiptare; <p>Objektiva maksimale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë etapat e formimit të truallit të trevave shqiptare, përbërjen litologjike e strukturore të tij dhe rolin e tyre në pasuritë e shumta minerare; - të analizojë faktorët e kushtet që kanë ndikuar në shkallën e lartë të degradimit, shkretrimit dhe përmbytjeve të tokave si dhe pasojat e tyre; 	II. Diversiteti i mjediseve dhe peizazheve të trevave shqiptare Njohuri të reja: 11 orë Përsëritje: 1 orë Projekt: 1 orë Testim: 1 orë	<p>1. Pozita gjeologjike dhe përbërja gjeologjike e trevave shqiptare</p> <p>2. Rezervat minerare të trevave shqiptare</p> <p>3. Relievi i trevave shqiptare</p> <p>4. Morfologjia e relievit të trevave shqiptare</p> <p>5. Tiparet e klimës së trevave shqiptare dhe faktorët që i përcaktojnë ato</p> <p>6. Rajonizimi klimatik i trevave shqiptare</p> <p>7. Hidrografia e trevave shqiptare. Detet dhe liqenet</p> <p>8. Lumenjtë e trevave shqiptare</p> <p>9. Ujërat nëntokësorë dhe burimet</p> <p>10. Llojet e tokave</p> <p>11. Bota bimore dhe shtazore e trevave shqiptare</p>
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				
11.				
12.				
13.				
14.				
15.				

Nr	Linja	Objektiva të linjës	Blloku tematik	Nr	Tema
16.	II. Sistemet fizike (14 orë)	të vlerësojë rolin dhe ndikimin e klimës në dukuritë e tjera natyrore, në shpërndarjen e popullsisë dhe aktivitetet e saj; - të vlerësojë rëndësinë jetësore dhe ekonomike të pasurive hidrike të trevave shqiptare; - të analizojë faktorët dhe kushtet që kanë përcaktuar pasurinë e madhe bimore dhe shtazore të trevave shqiptare; - të vlerësojë përmes një projekti në grup larminë dhe pasurinë e madhe natyrore të trevave shqiptare (si p.sh. relievin, klimën, hidrografinë, etj).		12.	Projekt 2 - Tema: Pasuria e madhe natyrore e trevave shqiptare
17.				13.	Përsëritje 1 - Tema: Hapësira gjeografike e trevave shqiptare dhe kushtet natyrore të tyre
18.				14.	Testim 1 - Tema: Hapësira gjeografike e trevave shqiptare dhe kushtet natyrore të tyre
19.				1.	III.1. Organizimi administrativ i trevave shqiptare Njohuri të reja:1 orë

20.	<p>- të përshkruajë elementët (karakteristikat) kryesore demografike të popullsisë së trevave shqiptare (numri i popullsisë, shtimi natyror, struktura e popullsisë);</p> <p>Objektiva mesatare:</p> <p>- të evidentojë ndryshimet në organizimet administrativo-tokësore në Republikën e Shqipërisë, në Republikën e Kosovës dhe në trevat e tjera shqiptare; - të evidentojë territoret ku kanë migruar shqiptarët me veçoritë dhe problemet e integritetit të tyre; - të diskutojë mbi elementë të identitetit kombëtar të trevave shqiptare (gjuha, toleranca fetare, marrëdhëniet ndëretnike);</p> <p>Objektiva maksimalë:</p> <p>- të analizojë organizimin e sotëm politiko-administrativ të trevave shqiptare; - të argumentojë ndikimin e organizimit të sotëm politiko-administrativ të trevave shqiptare në zhvillimin dhe integritetin rajonal dhe evropian të tyre. - të analizojë kushtet dhe faktorët që kanë ndikuar në popullimin e trevave shqiptare; - të analizojë procesin e migrimit si promotorin e të gjitha ndryshimeve demografike të popullsisë shqiptare, duke u ndalur në periudhën pas vitit 1990; - të analizojë ecurinë e zhvillimit të popullsisë dhe vendbanimeve në trevat shqiptare, përmes treguesve statistikore, grafikë, etj.</p>	<p>III.2</p> <p>Popullsia dhe vendbanimet Njohuri të reja:3 orë</p>	<p>1.</p>	<p>Historiku i popullimit dhe ndryshimet demografike të trevave shqiptare</p>	
21.				<p>2.</p>	<p>Migrimet e popullsisë. Shkaqet dhe pasojat e tyre në trevat shqiptare</p>
22.				<p>3.</p>	<p>Struktura e vendbanimeve në trevat shqiptare</p>
23.			<p>III.3</p> <p>Ekonomia e trevave shqiptare</p>	<p>1.</p>	<p>Kushtet e zhvillimit ekonomik të trevave shqiptare</p>
24.				<p>2.</p>	<p>Ekonomia e trevave shqiptare</p>
25.		<p>Njohuri të reja:2 orë</p> <p>Projekt: 1 orë</p>	<p>3.</p>	<p>Projekt 3 - Tema: Zhvillimi ekonomik, problematikat e zhvillimit dhe perspektiva e trevave shqiptare drejt integritetit evropian</p>	

Nr	Linja	Objektiva të linjës	Biloku tematik	Nr	Tema
26.	IV. Ndërveprimi njeri/mjedis (7 orë)	<p>Objektiva minimale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të identifikojë vlerat natyrore dhe historiko-kulturore të trevave shqiptare; - të veçojë disa nga sitet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore kombëtare (përfshirë ato që janë pjesë e trashëgimisë botërore) të trevave shqiptare; - të identifikojë potencialet turistike dhe zonat më të rëndësishme turistike; <p>Objektiva mesatare:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të evidentojë vlerat natyrore dhe historiko-kulturore të trevave shqiptare, në varësi me veçoritë e specifikat e tyre; -të evidentojë gjendjen aktuale dhe mundësitë për zhvillimin e ardhshëm të turizmit si dhe gjendjen e mjedisit në trevat shqiptare; - të evidentojë disa site të trashëgimisë natyrore e kulturore shqiptare; <p>Objektiva maksimale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë vlerat natyrore dhe historiko-kulturore të trevave shqiptare, në varësi me veçoritë e specifikat e tyre; - të veçojë disa nga sitet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore kombëtare (përfshirë ato që janë pjesë e trashëgimisë botërore) të trevave shqiptare; - të vlerësojë rëndësinë e pasurisë natyrore dhe kulturore të trevave shqiptare për zhvillimin turistik të tyre, gjendjen aktuale dhe mundësitë për zhvillimin e ardhshëm të turizmit; - të evidentojë faktorët dhe pasojat e problemeve mjedisore kryesore sot (ndotja e ajrit, ujit, tokës); - të parashikojë rrugë të menaxhimit efektiv të këtyre problemeve mjedisore; - të hartojë një plan veprimi për zgjidhjen e problemeve mjedisore të një zone informale në qytetin ku banon ose për qytete të tjera të vendit me problematika të spikatura mjedisore; 	<p>IV. Mjedisi dhe turizmi i trevave shqiptare</p> <p>Njohuri të reja:3 orë</p> <p>Përsëritje: 1 orë</p> <p>Projekt: 2 orë</p> <p>Testim: 1 orë</p>	1.	Trashëgimia natyrore e trevave shqiptare
27.				2.	Trashëgimia kulturore e trevave shqiptare
28.				3.	Projekt 4 - Tema: Trashëgimia natyrore dhe kulturore e trevave shqiptare në favor të zhvillimit të tyre
29.				4.	Mjedisi i trevave shqiptare dhe problemet e tij mjedisore
30.				5.	Projekt 5 - Tema: Problemet mjedisore në hapësirën e banimit dhe rrugët e zgjidhjes së tyre
31.				6.	Përsëritje 2 - Tema: Sistemet humane dhe ndërveprimi shoqëri-mjedis
32.				7.	Testim 2 - Tema: Sistemet humane dhe ndërveprimi shoqëri-mjedis

33.	V. Rajonet gjeografike (36 orë)	Në përfundim të kësaj linje, nxënësi/ja do të jetë i/e aftë: Objektiva minimale: - të evidentojë ndarjen rajonale të trevave shqiptare dhe tipat e rajoneve. - të përcaktojë pozitën gjeografike të Rajonit: Verior/Verilindor, Juglindor, Jugor dhe Perëndimor - të përshkruajë veçoritë kryesore natyrore të Rajonit: Verior/Verilindor, Juglindor, Jugor dhe Perëndimor dhe ofertat potenciale natyrore që ato ofrojnë për zhvillim; - të përshkruajë veçoritë kryesore të popullimit dhe të aktivitetit aktual ekonomik të këtyre rajoneve; - të identifikojë trashëgiminë natyrore dhe kulturore të secilit prej rajoneve Objektiva mesatarë: - të evidentojë tiparet specifike të Republikës së Shqipërisë dhe rajonet gjeografikë të saj; - të evidentojë karakteristikat kryesore të kushteve natyrore, të popullimit dhe të zhvillimit ekonomik të katër rajoneve të Republikës së Shqipërisë; - të evidentojë akset dhe drejtimet e zhvillimit të ardhshëm të Republikës së Shqipërisë me shanset dhe mundësitë që ofron ajo për integrim rajonal dhe evropian. - të përcaktojë tiparet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit për qëllime turistike, etj; - të analizojë tendencën e ndryshimeve demografike të Rajonit Verior/Verilindor, me problematikat që e shoqërojnë;	V.1 Republika e Shqipërisë (24 orë) Njohuri të reja: 17 orë Punë praktike: 4 orë Projekt: 1 orë Përsëritje: 1 orë Testim: 1 orë	1. Vecoritë fiziko-gjeografike të Republikës së Shqipërisë 2. Popullsia në Republikën e Shqipërisë 3. Ekonomia e Republikës së Shqipërisë 4. Rajoni verior dhe verilindor i Republikës së Shqipërisë 5. Popullimi dhe ekonomia në Alpet Shqiptare 6. Nënrajonit verilindor 7. Disa njësi përbërëse të nënrajonit verilindor 8. Njësitë e tjera përbërëse të nënrajonit verilindor 9. Punë Praktike Nr 1- Tema: Rajoni Verior dhe Verilindor i Republikës së Shqipërisë 10. Pozita gjeografike, kushtet natyrore dhe njësitë e rajonit juglindor 11. Popullimi i rajonit juglindor
34.				
35.				
36.				
37.				
38.				
39.				
40.				
41.				
42.				
43.				

Nr	Linja	Objektiva të linjës	Blloku tematik	Nr	Tema
44.		- të evidentojë procesin e urbanizimit në RSH (për të gjitha rajonet), sidomos urbanizimin e shpejtë të Rajonit Perëndimor dhe rrjedhojat e tij;		12.	Ekonomia e rajonit juglindor
45.		Objektiva maksimale:		13.	Punë Praktike Nr 2- Tema: Rajoni Juglindor i Republikës së Shqipërisë
46.		- të analizojë tiparet specifike natyrore, demografike dhe ekonomike që dallojnë Republikën e Shqipërisë nga trevat e tjera shqiptare, faktorët e diferencimit të saj rajonal dhe rajonet geografikë; - të vlerësojë akset dhe drejtimet e zhvillimit të ardhshëm të Republikës së Shqipërisë me shanset dhe mundësitë që ofron ajo për integrim rajonal dhe evropian.		14.	Pozita gjeografike, kushtet natyrore dhe njësitë e rajonit jugor
47.				15.	Popullimi i rajonit jugor
48.		- të analizojë tendencën e ndryshimeve demografike të rajoneve, me problematikat që e shoqërojnë;		16.	Ekonomia e rajonit jugor
49.		- të analizojë urbanizimin e shpejtë të Rajonit Perëndimor dhe rrjedhojat e tij; - të vlerësojë diversitetin e hapësirave të prodhimit bujqësor e industrial, sektorit terciar, rrjetin e transportit dhe rolin e tij në prirjen e organizimit të ri hapësinor të rajoneve; - të vlerësojë trashëgiminë natyrore dhe kulturore të rajoneve për qëllime turistike, etj; -		17.	Punë Praktike Nr 3 - Tema: Rajoni Jugor i Republikës së Shqipërisë
50.				18.	Pozita gjeografike, kushtet natyrore dhe njësitë e rajonit perëndimor
51.				19.	Popullimi në rajonin perëndimor
52.				20.	Ekonomia e rajonit perëndimor

53.				<p>Punë Praktike Nr 4 - Tema: Rajoni Perëndimor i Republikës së Shqipërisë</p>
54.	<p>- të parashikojë mundësitë e perspektivës së zhvillimit të rajoneve; - të realizojë në grup një deytërë tematike mbi mundësitë e zhvillimit ekonomik të RSH dhe të rrugëve nëpër të cilat ajo duhet të ndjekë për tu integruar në Evropë. Objektiva minimale: - të përshkruajë Republikën e Kosovës si një rajon gjeografik me kufi të qartë natyror dhe politik, veçoritë specifike fiziko-gjeografike, demografike dhe ekonomike të saj; Objektiva mesatarë: - të evidentojë veçoritë fiziko-gjeografike të Republikës së Kosovës dhe tiparet demografike dhe ekonomike të saj; - të evidentojë diferencimin rajonal dhe tiparet gjeografike natyrore, demografike dhe ekonomike të Rajonit Perëndimor dhe Lindor të Kosovës; Objektiva maksimale: - të analizojë veçoritë specifike fiziko-gjeografike, demografike dhe ekonomike të Republikës së Kosovës; - të analizojë tiparet gjeografike natyrore, demografike dhe ekonomike të Rajonit Perëndimor dhe Lindor të Kosovës; - të vlerësojë akset dhe drejtimet e zhvillimit të ardhshëm të Republikës së Kosovës me shanset dhe mundësitë që ofron ajo për integrim rajonal dhe evropian;</p>		21.	<p>Projekt 6 - Tema: Zhvillimi ekonomik i Republikës së Shqipërisë dhe rruga drejt integritimit evropian</p>
55.				<p>Përsëritje 3 - Tema: Republika e Shqipërisë</p>
56.				<p>Testim 3 - Tema: Republika e Shqipërisë</p>
57.		<p>V.2 Republika e Kosovës (5 orë)</p>	1.	<p>Pozita gjeografike dhe veçoritë fiziko- gjeografike të Republikës së Kosovës</p>
58.		<p>Njohuri të reja:5 orë</p>	2.	<p>Popullsia e Republikës së Kosovës</p>
59.			3.	<p>Ekonomia e Republikës së Kosovës</p>


Nr	Linja	Objektiva të linjës	Blloku tematik	Nr	Tema	
60.		<p>Objektiva minimale:</p> <p>- të përcaktojnë pozitën gjeografike të trevave shqiptare në Serbi, në Maqedoninë Perëndimore, në Mal të Zi dhe në Greqi, statusin e tyre politik, veçoritë e tyre specifike natyrore, demografike dhe ekonomike.</p> <p>Objektiva mesatare:</p> <p>- të evidentojë veçoritë fiziko-gjeografike, natyrën e kushtet e popullimit dhe të zhvillimit ekonomik të trevave shqiptare në Serbi, në Maqedoninë Perëndimore, në Mal të Zi dhe në Greqi.</p> <p>Objektiva mesatare:</p> <p>- të analizojë veçoritë fiziko-gjeografike, natyrën e kushtet e popullimit dhe të zhvillimit ekonomik të trevave shqiptare në Serbi, në Maqedoninë Perëndimore, në Mal të Zi dhe në Greqi.</p> <p>- të zhvillojë një projekt mbi zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës e të trevave të tjera shqiptare jashtë kufirit të Republikës së Shqipërisë dhe perspektivës së tyre drejt integritimit evropian</p>		4.	Rajonizimi i Republikës së Kosovës. Rajoni Perëndimor	
61.				5.	Rajoni lindor	
62.				V.3 Trevat e tjera shqiptare jashtë kufirit (7 orë)	1.	Trevat shqiptare në Serbi
63.					2.	Trevat shqiptare në pjesën perëndimore të Republikës së Maqedonisë
64.				Njohuri të reja:4 orë	3.	Trevat shqiptare në Mal të Zi
65.				Përsëritje: 1 orë	4.	Trevat shqiptare në Greqi
66.				Punë praktike: 1 orë	5.	Përsëritje 4 - Tema: Republika e Kosovës
67.			6.		Punë Praktike Nr 5 - Tema: Republika e Kosovës dhe trevat e tjera jashtë kufirit të Republikës së Shqipërisë	
68.			Projekt: 1 orë	7.	Projekt 7 - Tema: Zhvillimi ekonomik i Republikës së Kosovës dhe i trevave të tjera shqiptare jashtë kufirit të Republikës së Shqipërisë e perspektiva e tyre drejt integritimit evropian	

HARTAT E KONCEPTEVE

KREU: HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E TREVAVE SHQIPTARE

Linja I: Vendndodhja gjeografike

Tema: Objekti i gjeografisë së trevave shqiptare



Tema: Pozita gjeografike dhe përbërja e trevave shqiptare

Pozita gjeografike

Trevat shqiptare shtrihen në gjerësitë mesatare të Hemisferës Veriore. Ato ndodhen në Evropën Juglindore, të vendosura në perëndim të Gadishullit Ballkanik. Lartësitë e Alpeve Shqiptare të Mognës dhe të Kopaonikut, i krijojnë trevave një kufi natyror verior, ndërsa kufiri jugor i tyre shkon deri në gjirin e Ambrakisë. Kufirin perëndimor e përbëjnë brigjet e deteve Adriatik dhe Jon (që nga Tivari në veri e deri në Prevezë në jug), ndërsa atë lindor luginat e Moravës së Jugut dhe luginat e Vardarit.

Trevat shqiptare

Përbërja e trevave shqiptare

Në përbërje të trevave shqiptare hyjnë:

- Republika e Shqipërisë;
- Republika e Kosovës;
- Trevat shqiptare në Republikën e Malit të Zi: (Tivari, Ulqini, Tuzi, Plava, Gucia, Hoti, Gruda, Rozhaja, Kraja, Anamali, Shpuza);
- Trevat shqiptare në Republikën e Serbisë: (Presheva, Bujanovci dhe Medvegja);
- Trevat shqiptare në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë: (Kumanovë, Shkup, Tetovë, Gostivar, Dibër, Kërçovë, Strugë, Ohër, Manastir, etj.);
- Trevat shqiptare në Republikën e Greqisë: (Çamëria, Follorina, Kosturi, Grebenea, Konica etj.);

Roli i pozitës gjeografike

Rëndësi strategjike sepse:

-Lidhin Mesdheun Perëndimor me vendet e Ballkanit dhe të Azisë së Vogël, përmes daljes në Kanalin e Otrantos dhe të Korfuzit.

- Lehtësojnë lidhjen e pjesëve të brendshme të Ballkanit me Detin Adriatik përmes luginave lumore (Drin, Shkumbin, Vjosë, Fan, Lepenc, etj) që përshkojnë tërthor sipërfaqen e trevave

Rëndësi social-kulturore sepse:

trevat shqiptare që në lashtësi janë bërë pjesë e rëndësishme përbërëse e kulturës së hershme mesdhetare, me një kulturë unike.

I ka bërë trevat shqiptare si hapësira të këmbimit të kulturave të ndryshme dhe të ndikimit të disa elementëve kulturor midis vendeve.

Rëndësi ekonomike sepse: mundëson zhvillimin e disa degëve të ekonomisë. Ajo është e përshtatshme për kultivimin e shumë kulturave bujqësore, për të gjitha llojet e turizmit, për industrinë energjitike, peshkimin, tregtinë dhe të gjitha llojet e transportit. Përfshirja në projekte rajonale infrastrukturore, tregëtare dhe energjitike, sjell gjithashtu përfitime ekonomike edhe nga pozicioni tranzit në to.

Rëndësi nga pikëpamja natyrore

sepse: krijon kushte të favorshme e të përshtatshme për jetesë. Bëhen të pranishme: tiparet mesdhetare dhe kontinentale të klimës, të hidrografisë, të tokave, të botës bimore e shtazore etj.

Tema: Harta politike e trevave shqiptare

Harta politike e trevave shqiptare në kohën antike

Në kohën antike, pjesa perëndimore e Ballkanit banohej nga ilirët, një nga popujt më të mëdhenj të gadishullit.

Ilirët shtriheshin që nga lumi Sava në veri deri tek gjiri i Ambrakisë në jug dhe që nga rrjedhja e lumenjve Moravë e Vardar në lindje deri në brigjet e Adriatikut e Jonit në perëndim. Ata kishin formuar bashkësitë fisnore që në shekujt e parë të mijëvjeçarit të fundit para erës sonë.

Në shek. VI-V p.e.sonë në Ilirinë e Jugut lindin formacionet e para shtetërore, pra lindi dhe shteti ilir.

Pas një periudhe të gjatë lulëzimi, fuqizimi e luftërash, në vitin 168 para.e.sonë, shteti Ilir ra nën sundimin Romak dhe më pas u nda në katër provinca: Prevali, Dardania, Epiri i Ri dhe Epiri i Vjetër.

Harta politike e trevave shqiptare nga shek XIV- 1912

Në shek XV trevat shqiptare u ndanë në disa principata të drejtuara nga familjet e mëdha shqiptare: e Topiajve, e Balshajve, e Muzakajve, e Zenebishëve dhe e Shpatajve. Në mesin e shek. XIV, nisën sulmet osmane për pushtimin e viseve shqiptare dhe pas një shekulli qëndrese, trualli shqiptar ra nën sundimin e plotë osman. Ato u përfshinë në elajetin e Rumelisë dhe u ndanë në nëntë sanxhakë. Në vitet 60 të shek XV, u dallua për qëndresën kundër osmanëve, shteti i Skënderbeut. Në fundin e shek. XVIII e në fillimin e shek. XIX, filluan përpjekjet për shkëputjen e Shqipërisë nga sundimi osman dhe për formimin e një shteti shqiptar dhe në vitin 1912, u shpall Pavarësia e Shqipërisë.

Pse ka ndryshuar harta politike e trevave shqiptare?

Ndryshimet e herë pas herëshme, kanë ardhur si rezultat i ndikimit e i ndërthurjes së **faktorëve politikë dhe historiko-shoqërorë.**

Harta politike e trevave shqiptare gjatë shekujve V-XIV

Pas ndarjes së Perandorisë Romake, trevat iliro-shqiptare hynë në përbërje të Perandorisë Bizantine, gjatë sundimit të së cilës (në shek. IV-VII të e.s.) u prekën nga dyndjet e popujve. Gjatë këtij sundimi ato u ndanë mbi bazë themash (të Durrësit, të Nikopojës, të Dalmacisë e të Selanikut).

Në shek. XI- XII, u krijuan formacione autonome të fisnikëve shqiptarë ku u dallua më tepër formacioni shtetëror i Arbrit. Në shek. XIII, Shqipëri (Albania) dhe shqiptarë (Albanenses) quheshin trevat dhe popullsia që shtrihej nga kufijtë e Dioklesë (Gentës) në veri, deri në gjirin e Prevezës në jug.

Ndryshimet e hartës politike të trevave shqiptare në vitin 1913

Në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, u mor vendimi përfundimtar mbi kufijtë politikë të trevave shqiptare: që në atë moment e në vazhdim, mbetën jashtë kufijve të sotëm politikë të Shqipërisë gjysma e territoreve shqiptare. Ato u ndanë midis Ser-bisë, Malit të Zi e Greqisë.

Statusi i sotëm politik i trevave shqiptare dhe e ardhmja e tyre

Në 17 Shkurt 2008 Kosova u shpall republikë e pavarur, tashmë e njohur nga shumë shtete. Komunitat Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë, janë pjesë e Serbisë

Një pjesë tjetër e trevave shqiptare është pjesë e Republikës së Maqedonisë (pjesa perëndimore), pjesa tjetër në veri është pjesë Republikës së Malit të Zi dhe pjesa në jug, si pjesë e Republikës së Greqisë.


KREU: DIVERSITETI I MJEDISEVE DHE PEIZAZHEVE TË TREVAVE SHQIPTARE

Linja II: Sistemet fizike

Tema: Pozita gjeologjike dhe përbërja gjeologjike e trevave shqiptare

Pozita gjeologjike e trevave shqiptare

Trualli shqiptar i përket teknogenezës alpine dhe përbëhet nga struktura gjeologjike që quhen “*Albanide*”. Albanidet, bëjnë pjesë *në zonën mesdhetare të sistemit të rrudhosur alpin*. Ato përfaqësojnë një pjesë të *degëzimit jugor* të zonës mesdhetare të sistemit të rrudhosur alpin, pra janë një pjesë e nënnjesisë Apenino-Dinaride-Albanide-Helenide-Touride. Albanidet shtrihen në sektorin e brendshëm dhe *në sektorin e jashtëm të këtij degëzimi*. Ky pozicionim gjeologjik i trevave shqiptare, ka përcaktuar një ndërtim gjeologjik e strukturor të shumëllojshëm dhe prani të pasurive të shumta minerare. Strukturat e Albanideve u krijuan gjatë dy etapave kryesore, gjatë etapës *tektogjene* dhe gjatë etapës *orogjenike* ose *neoektonike*.



Tema: Rezervat minerare të trevave shqiptare

Bazuar në përdorimin industrial të tyre, *mineralet ndahen në lëndë të djegshme, minerale të dobishme metalore dhe minerale të dobishme jometalore*

Rezervat e lëndëve djegëse:
Rezervat e **gymyrgurit** gjenden në formë shtresash në konglomeratet dhe ranorët e oligocenit dhe miocenit (gjenden në: ultësirën ndërmllore Korçë-Gorë-Mokër, Memaliaj, etj).
Linjtet: rezervat e RSH, janë qymyre të cilësisë së ulët. Në Republikën e Kosovës, linjtë ka rëndësi energjike dhe gjenden në rezerva të mëdha, në fushëgropën e Kosovës dhe Rrafshin e Dukagjinit.
Torfat: janë grumbullime të krijuara në zona ish-kënetore, që përfshihen në grupin e qymyreve të dobët.
Asfalti: është një bitum natyror që gjendet në shtresa argjilore e ranore. Vendburimi më i vjetër i tij është ai i Selenicës. Rezervat e **naftës:** gjenden në RSH dhe lidhen me praninë e shkëmbinjve karbonatikë (Ballsh, Gorisht) dhe të shkëmbinjve ranorë (Kuçovë, Patos, Marinzë). Studime dhe kërkime po bëhen edhe në platformën detare të Detit Jon.
Gazi natyror gjendet kryesisht i shoqëruar me naftën, por në disa zona edhe i veçuar prej saj (në kodrat e Divjakës).

Rezervat e mineraleve të dobishme metalore
Xeherorët e **kromit** gjendet në shkëmbinjtë magmatikë ultrabazikë. Grumbullimet më të rëndësishme të këtij minerali janë në vendburimet e Bulqizës e të Batrës në RSH, ato në lindje të Republikës së Kosovës dhe në trevat tona në Maqedoni.
Rezervat e **bakrit** gjendet në shkëmbinj vullkanogjenosedimentarë. Janë të përhapur në zonën e Korabit dhe të Gashit në RSH.
Rezervat e **hekur-nikelit** gjendet në disa shkëmbinj metamorfikë, kryesisht në zonat juglindore të RSH, në disa zona në Republikën e Kosovës (Çikatovë-Magur, Carralevë) dhe në trevat tona në Maqedoni.
Boksitet kanë përhapje të kufizuar dhe lidhen me praninë e shkëmbinjve gëlqerorë. Gjenden kryesisht në zonën e Alpeve dhe të Vermoshit, në Republikën e Kosovës (Gremnik) dhe në Plavë.
Mineralet e zinkut të plumbit dhe argjendit gjenden në shkëmbinj magmatikë. Rezervat më të mëdha gjenden në disa zona në Republikës së Kosovës (sidomos në Trepçe).


Rezervat e mineraleve të dobishme jometalore
Rezervat e **asbestit**, janë të përhapur në shkëmbinjtë ultrabazikë. Gjenden në verilindje, lindje e juglindje të RSH dhe në Republikën e Kosovës. **Magneziti** formohet nga veprimtaria hidrotermale mbi shkëmbinjtë ultrabazikë. Gjendet në RSH (Gomsiqe, Devoll) dhe në Kosove (Goleshtë, Guri i Bardhë). **Squfuri** shoqëron vendburimet e bakrit. **Fosforiti** dhe **kripa e gurit** gjenden në shkëmbinj gëlqerorë, kryesisht në zonën Jonike. **Gipsi** gjendet në RSH (Dumre, Korab, Vlorë) dhe në trevat shqiptare në Maqedoni etj. **Argjilat** kanë përhapje të gjerë në treva. Dallohen vendburimet e RSH (Kavajë, Tiranë, Lushnjë) dhe të Kosovës (Gjakovë, Skënderaj, Klinë, Pejë Viti, etj). **Gëlqerorët** dhe **dolomitët**, përdoren si materiale ndërtimi dhe kanë përhapje të gjerë në trevat shqiptare. Rezerva të **mermerit** gjenden në disa vendburime të RSH (Muhur, Burrel, etj) dhe në trevat tona në Maqedoni. **Rëra e kuarcit** lidhet me shkëmbinjtë magmatikë. Është e përhapur në RSH dhe në Republikën e Kosovës (Ferizaj, Lipjanë).

Tema: Relievi i trevave shqiptare

Trevat shqiptare dallohen për:

- një reliev original, tepër të spikatur dhe të shumëllojshëm;
- karakterin *kodrinoro-malor* të tyre.

- lartësia ulet nga lindja në perëndim gradualisht nga malet dhe malësitë e larta në male më të ulta, në kodra e së fundmi në fushat pranë bregdetit, sepse ka ndjekur drejtimin e evolucionit gjeologjik që kanë pësuar trevat. Në drejtim të brigjeve të Jonit, relievi malor i lartë përsëritet edhe në pjesën bregdetare ndërsa në veri të trevave, lartësia ulet nga qendra drejt periferisë. Në juglindje e lindje të trevave, një përqindje të lartë zënë gropat e fushëgropat.



Tema: Morfologjia e relievit të trevave shqiptare

Karakteristikë për relievin e trevave shqiptare është:

Prania e **copëtimit vertikal** që krijon një diferencim vertikal të relievit në tre kate hipsometrikë:

Relievi i ulët (0-200 m). Zë rreth 23.4 % të territorit të Republikës së Shqipërisë dhe 17.3 % e territorit të Republikës së Kosovës. Ky reliev është përqëndruar në Ultësirën Perëndimore.

Relievi i mesëm (200-1000 m). Zë 48.1% të territorit të Republikës së Shqipërisë dhe 63.4 % e territorit të Republikës së Kosovës. Në këtë kategori të relievit bëjnë pjesë kodrat, gropat dhe fushëgropat (Fushëgropa e Kosovës, e Korçës dhe e Pellagonisë; Lugu i Dukagjinit dhe i Pollogut;)

Relievi i lartë (mbi 1000 m). Zë 28.5 % të territorit të Republikës së Shqipërisë dhe 19.3 % e territorit të Republikës së Kosovës. Ky kat hipsometrik përfaqësohet me malet që gjenden në veri, lindje e jug të trevave. Vetëm 1% e këtij relievi ka lartësi mbi 2000 m.

Diferencimi vertikal brenda hapësirave të vogla, krijojnë edhe pjerrësinë e konsiderueshme të shpateve që luhet nga 10-450. Në disa raste shpatet marrin edhe karakter gremior.

Prania e **copëtimit horizontal**. Në RSH, vlera mesatare e copëtimit horizontal është 3-4 km/km². Për **vlera shumë të larta të copëtimit** dallohen: territoret me përbërje **terrigjene e flishore** (si: Gropa e Matit dhe e Kolonjës, Kodrat e Kërrabës e të Mallakastrës dhe Malësia midis Tomorr-Melesinit), **vullkanogjene-sedimentare** (në Malësinë Pukë-Mirditë) dhe territoret që kanë bimësi të pakët, ose janë të zhveshura nga keqpërdorimi i veshjes bimore. Për **vlera të vogla të copëtimit horizontal** dallohen: rajonet fushore të Ultësirës Perëndimore, Fushëgropa e Kosovës, Fushëgropa e Korçës, etj.

Morfologjia e relievit të trevave shqiptare
Morfologjia e relievit të trevave shqiptare përbëhet nga male, vargje malorë, malësi, kodra, vargje kodrinorë, fusha, fushëgropa, gropa, lugje, lugina lumore, etj. Relievi është orientuar në drejtime të ndryshme: në perëndim dhe jug të

Malet dhe kodrat: në varësi të përbërjes shkëmbore dhe të kohës e forcës së veprimit të faktorëve të jashtëm, kanë kreshta të ndryshme. Malet gjenden si male të veçuar, vargje malorë dhe malësi.


Fushëgropat: janë formuar nga fundosjet tektonike dhe kanë ende tendencën e uljes në reliev dhe si rezultat i kësaj, karakterizohen nga një fund i sheshtë.

Gropat: janë të shumta dhe shumica e tyre gjendet në brendësi të trevave. Shtrihen herë në formë zinxhiri e herë të shpërndara në pjesë të ndryshme të truallit dhe janë krijuar nga fundosje tektonike. Kanë funde të çrregullt, të gërryer prej rrjedhjeve sipërfaqësore dhe reliev të larmishëm, të diferencuar e të rrethuar nga male të larta.

Fushat: janë përqëndruar në pjesën perëndimore të trevave shqiptare, në Ultësirën Perëndimore. Është fusha më e madhe jo vetëm e trevave shqiptare por edhe e gjithë Ballkanit Perëndimor dhe në pjesën më të madhe të saj ka origjinë tektonike ngritëse të shoqëruar me veprimtarisë depozituese të lumenjve që derdhen në Adriatik. Në veri të saj, në Ultësirën e Shkodrës, ka origjinë tektonike fundosëse të shoqëruar nga veprimtaria depozituese e Drinit dhe e përrenjëve të Mbishkodrës. Fusha ka edhe në brendësi të trevave e ato zënë fundin e gropave ndërmaalore ose në luginat e lumenjve, por janë me sipërfaqe të vogël.

Luginat: përbëjnë një karakteristikë dalluese shumë të përhapur të relievit, që lidhet me: reshjet e bollshme në kushtet e relievit kodrinor-malor.

Tema: Tiparet e klimës së trevave shqiptare dhe faktorët që i përcaktojnë ato



Tema: Rajonizimi klimatik i trevave shqiptare

Ndarja e klimës në disa tipe është bërë **duke u mbështetur**:

- në shtrirjen hapësinore të trevave nga bregdeti drejt brendësisë kontinentale;
- në shkallën e ndikimit të masave ajrore;
- në veçoritë e relievit, sidomos në lartësinë mbi nivelin e detit;
- në shkallën e ndikimit të faktorëve lokalë.

Klima malore ndeshet në lartësitë mbi 1000-1300 m mbi nivelin e detit. Kjo klimë mbizotëron në Alpet Shqiptare, në vargun Sharr-Korab, në Kopaonik, etj.

Tipet e klimës në trevat shqiptare

Klima kontinentale shfaqet në pjesën më të madhe të Republikës së Kosovës, në trevat shqiptare në Serbi dhe ato në Maqedoninë Perëndimore. Tiparet e klimës kontinentale në këto treva, janë formuar në kushtet e largësisë së tyre prej ndikimit detar, të prezencës së barrierave malore midis tyre dhe pjesës tjetër të trevave, të ndikimit të masave ajrore kontinentale nga brendësia e Gadishullit Ballkanik e Evropa Lindore që depërtojnë prej luginave lumore dhe nga lartësia mbi nivelin e detit.

Klima mesdhetare e trevave shqiptare shfaq tiparet e saj më të qarta në territorin e Republikës së Shqipërisë, në trevat shqiptare në Greqi, në zonën bregdetare të trevave shqiptare në Mal të Zi dhe në jugperëndim të Republikës së Kosovës. Kjo klimë dallohet për verën e nxehtë e të thatë dhe dimrin e butë e të lagët, si dhe për një regjim detar në ecurinë e përgjithshme vjetore të temperaturave e të rreshjeve. Ndahet në disa nënzona klimatike.

Zona mesdhetare fushore, që shtrihet në pjesën e ulët bregdetare (Ultësirën Perëndimore dhe brezin e ulët të bregdetit jonian). Zë 18% të territorit dhe karakterizohet nga dimri i butë e i lagësht dhe verë e nxehtë, e gjatë dhe e thatë. Tiparet e kësaj klime janë krijuar në kushtet e relievit të ulët fushor, të afërsisë me detin Adriatik dhe Jonian, të mbrojtjes nga ndikimet e erave të ftohta lindore, malore e kontinentale.

Zona mesdhetare kodrinore, shtrihet në lindje të zonës mesdhetare fushore dhe përfshin relievet kodrinore dhe luginore. Përfshin luginën e Matit, shpatet perëndimore të maleve të Skënderbeut, rrjedhjen e mesme të Shkumbinit, të Devollit, të Drinosit e të Shushicës, relievet kodrinore përreth Fushëgropës së Delvinës etj. Tiparet e kësaj zone janë formuar në kushtet e relievit kodrinor mbi 200 m, në kushtet e largimit nga ndikimi detar, të mbrojtjes nga erat e ftohta lindore në disa pjesë por edhe të ndikimit në sektorët e luginave, etj.

Zona mesdhetare paramalore, përfshin luginën e Drinit, të Drinit të Zi, rrjedhjen e poshtme të Valbonës, gropën e Tropojës me kodrat e malet rreth saj, luginën e Shkumbinit të Sipërm, gropat e fushëgropat juglindore, pjesët e larta të maleve Krujë-Dajt, malin e Skënderbeut, etj. Tiparet e kësaj klime, janë formuar nga lartësia mbi nivelin e detit, nga largësia prej ndikimit detar e ekspozimi ndaj ndikimit kontinental, nga karakteri i mbyllur i mjaft territoreve të saj dhe karakteri i ndryshëm i relievit që e përbën, etj.

Zona mesdhetare malore, shtrihet në lartësitë mbi 1300 m, duke përfshirë vargjet malorë, malësitë e male të veçantë. Karakterizohet nga klimë tipike malore, me dimër të gjatë e të ftohtë, me reshje të bollshme e vranësira të shpeshta dhe me verë të freskët, të shkurtër dhe me shira të mjaftueshme. Tiparet kësaj klime janë formuar në kushtet e lartësisë mbi nivelin e detit, nën ndikimin e dukshëm të masave ajrore lindore e veriore, të largësisë nga ndikimi detar, etj.

Tema: Hidrografia e trevave shqiptare.

Detet dhe liqenet

Disa veçori të hidrografisë së trevave shqiptare


Trevat shqiptare dallohen për *pasuri të mëdha ujore në raport me sipërfaqen e tyre*. Pasuria hidrografike, *ka shpërndarje të pabarabartë* në sipërfaqen e territorit të trevave dhe në stinë të ndryshme të vitit.

Hidrografia paraqitet: *në formën e deteve, liqeneve, lagunave, lumenjve, përrenjve, burimeve, ujërave nëntokësorë dhe të objekteve hidrografikë artificiale (kanale ujitës, ujëmbledhës, rezervate)*

Detet që lagin trevat shqiptare

Deti Jon. Prej Kanalit të Otrantos hapet në drejtim të jugut, si një det i gjerë i vendosur midis jugut të Gadishullit Apenin dhe Gadishullit Ballkanik. Është vendosur në një gropë tektonike me thellësi 3000-4000 m, me thellësi maksimale 5120 m (në Peloponez). Është pjesa më e thellë e detit Mes-dhe. Dallohet për pastërti të ujrave dhe kripësi më të madhe se Deti Adriatik (39 ‰). Bregdeti shqiptar i Jonit shtrihet nga kepi i Gjuhëzës (në gadishullin e Karaburunit) deri në gjirin e Artës (në trevat e Çamërisë). Është bregdet i lartë shkëmbor që dallohet edhe për plazhe të vogla, zallore e me thellësi të madhe në brigje.

Deti Adriatik, është pjesë e Detit Mesdhe dhe shtrihet midis Gadishullit Apenin në perëndim dhe Gadishullit Ballkanik në lindje. Fillon në veri në Gjirin e Triestes dhe përfundon në Kanalin e Otrantos, me një gjatësi 850 km dhe gjerësi mesatare 200 km. Kanali i Otrantos ndodhet midis Kepit të Gjuhëzës në Gadishullin e Karaburunit dhe Kepit Santa Lucia de Luca në Itali me një gjerësi 72 km. Kanali i Otrantos, e ndan këtë det me Detin Jon dhe është distanca më e shkurtër midis dy gadishujve. Deti Adriatik është vendosur në gropën e madhe tektonike midis dy gadishujve dhe në pjesën më të madhe të tij ai ka thellësinë nën 200 m. Thellësinë maksimale e arrin në jug me 1589 m. **Bregdeti shqiptar i Adriatikut** është i gjatë 380 km dhe në pjesën më të madhe të tij është bregdet i ulët.



Tema: Lumenjtë e trevave shqiptare

Veçori të përgjithshme të lumenjve

Trevat shqiptare dallohen: për rrjetin e dendur hidrografik, por dendësia e tij ndryshon nga njëri pellg lumor te tjetri. Ujërat e pellgjeve ujëmbledhës të tyre përfundojnë në katër dete: në Adriatik, në Jon, në Egje dhe në Detin e Zi. Janë lumenj të shkurtër, me disa degëzime dhe kanë pellgje ujëmbledhës të vegjël. Një pjesë e madhe e tyre rrjedh me drejtim nga lindja në perëndim. Kanë pjerrësi të konsiderueshme të luginës së tyre, por sidomos në rrjedhjet e tyre të sipërme. Në rrjedhjet e poshtme në përgjithësi janë fushorë. Lumenjtë dallohen për kofçentin e lartë të rrjedhjes, pra pjesa më e madhe e sasisë së reshjeve që bie në pellgun ujëmbledhës hyn në rrjedhje. Lumenjtë e trevave shqiptare karakterizohen nga regjimi mesdhetar, pra sasia më e madhe e prurjeve në to, regjistrohet në gjysmën e ftohtë e të lagësht të vitit ndërsa sasia më e vogël, gjatë periudhës së thatë e të nxehtë. Lumenjtë e trevave shqiptare, janë eroziv dhe mbartin sasi të mëdha

Lumenjtë e trevave shqiptare

Lumenjtë që derdhen në detin Adriatik:

Drini, është lumi më i madh jo vetëm i trevave shqiptare, por i gjithë Ballkanit Perëndimor. Formohet nga bashkimi i **Drinit të Zi** me **Drinin e Bardhë**. **Drini i Zi** buron nga liqeni i Ohrit, ndërsa **Drini i Bardhë** buron nga malësia e Zhlebit.

Buna, buron nga liqeni i Shkodrës dhe është i vetmi lumë fushor në Shqipëri.

Lumenjtë që derdhen në detin Egje:

Vardari. Vetëm rrjedhja e tij e sipërme kalon në trevat shqiptare, sepse buron në Vrutok, pak kilometra në veri të Gostivarit. Në afërsi të Shkupit bashkohet me me degën e tij **Lepencin**, që buron nga Malet e Sharrit. Më pas, hyn në territorin grek (në Gjegjeli) dhe derdhet në det, në perëndim të Selanikut.

Lumi i Aliakmonit, është 300 km i gjatë, por vetëm rrjedhja e sipërme kalon në trevat shqiptare, sepse buron në faqen lindore të malit Gramoz.

Rëndësia e lumenjve: kanë rëndësi të madhe **gjeografike, jetësore dhe ekonomike**. Ndikojnë në klimë, pasi rrisin sasinë e avujve të ujit e krijojnë mikroklima. Luginat e tyre gjithashtu, shërbejnë si korridore për lëvizjen e masave ajrore të ndryshme. Janë një ndër faktorët e jashtëm që modelojnë relievin e trevave dhe krijojnë mjediseve të veçanta jetese për botën e gjallë. Lumenjtë e trevave shqiptare kanë një rëndësi të madhe ekonomike. Janë të favorshëm për sigurimin e ujit të pijshëm e industrial, për zhvillimin e bujqësisë (ujtje e drenazhim), për hidroenergji (ndërtimi i HEC-ëve), për zhvillimin e transportit të turizmit, të transportit, të turizmit, të peshkimit, të sporteve ekstreme, etj.

Lumenjtë që derdhen në detin Jon, janë :


Kalama, Pavlla, Kalasa, Bistrica, lumi i Artës. **Lumi i Artës**, buron nga malet e Pindit (në Greqi), kalon pranë Janinës dhe rrjedh drejt qytetit të Artës dhe derdhet në jug të saj (në Gjirin e Ambrakisë).

Bistrica, është lumë që ushqehet prej ujërave nëntokësorë. Burimet e saj (20 burime) dalin në rrëzën jugore të Qafë Muzinës. Burimi kryesor i saj është "Syri i Kaltër". **Kalama**, buron pranë kufirit të RSH, në verilindje të Janinës. Përshkon gjithë Çamërinë dhe derdhet në veri të Igumenicës.


Degë lumore të lumenjve që derdhen në Detin e Zi:

Lumi Ibër dhe **Sitnica** (degë e tij) përshkojnë territorin e Fushë Kosovës nga jugu në veri. Pranë Mitrovicës lugina ka karakter fushor. Lumi gjarpëron derisa ujërat e tij derdhen në Danub.

Tema: Ujërat nëntokësorë dhe burimet



Tema: Llojet e tokave



Tema: Bota bimore dhe shtazore e trevave shqiptare

Pozicioni gjeografik, ka përcaktuar krijimin e origjinalitetit të botës së gjallë të trevave shqiptare. Për shkak të pozitës gjeografike, në trevat shqiptare ka bimësi e botë shtazore të tipit mesdhetar, ballkanik dhe të Evropës Qendrore. **Përbërja gjeologjike**, përcakton llojin e **tokave** dhe rrjedhimisht ndikon edhe në karakteristikat dhe llojet e botës së gjallë. **Relievi**, ndikon me anë të lartësisë dhe ekspozimit. Mbi bazën e rritjes në lartësi përcaktohet edhe katëzimi i botës së gjallë. Shkalla e ndryshme e ekspozimit ndaj rrezatimit diellor, erës dhe rreshjeve, përcakton llojshmërinë e botës së gjallë (rriten specie që duan ose jo diell, lagështirë, etj.). **Klima** dhe **hidrografia**, ndikojnë në shumëllojshmërinë e botës bimore dhe shtazore. **Shoqëria njerëzore**, ka ndikuar pozitivisht dhe negativisht mbi botën e gjallë.

Faktorët që ndikojnë në shumëllojshmërinë e botës së gjallë

Bimesia


Katet e bimesise

Brezi i ahut, shtrihet mbi brezin e dushkut dhe shkon deri në 1800-2300 m lartësi. Është brezi më i pasur pyjor i trevave shqiptare, ku dominon druri i ahut. Shpesh masivet e ahut përzihen edhe me pyje halore dhe pyje bredhi. Pyjet e ahut kanë sipërfaqe më të madhe shtrirjeje në pjesën veriore të trevave. Në pjesën jugore pyjet e ahut ia lën vendin halorëve. Sipërfaqe të mëdha me bimësi të këtij brezi gjenden në malet e Sharrit, në Alpe etj.

Brezi i kullotave alpine, përfshin territoret më të larta malore të trevave, mbi lartësitë 1700-1800 m. Përbëhet nga një bimësi barishtore, që në disa sipërfaqe althernohet me shkurre të ulëta. Në trevat qendrore dhe veriore, bimësia barishtore është e tipit mesevropiane ndërsa në trevat jugore është e tipit mesdhetare.

Brezi i shkurreve mesdhetare: Kufiri i lartësisë në të cilën shtrihet ky brez, në planin vertikal, ndjek ndryshimin e vlerave të temperaturës dhe të rreshjeve. Në trevat veriore kufiri vertikal i kësaj bimësie, shkon deri në 400 m, ndërsa në trevat jugore 800-1000 m. Është bimësi tipike për pjesën perëndimore të trevat shqiptare. Ky brez gjendet në formën e dy nënkateve: të shkurreve të tipit makje, me gjelbërim të përhershëm dhe i shkurreve të tipit shibljak, që rrëzon gjethet në dimër. Brezi me gjelbërim të përhershëm përbëhet nga mareja, shqopa, dafina, gjineshtra etj, ndërsa brezi i dytë përfaqësohet me shkozën. Pjesë e këtij brezi janë edhe halorët e tipit mesdhetar që gjenden në Divjakë, Pishëporë, dhe Llogara.


Brezi i dushkut, shtrihet mbi brezin e shkurreve mesdhetare. Në trevat veriore gjendet deri në 700 m lartësi ndërsa në ato jugore deri në 1200 m. Bimësia karakteristike janë disa lloje dushqesh (lisi i butë, qarri, bunga, etj), të cilat shpesh përzihen me drurë të tjerë (panja, lajthia, gështenja etj).



KREU: ORGANIZIMI ADMINISTRATIV I TREVAVE SHQIPTARE

Linja III: Sistemet humane

Tema: Organizimi administrativ i trevave shqiptare



KREU IV: POPULLSIA DHE VENDBANIMET

Tema: Historiku i popullimit dhe ndryshimet demografike të trevave shqiptare

Numri i popullsisë shqiptare

Një pasqyrim të parë por të pjeshëm të numrit të popullsisë shqiptare e jep regjistri kadastral i vitit 1431-1432 që jepte të dhëna vetëm mbi Sanxhakun të Shqipërisë (me kryeqendër Gjirokastrën). Më pas, në vitin 1506, ai u plotësua me të dhënat mbi regjistrimin e përgjithshëm të të gjitha tokave shqiptare (përveç tokave ku ishte zbatuar më parë sistemi i timarit u shtuan të dhëna mbi krahinat malore të vetëqeverisura në të cilat nuk ishte zbatuar ky sistem).

Mendohet, që deri në momentin e copëtimit të trojeve shqiptare në vitin 1913, numri i popullsisë të ishte rreth 1500000 banorë.

Që prej copëtimit të trevave e deri sot, të dhënat për numrin e popullsisë shqiptare, jepen të veçanta për Shqipërinë dhe për trevat e tjera shqiptare jashtë kufirit. Regjistrimet e numrit të popullsisë shqiptare në trevat tona jashtë kufiri, shpesh nuk kanë pasqyruar realitetin, madje kanë pasur tendenca të uljes së numrit të saj.

Regjistrimi i përgjithshëm më i hershëm në **Shqipëri** është i vitin 1923, ku popullsia rezultoi rreth 814 380 banorë. Që nga ai vit e deri në vitin 2001 janë kryer disa regjistrime. Në Regjistrimin e 10-të të Popullsisë dhe Banesave (më 1 Prill 2001, INSTAT), rezultoi se popullsia e regjistruar në RSH ishte 3 087 159 banorë.

Struktura etnike e popullsisë në **Kosovë**, për herë të parë është evidentuar në regjistrimin e vitit 1948. Të dhënat e periudhës pas viti 1981, jepen nga përllogaritjet e Entit të Statistikave të Kosovës. Sipas tij, në vitin 2006 numri i popullsisë në Republikën e Kosovës ishte 2 100 000 banorë.

Në trevat shqiptare në Maqedoni jetojnë 509 083 shqiptarë (sipas regjistrimit të vitit 2002), **në trevat shqiptare në Mal të Zi jetojnë** 47 682 shqiptarë, **në trevat shqiptare në Serbi jetojnë** rreth rreth 80 000 shqiptarë dhe **në trevat shqiptare në Greqi jetojnë** rreth rreth 60000 shqiptarë. Një pjesë tjetër e popullsisë shqiptare, është edhe pjesa që ka emigruar që herët jashtë vendit dhe përbën diasporën shqiptare në SHBA, Argjentinë, Bullgari, Kroaci, Egjipt, Greqi dhe Turqi.

Popullimi dhe ndryshimet demografike në trevat shqiptare

Popullim i hershëm dhe i vazhdueshëm në trojet e veta Të dhënat arkeologjike të zbuluara në Xarë (të rrethit të Sarandës) në Kryegjatë (në afërsi të Apolonisë) në Gajtan (të rrethit të Shkodrës), etj, sjellin prova dhe argumenta që trevat shqiptare janë banuar që nga paleoliti i mesëm (100 000 vjet-30 000 vjet më parë).

Gjatë neolitit popullimi u bë më dendur dhe në shekujt e parë të mijëvjeçarit të fundit para erës sonë ishin formuar bashkësitë fisnore ilire që shtriheshin që nga lumi Sava në veri deri tek gjiri i Ambrakisë në jug dhe që nga rrjedhja e lumenjve Moravë e Vardar në lindje deri në brigjet e Adriatikut e Jonit në perëndim.

Më pas popullsia vazhdoi të rritej në numër, por sipërfaqja e shtrirjes së saj, krahasuar me atë të mëparshme filloi të tkurrej, sidomos gjatë mesjetës, në periudhën e dyndjeve në Ballkan (në përfundim të dyndjeve sllave në fund të shekulit VIII).

Gjatë mesjetës, numri i popullsisë së trevave shqiptare vazhdoi të rritej. Deri në shek XII, kjo popullsi u quajt arbër si rezultat i lindjes dhe fuqizimit të formacionit shtetëror të Arbrit (i cili ishte vazhdim i fisit ilir albanoi gjatë antikitetit), ndërsa nga shek. XIII e në vazhdim, ajo u quajt shqiptare.

Shpërndarja e popullsisë në trevat shqiptare

Dendësia e popullsisë është e ndryshme: **Dendësinë mesatare më të madhe të popullsisë** në trevat shqiptare e ka Republika e Kosovës me 193 banorë/km² dhe më të ulët trevat shqiptare në Greqi me 31 b/km².

Sipas rajoneve, dendësinë më të madhe në trevat shqiptare e ka Rajoni Perëndimor (në rajonin Tiranë-Durrës shkon rreth 420 b/km²), Rajoni Lindor i Kosovës (në Prishtinë 420 b/km²), Rajoni Perëndimor i Kosovës (në Prizren 210 b/km²) dhe Fusha e Pollogut (në Tetovë 150 b/km²).

Dendësia më e vogël 20-50 b/km², është kryesisht në rajonet malore të trevave dhe në zonat që kanë njohur emigracion më të madh të popullsisë.

Popullimi dhe ndryshimet demografike në trevat shqiptare

Struktura e popullsisë

Struktura e popullsisë sipas grupmoshës.

Popullsia e trevave shqiptare është popullsi e re ku mbizotërojnë grupmoshat e reja, fertile dhe aktive për punë. Moshë mesatare e popullsisë në RSH është 29 vjeç, ndërsa në Republikën e Kosovës 23 vjeç. Rreth 32 % të popullsisë të popullsië së trevave shqiptare, e përbën grupmosha 0-15 vjeç, 61 % e përbën grupmosha 16-65 vjeç dhe 7 % grupmosha mbi 65 vjeç.

Struktura e popullsisë sipas gjinisë.


Në kuadrin e përgjithshëm të popullsisë së trevave, në raportin midis përqindjeve që zë popullsia mashkull/femër, popullsia mashkull ka një ndryshim të lehtë dominues, krahasuar me përqindjen që zë popullsia femër. Lindin më shumë meshkuj sesa femra, por jetëgjatësia është më e lartë tek femrat se sa tek meshkujt.

Struktura etnike e popullsisë. Në RSH popullsia shqiptare është homogjene dhe zë 98 % të popullsisë së përgjithshme ndërsa pakicat kombëtare zënë vetëm 2% (greke, malazeze, maqedonase.) të saj. Në Republikën e Kosovës, popullsia shqiptare përbën 92 % të popullsisë së përgjithshme dhe pjesa tjetër (8 %) përbëhet nga pakica etnike serbe, boshnjake, malazeze, rome dhe turke.

Struktura fetare e popullsisë. Në trevat shqiptare bashkëjetojnë në mënyre paqësore dy fe: islamike dhe e krishterë, me katër bashkësi fetare kryesore, myslimanë, bektashinj, ortodoksë dhe katolikë. Pjesa më e madhe e popullsisë së trevave i përket besimit islamik.

Struktura sipas vendbanimeve. Në popullsinë e përgjithshme të trevave shqiptare, popullsia rurale zë përqindje më të lartë (rreth 58 %) se ajo urbane (42 %). Megjithatë, popullsia urbane, që pas Luftës së Dytë Botërore e në vazhdim, ka pësuar rritje në vazhdimësi.

Tema: Migrimet e popullsisë. Shkaqet dhe pasojat e tyre në trevat shqiptare



Tema: Struktura e vendbanimeve në trevat shqiptare

Tipet e vendbanimeve në trevat shqiptare

Vendbanimet fshatare zënë hapësirën më të madhe të trevave shqiptare dhe ndryshojnë midis tyre nga: 1. Aktiviteti kryesor ekonomik (ku pjesa më e madhe kanë si aktivitet bazë bujqësinë e blegtorinë dhe dallohen për sipërfaqen më të madhe të shtrirjes e numrin e lartë të popullsisë). Këta fshatra shtrihen kryesisht në Ultësirën Perëndimore, Fushën e Kosovës, Lugun e Dukagjinit, Fushëgropën e Korçës, të Pollogut dhe të Pellagonisë, por edhe në zonat kodrinore përreth tyre. Një pjesë tjetër e fshatrave, kanë si aktivitet bazë ekonominë pyjore dhe janë përqëndruar kryesisht në zonat kodrinore e malore, ku janë të pranishme sipërfaqet pyjore. Ato kanë një përqëndrim më të vogël të popullsisë. Fshatrat e zonave bregdetare dhe bregliqenore, kanë si aktivitet bazë peshkimin e turizmin dhe dallohen për përqëndrimin e banesave. Të tillë janë fshatrat e

Veçoritë e zhvillimit të vendbanimeve në trevat shqiptare

Që nga paleoliti i mesëm deri në fund të neolitit, vendbanimet gjendeshin nëpër shpella, në tarraca lumore, pranë burimeve ujore, pranë tokave pjellore dhe nëpër pyje. Banesat kaluan nga ato në formë gropash të nëndheshme në kasolle të ndërtuara mbi hunj (palafite). Në epokën e hekurit, Ilirët jetonin në fshatra dhe në vendbanime të fortifikuara. Në fundin e kohës së hekurit (shek. VII-V p.e.sonë), disa prej këtyre vendbanimeve morën pamjen e qendrave protourbane (paraurbane), të krijuara si rezultat i zhvillimit të zejtarisë dhe të tregëtisë. Njoftimet më të hershme mbi ekzistencën e qyteteve në Iliri i përkasin mesit të shek. IV para.e.sonë dhe (Dyrrahu, Apolonia, Bylisi, Antigonea, Lisi, etj.). Gjatë periudhës së mesjetës (shek V-VII e.s), pjesa më e madhe e popullsisë jetonte në fshat dhe disa vendbanime urbane morën një tjetër rëndësi. Në vitet '20 dhe '30 të shek. XX, fizionomisë orientale të qyteteve, iu shtuan ndërtime me elementë të modeleve evropiane (austriake dhe italiane) dhe përveç funksionit ekonomik e tregtar që kishin, qytetet morën edhe funksion administrativ dhe shoqëror. Pas vitit 1945 e në vazhdim, përveç rritjes së funksioneve administrative dhe sociale, qendrat urbane morën edhe funksione industriale. Në zonat rurale funksioni kryesor vazhdoi të ishte ai bujqësor, blegtoral e në disa zona bregdetare e bregliqenore edhe peshkimi. Pas vitit '90, u rrit numri i vendbanimeve urbane, ndryshoi urbanistika dhe stili i ndërtimeve (sidomos në qytetet e mëdha) dhe u vu në një ridimensionim i funksioneve të tyre.

Qytetet, janë vendbanimet më të rëndësishme të trevave shqiptare. Ato ndryshojnë midis tyre sipas funksionit që kanë dhe aktiviteteve që kryhen në to. Mbi bazën e funksioneve, qytetet ndahen në: shumëfunksionalë (kryeqyteti dhe qendrat e qarqeve që kryejnë aktivitet administrativ, tregëtar, industrial, kulturor, arsimor, shëndetësor, etj.), industrialë, tregëtarë dhe turistikë. Emërtimi i tyre, bazohet në aktivitetin dominues që ata kanë, por përveç tij në to kryhen edhe funksione të tjera të rëndësishme.

Tema: Kushtet e zhvillimit ekonomik të trevave shqiptare

Potenciali natyror në favor të zhvillimit ekonomik të trevave shqiptare

Pozita gjeografike mundëson kultivimin e shumë kulturave bujqësore, zhvillimin e energjitikës, të turizmit, të transportit, të tregëtisë, të shërbimeve, të peshkimit etj. Dalja përmes kanalit detar të Otrantos dhe vendosja në kryqëzimin e rrugëve që kalojnë nga Mesdheu Perëndimor për në Ballkan e në Azinë e Vogël, krijojnë mundësinë e përfshirjes së trevave shqiptare në projekte ekonomike rajonale dhe ndërrajonale. Nëntoka e pasur me **shumëllojshmëri minerale**, mundëson zhvillimin e industrisë nxjerrëse dhe përpunuese të mineraleve, si dhe eksportin e tyre. Mozaiku i formave të **relievit**, përcakton profilin e zhvillimit ekonomik në hapësirën e trevave shqiptare.

Shumëllojshmëria klimatike, kohëzgjatja e ditëve me diell, vlerat e temperaturave, regjimi e sasia e reshjeve dhe drejtimi e shpejtësia e erës, mundësojnë kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore e rendimentin e tyre, zhvillimin e blegtorisë, të turizmit (bregdetar, të bardhë, të gjelbër) dhe të energjitikës (për hidroenergji dhe energjinë eolike). **Hidrografia e pasur** e trevave, krijon mundësinë e zhvillimit të transportit ujor, të përfitimit të hidroenergjisë, të zhvillimit të turizmit bregdetar e bregliqenor dhe të peshkimit. Përgjatë luginave lumore gjithashtu, është ndërtuar edhe rrjeti automobilistik që mundëson lidhjen midis të gjithave hapësirave të trevave shqiptare. **Shumëllojshmëria e tokave, e bimësisë dhe e botës shtazore** mundësojnë zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, ekonomisë pyjore, industrisë së drurit, turizmit, industrisë ushqimore, etj.

Perspektivat e zhvillimit

Perspektiva e zhvillimit ekonomik të trevave shqiptare sot, është e lidhur me zbatimin e suksesshëm të strategjive të përbashkëta të zhvillimit rajonal dhe integrimin evropian të tyre. Kjo perspektivë, bazohet në krijimin e klimës së sigurisë, të besimit dhe të bashkëpunimit midis vendeve të rajonit të Ballkanit, si dhe në mundësinë e integritit të suksesshëm në Bashkimin Europian të të gjithë vendeve ku bëjnë pjesë trevat shqiptare.


Potenciali human në favor të zhvillimit ekonomik të trevave shqiptare

Përqindja e lartë që zë grupmosha e punës në numrin e përgjithshëm të popullsisë shqiptare, është një mbështetje shumë e mirë për zhvillimin ekonomik të këtyre trevave. Një faktor tjetër i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të trevave është edhe **kualifikimi që ka grupmosha e punës** dhe përpjekjet e vazhdueshme të kësaj grupmose për t'ju përshtatur kërkesave të tregut. Një tjetër faktor nxitës dhe mbështetës në zhvillim, është edhe **tradita e ekonomive** që shqiptarët kanë zhvilluar në shekuj. Një faktor tjetër i rëndësishëm i zhvillimit aktual ekonomik të trevave shqiptare është edhe **kthimi nga emigracioni i një pjese të popullsisë së emigruar**, të cilët sjellin me vete përvojën dhe kualifikimin në ekonomitë më të zhvilluara evropiane, duke investuar të ardhurat e tyre sidomos në ndërtimtarë, shërbime e turizëm. E një rëndësie të veçantë për zhvillimin ekonomik të trevave është edhe **përgatitja dhe shkollimi i një brezi të ri në shkollat më të mira evropiane e amerikano-veriore**. Një pjesë e tyre janë kthyer në atdhe dhe janë bërë pjesë e elitës intelektuale të kombit, që kontibujojnë në politikat dhe strategjitë integruese evropiane të trevave shqiptare.

Kushtet e zhvillimit ekonomik të trevave shqiptare


Roli i faktorëve historiko-shoqërorë në zhvillimin ekonomik të trevave shqiptare **Luftërat dhe pushtimet e ndryshme, copëtimi territorial e politik i trevave, emigrimet masive të popullsisë dhe zbatimi i politikave të gabuara të zhvillimit ekonomik**, kanë frenuar dhe kanë penguar rrjedhën e zhvillimit ekonomik të këtyre trevave.

Tema: Ekonomia e trevave shqiptare



Linja IV: Ndërveprimi njeri/mjedis

Tema: Trashëgimia natyrore e trevave shqiptare



Më tepër informacion, i cili mund ti serviret nxënësve për Projektin 4 Projekt Nr.4

Tema: Trashëgimia natyrore dhe kulturore e trevave shqiptare në favor të zhvillimit të tyre

1.Kategorizimi i Zonave të Mbrojtura. (Sipas Agjensisë Kombëtare të Mjedisit)

Nr	Emërtimi	Sipërfaqja, ha	Rrethi	Miratuar
Kategoria I		Rezervat strikt natyror/rezervë shkencore		
1	Laguna e Karavastasë	5 000	Lushnjë	22.08.1994
2	Lumi i Gashit	3 000	Tropojë	15.01.1996
3	Rrajca	4 700	Librazhd	15.01.1996
4	Kardhiq	1 800	Gjirokastrë	15.01.1996
Kategoria II		Park kombëtar		
15	Mali i Dajtit	3 300	Tiranë	16.12.1960/1966
16	Thethi	2 630	Shkodër	21.11.1966
17	Lurë	1 280	Dibër	21.11.1966
18	Pisha e Divjakës	1 250	Lushnjë	21.11.1966
19	Llogara	1 010	Vlorë	21.11.1966
20	Bredhi i Drenovës	1 380	Korçë	21.11.1966
21	Mali i Tomorrit	4 000	Berat	15.01.1996/1940
22	Lugina e Valbonës	8 000	Tropojë	15.01.1996
23	Bredhi i Hotovës	1 200	Përmet	15.01.1996
24	Qafë Shtama	2 000	Krujë	15.01.1996
25	Zall Gjocaj	140	Mat	15.01.1996
26	Prespa	27 750	Prespa e Madhe dhe e Vogël	18.02. 1999
27	Butrinti			
Kategoria III		Monument natyre		
27	Bredhi i Sotirës	1 740	Gjirokastrë	15.01.1996
28	Syri i Kaltër	200	Delvinë	15.01.1996
29	Vlashaj	50	Dibër	15.01.1996
30	Zhej	1 500	Gjirokastrë	15.01.1996
	Etj.			

Kategoria IV		Rezervë natyrore e menaxhuar		
31	Rrushkull	650	Durrës	1955,1977,1983 26.12.1995
32	Pishë-Poro	1 500	Fier	1958/1977/1983
33	Velipojë	700	Shkodër	1958/1977/1983
34	Kune	800	Lezhë	1940/1960/1977/ 1983
35	Maliq	50	Korçë	1961/1977/1983
36	Patok-Fushëkuqe-Negel	2 200	Kurbin	1962/1977/1983
37	Karaburun	20 000	Vlorë	22.02.1968/1977/ 1983
38	Pishë-Poro	1 770	Vlorë	04.08.1969/1977/ 83
39	Vain	1 500	Lezhë	1940,1969,1977, 1983
40	Cangonji	250	Devoll	05.11.1960/ 1977/ 83
41	Bërzanë	880	Lezhë	05.11.1977/1983
42	Levan	200	Fier	05.11.1977/1983
43	Qafëmollë-Derje	3 300	Tiranë	05.11.1960/ 1977/ 83
44	Balloll	330	Berat	05.11.1977/1983
45	Qafë-Bushi	500	Elbasan	05.11.1977/1983
46	Bogovë	330	Skrapar	05.11.1977/1983
47	Krastafllak	250	Korçë	05.11.1977/1983
	Etj.			
Kategoria V		Peizazh i mbrojtur tokësor/detar		
48	Bizë	1.370	Tiranë	15.01.1996
49	Bërdhet	670	Tiranë	15.01.1996
50	Nikolicë	510	Devoll	15.01.1996
51	Territori natyror i pellgut të Ohrit	27 323	Pogradec	18.02.1999
	Etj.			
Kategoria VI		Rezervë e resurseve të menaxhuara		
52	Luzni-Bulac	5 900	Dibër	15.01.1996
53	Piskal-Shqeri	5 400	Kolonjë	15.01.1996
54	Bjeshka e Oroshit	4 700	Mirditë	15.01.1996
55	Guri i Nikës	2 200	Pogradec	15.01.1996

Monumentet natyrore në R.Sh. (sipas rretheve)

PREFEKTURA E ELBASANIT

Rrethi Elbasan

1. Frashëri i Polos Vale
2. Pylli aluvial i Shushicës
3. Shpella e Letanit
4. Hinka e Kosovës (Dumre)
5. Mali (Shkëmbi) i Gradishtes
6. Shpella e Gracenit
7. Liqenet e Sefëranit
8. Liqeni i Degës (Dumre)
9. Burimi i Llixhës së Hibrait
10. Dushku i Lleshanit
11. Mështekna e Zavalines
12. Pisha e Fushe Kuqes Gjinar
13. Dushku i Kishës Gjinar
14. Lisat e Pashtreshit
15. Mani i Zi i Joronishtit
16. Rrepet e Byshekut
17. Robulli i Zeleshnjës
18. Rapi i Bezistanit
19. Rrapi i Vojvodës
20. Rrapi i Gurrës së Labinotit
21. Ulliri i Qejfit
22. Rrapi i Llixhës
23. Rrapi i Uruçës

Rrethi Gramsh

1. Shpella e Kabashit
2. Kanioni i Sinecit (Saraselit)
3. Shkëmbi (kanioni) i Kopaçit (Grabovëe)
4. Karsti i Tervolit
5. Kanioni i Holtës
6. Tarraca e Ballores (Qytezës)
7. Gurret e Krushqeve në Lisec
8. Liqenet e Valamares
9. Liqeni i Dushkut
10. Burimet e Kerpices
11. Ujëvara e Sotirës
12. Arra e Tunjes

13. Robulli i Valamares
14. Dushkaja e Katër Lisave
15. Moçalet e Grabovës
16. Dushku i Bulçarit
17. Ahishtja e Rovjes
18. Liqeni i Zi (Lenie)
19. Gështenja dhe pisha në Teqenë e Skënderbegasit
20. Robulli i Grabovës

Rrethi Librazhd

1. Mështekna e Qarishtës
2. Pylli i Stravajt
3. Druri i Bizgës
4. Vrima e Dardhës së Ariut
5. Vrima e Stërqqokave
6. Shpella e Hasanit
7. Shpella e Shkëmbit të Bletës
8. Pusi i Faqes së Madhe
9. Shpella e Kosharishtit
10. Shpella e Pishkashit
11. Shpella e malit të Letmit
12. Sofra e Skënderbeut
13. Burimi i Studnës
14. Gurra e Kosharishtes
15. Liqenet e Rajcës
16. Liqeni i Floqit
17. Liqeni i Shebenikut
18. Liqeni i Varrit të Plakës
19. Rrapi i Bërzeshtës
20. Rrepet e Gurakuqit
21. Mani i Çupit
22. Rrapi i Hotolishtit
23. Rrapi i Taksimit
24. Rrapi i Gizaveshtit
25. Ahet e Fushe Gurrës
26. Pylli i Barkmadhit Kostenjë

Rrethi Peqin

1. Qarri i Karrines (Drangojve)
2. Bokërima e Garrunjës

3. Vidhi i Tabakut
4. Rrapi i Haskos
5. Rrapi i Uruçajt
6. Lisi i Babaliut

PREFEKTURA E FIERIT

Rrethi Fier

1. Dunat e Semanit
2. Pishat e zeza ne bregdetin e Poros –
Kategoria C
3. Kurora e lumit të vjetër të Semanit
(Libofshe Adriatik)
4. Rrepet e rrugës Fier-Vlorë
5. Rrapi i pazarit te Cakranit (Çaireve)

Rrethi Mallakaster

1. Rrepet e Vurgut të Çorrushit
2. Ujërat termale të Powlës
3. Rrapi i Ballshit
4. Lisat e Kalenjës (afër uzinës)
5. Rrepet e Festes
6. Lisi i Lapulecit -Lapulec
7. Lisat e Ngrasanit
8. Lisi i Vakefit (Çerilerës)
9. Lisi i Cfirit - Mallakastër
10. Lisat e Lavdanit
11. Mospërputhje këndore e Greshicës
12. Shpella e Poçemit (Vrima e Lakuriqit)
13. Rrapi i ujit (Drizar)
14. Arra e Hekalit
15. Rrepet e Poçemit

Rrethi Lushnjë

1. Rrapi i Zonjës – Bubullumë
2. Lisi i Koniatit – Koniat
3. Pisha e Egër në oazin e Divjakës
4. Dushkajat i Senës
5. Godulla e Pishës (Divjake)
6. Ishulli i Pelikanit
7. Ishulli i Kularit
8. Kordoni litoral i lagunës së re të
Divjakës

9. Dunat e Oazit të Divjakës
10. Burimi termoninerar i Karbunarës
11. Gorica e kodrës në Kryekuq
12. Selvitë e manastirit Ardenice
13. Dushkajat e Manastirit - Lushnje
14. Rrepet e Ngurrezes
15. Vidhat Zharnec

PREFEKTURA E VLORES

Rrethi Vlorë

1. Qiparisi i Kambanores së Kishës së
Vunoit
2. Lisat e Pilurit
3. Rrapi i Kosmarit Kudhës
4. Rrapi i Palasës
5. Rrapi i Shkollës nr.1
6. Rrapi i Xhamisë
7. Rrapi i Çesmës (Mifol)
8. Ilqet i Zarelit me (0,5 ha)
9. Rrapi i Kroit të Madh
10. Rrapi Laze
11. Mbihipja e Çikës
12. Mbihipja aktive e Dukatit
13. Shkëputje e re aktive e Llogarasë
14. Tarraca detare e Kusbabait
15. Tarraca detare e ish-shtëpisë së
pushimit të punëtorëve
16. Gjiri dhe shpellat e Gramës
17. Bariera Koralore e grykës së Diallit
18. Falezat e Sazanit
19. Shpella e Shëngjergjit ose e Bletës
20. Shpella e Ramicës
21. Shpella e Velçës
22. Shpellat e Boderit (Smokthine)
23. Shpella e Haxhi Alisë (Iliriane)
24. Shpella e shkruar
25. Shpella e Bilbilenjëve
26. Shpella e Porto Palermos
27. Shpella e Piratëve (Dhërmi)
28. Shpella e Odisesë (Surianit)
29. Shpella e Duk Gjonit
30. Kanioni i Gjipesë
31. Bokërimat e Vunoit

32. Rrethi i Plakës (Brataj)
33. Ujëvara e Ramicës
34. Dunat e Nartës
35. Delta e Përroit të Palasës
36. Burim i kripur i Bashajt
37. Vali i Vranishtit (burim i madh)
38. Laguna Limopuo
39. Rrepet e Buronjave Kuç
40. Pisha Flamur- Llogara
41. Rrapi Mesaplikut
42. Karthi i Tërbaçit
43. Rrapi i Dukatit
44. Rrepet e Izvorit
45. Rrapi i Tragjasit të Vjetër
46. Rrapi i Shenvarvares (Velçë)
47. Rrapi i Gurrave Smokthinë
48. Rrapi i Madh në Bashaj
49. Rrepet e Drashovicës
50. Ullinj të e Trubullit në Karbunarë
51. Pylli i Zvërnecit

Rrethi Delvinë

1. Rrapi i Muzinës
2. Rrepet e Rusanit
3. Rrepet e Delvinës
4. Pylli i Lefkës (Delvinës)
5. Pylli i Bushecit
6. Valanidhet e Dhrovjanit
7. Rrapi i Kalase
8. Melleza e Rezomes
9. Fosilet e Lefterhorit
10. Bokerimat e Muzines
11. Karsti i Delvines
12. Rruga e Gjarperit
13. Karsti i Bashajve
14. Kartsit i Gorjanit
15. Burimet e Tatzatit
16. Shpella e Tatzatit
17. Ujëvara e Kardhikaqit
18. Burimi karstik i Oknos
19. Syri i Kalter

Rrethi Sarandë

1. Rrapi i Nivices

2. Rrapi i Shenvasise
3. Rrapi i Dhivrit
4. Shkeputje tektonike e lloit shtytje – Borsh
5. Faleze e vjeter – Borsh
6. Poria (guri i Porise) Borsh
7. Gryka e Bogazit
8. Kanoini i Leshnices
9. Gjiri i Kakomese
10. Pllakat e Sarandes
11. Shpella e Konispolit
12. Shpella e Lukoves
13. Kanali i Vivarit
14. Liqeni i Rezes
15. Burimet e kripura te Mullirit (Rrezes)
16. Burimet karstike te Fteres
17. Pylli i Butrintit
18. Ishujt e Ksamilit
19. Ixuari i Borshit

PREFEKTURA E KORÇES

Rrethi Korçë

1. Guri i Prere
2. Guri i Capit
3. Piramidat e Tokes se Zhombrit
4. Bokerimat e Moglices
5. Ishulli i Malligradit
6. Vareze fosilesh te kretes se poshteme (Lavdar)
7. Mosperputhje kendore e Polenes se Vjeter
8. Burim uji dhe gazi te djegshem ne thyerjen tektonike te Polenes
9. Liqenet e Lenies
10. Lisat e Shenthanasit
11. Rrobulli i Kuq
12. Zgavra e Zaverit (Prespe)
13. Dushqet e Manastirit (Djellas Prespe)
14. Venjat e Dishnices
15. Pisha e Shendellise
16. Rrepet e qytetit (Shenmeria)
17. Shparthi i Osojes-Bakullit
18. Pisha e Voskopoje
19. Pisha e Makrezes

20. Bredhi i burimit te Çardakut (Gurit i Capit)
21. Ahishtja e Protopapes Opar
22. Bliri i Shen Pjetrit (Vithkuq)
23. Plepi i Gjyrasit
24. Pylli i perzjere i Maliqit
25. Ahishtet e Bofnjes
26. Venjat e Kallamasit
27. Rrobulli i Lenies

Rrethi Pogradec

1. Burimi i Drilonit
2. Guri i Kamjes
3. Mullaret e Gurte – Trebinje
4. Fragment i shkeputjes tektonike te grabenit te Ohrit (Pogradec)
5. Shpella e Memlishtit
6. Shpella e Radokalit
7. Shpella e Baribardhes
8. Shpella e Shen Marene
9. Mani i Shen Marenes
10. Kanioni i Llenges
11. Selvite e kishes Pogradec
12. Rrepet e Tushemishtit
13. Guret “nusja dhe dhenderi” Senisht
14. Shpella e Najazmes (Tushemisht)
15. Rrapi i Radokalit
16. Rrapi i Selces se Siperme
17. Lisi i Leshnices
18. Liqenet e Lukoves

Rrethi Kolonje

1. Banjat e avullit te Postenanit
2. Kanioni i Virkes
3. Shpella e Podes
4. Bokerimat e Piskalit
5. Dritare dhe mbulesa tektonike e Qinam-Vodices
6. Tisi i Golos (Germenj)
7. Ujevare e Rehoves
8. Travertinat (çmersat) e Blushit
9. Pusi karstik i Llokaftit
10. Lisat e Shen Merise
11. Lisat e Shenkollit (Lengeze)

12. Grumbulli i Plepit te Eger (Varishte)
13. Robujt e Badres
14. Liqeni akullnajor i Gramozit
15. Burimet termale te Vromonerit (Leskovik)
16. Rrapi i Leskovikut
17. Dafina e Cerckes
18. Korrija e Mullirit “Shen Thanasi” Gostivisht
19. Rrapi i Mbrezhdanit
20. Pishat e Pogonices (Sotires Radanj)
21. Rrepet e Glines
22. Bredhi i Shtikes
23. Selvite e Radoves
24. Korrija e Shenkollit e Vodices

Rrethi Devoll

1. Shpella e Trenit
2. Guret Mumjet e Trenit
3. Guri i Ariut (Eçmenik)
4. Burimet e Progrit
 1. Ahishtja e Shenkostandinit
 2. Pylli i Shen Thanasit
 3. Dushkaja e Dobrogoves
 4. Ahishtja e Bradvices
 5. Bredhi i Vishjes
 6. Plepat e Pilurit

PREFEKTURA E GJIROKASTRES

Rrethi Gjirokaster

1. Viroi (mema e ujit) i Gjirokastres
2. Pylli i Gurte – Nderan
3. Shpella e Vanistres (Skotinia)
4. Kanioni i Piksit
5. Tarraca e Nderanit
6. Shembja e Zhulatit
7. Gurra e Nivanit
8. Reshqitja e Kllezit
9. Reshqitja ne malin e Karparielit
10. Burimi i Libohoves
11. Burimi mineral i Glines
12. Burimi i Nepravishtes
13. Qafa e Çajupit

14. Shkembali i Zheit
15. Zhveshja e Muzines
16. Dalja e magmatikeve ne gelqeroret
afër Picarit
17. Liqeni i Kacojthit
18. Venjat e Konckes
19. Vithimat e Buretos
20. Vrimat e Konckes
21. Rrapi i Zhulatit
22. Rrapi i Fushebardhes
23. Rrapi i Mashkullores
24. Rrapishte e Mashkullores
25. Rrapi i Çerçizit -Gjirokaster
26. Rrapi i Libohoves
27. Geshtenja e Nepravishtes
28. Rrepet e Kellezit
29. Rrapi i Dhoksatit
30. Rrapi i Manastirit Stegopul
31. Rrapi i Tranoshishtes
32. Rrepet e Selos
33. Rrepet e Mullirit ne Selo
34. Perralli i Bodrishtes
35. Pishat e Kërres
36. Rrepet e Koshovices
37. Selvite e Kishes Hllomo
38. Rrepet e Çatistes
39. Lisat e Poliçanit
40. Selvite e Hllomose
41. Rrapi i Poliçanit
42. Rrapi i Nderanit
43. Lisat e Skorese
44. Lisat e Çorrokut – Sheper
45. Rrepet e shkollës - Sheperit
46. Lisat e Manastirit – Nivan
47. Rrepet e Nivanit

Rrethi Tepelene

1. Shpella Mema e Ujit
2. Sterra e Cikes
3. Shpella e Leke Petes
4. Shpella e Ujit –Dhembel
5. Vrima e Shkembit
6. Ujevare e Progonatit
7. Shpella e Kasarit

8. Kanionet e Nivices
9. Lugjet e Dhemblanit
10. Lisi i Levanit
11. Buza e Bredhit - Luzat
12. Rrapi i Selam Musait
13. Shpella e Mezghoranit
14. Shpella e Leklit
15. Burimet e Ujit te Ftohte
16. Pusi i Shendellise
17. Mogillat e Vasjarit
18. Tarraca erozive e Bençes
19. Shkembali i Prere Dukaj
20. Triavgat ne Gllave
21. Rrepet e Dervenit
22. Rrapi i Dames
23. Rrapi i Progonatit
24. Rrapi i Qesaratit
25. Rrepet e Donies -Kalivaç
26. Rrepet e Ujit te Ftohte
27. Lisi i Luzatit
28. Rrapi i Hormoves
29. Mrezhda e Zhabokikes

Rrethi Permet

1. Rrapi i Megallares- afër fshatit
Gjinakar
2. Pylli i Gerhotit, afër fshatit Zhepe
3. Bredhi i Çarshoves se Vjeter
4. Rrapi i Zhepes
5. Pylli i Çukes
6. Pylli i Ropushes
7. Horizonte vithisese dhe olistolite –
Çarçove
8. Perendi e Boroçkes (Kanioni, Guri i
Bletes)
9. Pusi i Cilikojkave afër fshatit
Çorrogunj
10. Pusi i Nemerçkes
11. Shpella e Pellumbave
12. Cirku i Nemerçkes
13. Guri i Qytetit
14. Guri i Atos – afër fshatit Kutal
15. Kanioni i Lengarices
16. Bokerimat e Dangllise

17. Gropa e Kazanit
18. Guri i Petranit
19. Kanioni i Kamenikut
20. Ujevara e Sopotit afer fshatit Sterbec
21. Ujrat Termale te Benjes
22. Uji i Zi Kelcyre
23. Rrepet e Grykes se Kelcyres
24. Bredhi i Petranit
25. Selvia e Kishes – Leuse
26. Grumbulli pyjor i Polmenit (rap +arre)
27. Rrepet e Kuqarit-
28. Bredhi i Kokojkes Frasher
29. Arra e Llukanit-Frasher
30. Geshtenja e Teqese Frasher

PREFEKTURA E LEZHES

Rrethi Lezhe

1. Rrera e Hedhur
2. Rrapi i Grykes
3. Rrepet e Kolshit
4. Shpella e Hutit
5. Shpella e Sukes se Vogel
6. Dritarja tektonike e Mirdites
7. Rivat e Drinit
8. Keneta e Kashtes
9. Rivat e Drinit
10. Rrapi i Pirajave (Blinisht)
11. Lisi i Markatomajt
12. Pylli (dushk, frasher, shkoze)i Shenmerise Kallmet (1 ha)

Rrethi Mirëdite

1. Kanioni i Shehut te Keq
2. Shpella Kusia e Nue Gjonit
3. Rrobulli i Blaçit
4. Guri i Gjonit
5. Guri i Nuses
6. Kroi i Bardhe
7. Mrizi i Shenaprenes
8. Rrapi i Kaçinarit
9. Lisat e Shpalit
10. Lisat e Marpepes

Rrethi Kurbin

1. Tarraca Detare e Laçit
2. Gryka e Shkopetit
3. Frasheri - Kurbin
4. Lisat e Shenmillit
5. Plepi i Bardhe
6. Shpella e Shenavlashit (Shennadoi)
7. Geshtenja e Vjeter
8. Rrapi i Daulles
9. Burimi i Vinjollit
10. Ishulli i Cabakut
11. Kordoni litoral i Bregut te Ri
12. Selvite e Shenmerise

PREFEKTURA E DIBRES

Rrethi Diber

1. Shpella e Gurit te Kuq
2. Karsti i Malit te Bardhe
3. Burimi dhe shpella e Sopanikes
4. Liqenet e Kasnise
5. Pasqyrat e Grames
6. Gropa e Panairit
7. Liqeni i Zi (mbi Radomire)
8. Ujevara e Poceshtes (Maqellare)
9. Bjeshka e Zonjave Zimur
10. Gryka e Setes (pjesa me e ngushte dhe me e thelle)
11. Shpella e Rusit (gryke Noke)
12. Shpella e Qytezes
13. Shpella e akullit – Bulaç
14. Burimi i Ujit te Ftohte Vleshe
15. Burimi i Kerçinit
16. Kroi i Mbretit – Serakol
17. Burimi termomineral i Llixhave te Peshkopise
18. Liqeni i Luleve (Lure)
19. Liqeni i Zi (Lure)
20. Liqeni i Madh (Lure)
21. Hartinat e Lures
22. Shllinasi
23. Guri i Kerçinit
24. Krasta e Poceshtit

25. Boroviku i Begiunecit
26. Burimet e Belloves
27. Gryka e Madhe Lure
28. Rrafshi i Korabit
29. Morenat e Fushelures
30. Cirku i Kurores se Lures
31. Kodra e Parave Billice
32. Fusha e Pelave - Lure
33. Rrapi i Kerçishtit
34. Pisha e Blliçes
35. Ahu i Blliçes
36. Lisi i Dobit
37. Vakufi i Çanges
38. Lisi Kabe
39. Vakufi i Sines se Siperme
40. Rrobulli i Lures
41. Rrapi i Çidhnes

Rrethi Bulqize

1. Druri i Male Zeqirit – Zerqan
2. Zabeli i Madh Zerqan
3. Shpella e ures se qytetit
4. Shkemi i Qytetit
5. Tre çesmat e Zerqanit
6. Bregu i Pepese (qarri i Pepese)
7. Qarri i Muharremit
8. Gurra dhe shpella e Zerqanit
9. Gurra e Vakefit te Zerqanit
10. Liqeni i Zi – Martanesh
11. Ujevare e Duriçit
12. Xixell Martanesh
13. Shpella e Xixëlles Valikardhe
14. Qarri i Allushit Valikardhe
15. Shpella e Ftohte Gjuras
16. Qarri i Kovashices
17. Vakufi Zerqan
18. Qarri Gjinovec
19. Pisha Zogje
20. Qarri Peladhi (Zerqan)

Rrethi Mat

1. Guri i Gjate – Urxuall
2. Kepi i Skenderbeut Varosh
3. Kanioni i Urakes

4. Rrapi i Marqethit
5. Lisi i Qershizes
6. Puset e Valzes
7. Maja e Boshtres (Macukull)
8. Gurri i Vashes
9. Lisi i Tushes, Frankth
10. Lisi i Bershinit
11. Kanioni i Filmit
12. Kroj i Gjeneralit (Gur i Bardhe)
13. Tisat e Mbasdejes
14. Lisat e Lam Pores
15. Burimi i Shutrese
16. Geshtenja e kalit e Gurrit te Bardhe – Mat
17. Lisi Qafe Shenkollit
18. Rrapi i pazarit te Klosit
19. Qarri i Bardhe ne Sheshaj
20. Lisi i Fushe Lores ne Barbullej
21. Lisi i Bershinit – Bershi
22. Vidhi i Patllit Suç
23. Lisat e Pores – Macukull
24. Lisi varreve te Rexhes (Macukull)–
25. Lisi Macukull (Varrit te Mire)
26. Lisi i Varrit te Turkut
27. Lisat e shkollës ne Macukull
28. Vidhi i Qafe Shenkollit (Dukagjin)
29. Lisi te varret e Shqypit (Barbullej)
30. Lisi i koder varreve (Urxuall)
31. Lisi te varret e Kurrmetes (Shqefen)
32. Lisi i Bushkashit
33. Lisi i Teqese se Domit
34. Rrapi i Çeles – Patin
35. Lisat e Kishes Groshot
36. Lisat e Xhamise Remull
37. Rrapi i Zabelit – Gurre e Madhe

PREFEKTURA E KUKESIT

Rrethi Kukës

1. Pisha e Gjeganit
2. Gryka e Çajes
3. Cirku akullanajor i Zepes
4. Kroj i Bardhe
5. Kanioni i Bicajt

6. Kanioni i Vanave
7. Lisat e Kalisit
8. Karsti i Arnit
9. Keneta e Kuksit
10. Kroi i Kuq Gjallice
11. Guri i Mengjezit Shishtavec
12. Guri i Shqipës (Borje)
13. Burimi i Kolosianit
14. Dushkajat e Novoseit
15. Meshtekna e Shishtavecit (liqeni i Kallabakut)
16. Rrobulli i Lakut te Topojanit

Rrethi Has

1. Burimi i Krumes
2. Burimet e Brudit
3. Gurra e Vranishtit
4. Gurra e Domajve
5. Pisha e Gjinajve
6. Shpella e Pellumbave
7. Shpella me oborr
8. Shpella qe tingellon Mazrek
9. Maja e Qytetezes
10. Ahishtja e Liqenit te Kuq
11. Pisha ne Gjinaj

Rrethi Tropoje

1. Rasa e Pecmarres
2. Shpella e Haxhise
3. Liqenet akullnajore te Doberdolit
4. Liqenet akullnajore te Sylbices
5. Shkemi i Forces
6. Burimi Karstik i Qirecit
7. Rasa e Currajt
8. Depozitimet fluvio-glaciale te Shoshajt
9. Depozitimet fluvio-glaciale te Shemtires
10. Bredhishtja e Ragamit
11. Shelgu i Rrjetezuar
12. Burimi i Qukut te Dunishes
13. Burimi i Shoshanit
14. Burimet e Valbones
15. Shpella e Haxhise

16. Shpella e Akullit
17. Lugina e varur akullnajore e Kukajt
18. Lugina Akullnajore e Motines
19. Kanioni i Shoshanit
20. Blijte ne Markaj
21. Dushkajat e Qafe Luzhes
22. Liqeni i Ponareve
23. Meshtekna e Lugut te Zi
24. Ahishtja Gurra e Hasan Gashit (Mertur)
25. Rrobulli ne liqenin e Ponareve
26. Arra e Dragobise
27. Shpella e Dragobise
28. Hormoqi i Valbones
29. Ahishtja e Vranices

PREFEKTURA E SHKODRES

Rrethi i Shkodres

1. Burimi i Vrakes
2. Olistolit e Kodres se Tepese
3. Mbihipja tektonike e Shirokes
4. Fragment i Thyres tektonike Shkoder – Peje (Karme)
5. Blloku Gravitativ e Gurit te Zi
6. Ujevara e Thethit
7. Rasa e Palajve
8. Guri i Lekes
9. Shpella e Gjeçovit
10. Portat e Shales
11. Shpella e Thethit
12. Shpella e Gajtani
13. Pragu i Kapreit
14. Shpella e Jubanit
15. Cirku i Gropes se Bukur se Jezceres
16. Burimet e Shtarzes
17. Liqeni i Jezceres
18. Pisha Flamur e qafes se Pejes
19. Ura shkembore e Markzagores
20. Burimet e Okolit – Thethit
21. Shpella e Majes se Arapit
22. Liqeni i Pejes
23. Geshtanjat e Mguilit (Pult)
24. Bliret ne Lesniqe

25. Kanioni i ures se Shtrenjte
26. Shpella e Zhyles
27. Shpella e Melagjise
28. Shpella e Muriqit
29. Kanioni i Grunasit
30. Kerleka e Kakise
31. Shpella e Liqethit Cukal
32. Burimet e Kirit
33. Habitati i Salamandres Alpine
34. Shpella e Kataraktit
35. Fusha e Liqethit
36. Pylli i ishullit te Franc Jozefit
37. Lisat e Minaqit (Domne)
38. Rrepet e Vorrezave te Ramajt
39. Rrapi i Hoxhe Dheut
40. Çinari i Tophanes
41. Rrapi i Toplanes
42. Ahet e Gurrese se Krenave

Rrethi Puke

1. Shpella e Kaurit
2. Fosilet e Kçires
3. Peneplena e Gomsiqes
4. Guri i Shenjte
5. Geshtenjat e Kokdodit
6. Bungat e varrezave ne Korthpule
7. Qarret e varrezave te Shenkollit ne Kryezi

8. Qarri i Xhamise se Kryeziut

9. Ujevara e Kryeziut

10. Mrizi i Nderlugjeve

11. Mani i Zi

12. Hurdha e Tisit

13. Sofra e Lekes

14. Karsti i Munelles

15. Pisha e Dardhes

16. Akacjet e Migjenit

17. Pisha e Shejzes

Rrethi Malesia e Madhe

1. Syri i Sheganit

2. Fortesa e Kelmendit

3. Burimet e Koprishtit

4. Syri i Gjonit

5. Shpella e Krevenices

6. Morenat e Razmes

7. Cirku i Livadhut te Boges

8. Burim i Vuklit

9. Blini i Bzhetes

10. Vidhat tek pusi i Markajve

11. Ahu i Gerçes (Mrizi i Gerçes)

12. Carraca e Vrithit

13. Tarraca e Greçes

14. Shpella e Gjolaive

15. Kanioni i Bashkimit Vermosh

16. Mrizi (ahu) i Pleshtit (Boge)

17. Vulfenia e Shtegut te Dheneve

18. Mullaret e Radit (Rapsh)

19. Arra e Madhe

20. Foljeta e Lohjes

21. Çinari (Foljeta) e Ganjollit

22. Shpella e Pucit

23. Pusi i Xhek Markut

24. Shpella e Njerezve te Lagur

25. Kanioni i Poices

26. Mullaret e Gurte te Bajzes

27. Pusi i Cilikokajve

28. Kalaja e Shtegut te Dheneve

29. Lugu akullnajor i Runicës

30. Depozitimet fluvio-glaciale te Boges

31. Lugu akullnajor i Seferçes

32. Geshtenja e Reçit

PREFEKTURA E DURRESIT

Rrethi Durresi

1. Kepi dhe Faleza e Rodonit

2. Plazhi i Kallmit

3. Çinari i Balliasit

4. Plazhi i Shenpjetrut

5. Shkëmbi i Kavajës

6. Rrapi i Rubjekës

7. Pylli i Kolndrekajve – Ishëm

Rrethi Kruje

1. Sarisalltëku dhe shpella

2. Gryka e Vajës

3. Gryka e Zeze

4. Selvia e Fushekrujes

5. Rrapi i Buranit

6. Masivi i pishes se Zeze Qafe Shtame
7. Kroi i Nenes Mbretereshe
8. Rrapi ose Çinari i Bretit
1. Rrapi i Ballabanecit
2. Rrapi i Taslloit
3. Rrepet e Aramerasis - Fushë Krujë

PREFEKTURA E TIRANES

Rrethi Tirane

1. Bokerimat e Mustafa Koçajt
2. Shpella e Shutresë
3. Shpella e Zezë (Pëllumbasit)
4. Shpella e Valit
5. Tarraca detare e Dajtit
6. Karsti i Malit me Gropa
7. Gryka e Skoranës
8. Gryka e Murdarit
9. Shkalla e Tujanit
10. Bokerimat e Mnerit
11. Rrapi i Priskës
12. Rrapi i Kranës – Dajt
13. Rrapi i Ndroqit
14. Arra e Babë Myslymit

Rrethi Kavaje

1. Plazhi i Gjeneralit
2. Faleza e Bardhorit
3. Plazhi i Carrinës
4. Fosilet detare të Thartorit
5. Burimet sulfurore të Fliballies
6. Shpellat karstike në gjips
7. Karsti në gjipsin e Mengajve
8. Burimet e kripura të Golemasit
9. Dafina e Kalase se Turres
10. Gurret ne Rrjesht
11. Lisi i Cikalleshit

PREFEKTURA E BERATIT

Rrethi Berat


1. Lisi i Çesmes se Prokopise
2. Shpella e Kapinovës
3. Shpella e Shahinovës

4. Geshtenjat e Mimasit
5. Lisi i Pashallise
1. Rrapi i Lybeshes
2. Rrapi i Veleshnjes
3. Rrapi i Burimit, Paftal
4. Pylli i Kulajve, Velçan
5. Rrapi i Zhitomit
6. Ulliri i Drobonikut ne Palikesh


Rrethi Skrapar

1. Stera e Katofiqit
2. Stera e Prosekut
3. Shpella e Pirogoshit
4. Sterra e Kakrukës
5. Bokerimat e Tomorrices
6. Lisi i Baba Fetahut
7. Arra e Madhe e Zhepes
8. Kanioni i Osumit
9. Kanioni i Gradecit
10. Cirqet akullnajore te Tomorrit
11. Lisi i Osojes
12. Trasgesioni i Paleogjenit te sipërme ne qafen e Devries
13. Karsti i Qafes se Devries
14. Burimi i Guakut
15. Lisi i Munushtirit
16. Sterra Uvlen (pusi i Ramies)
17. Stera e Bores
18. Morenat e Ujanikut
19. Vrima e Dragoit (Kuçedres)
20. Qafa e Kulmakut
21. Plepat, Konak te Tomorrices -
1. Rrapi i Verseshtes
2. Ahishtja e Leshnjes
3. Rrobulli i Kulmakes
4. Pishat e Gurrit te Prere, Greve
5. Rrapi i Verzhzhes
6. Koshnica
7. Bredhi i Kuçit
8. Ahishtja e Symizes
9. Ahishtja e Lirzes
10. Arrat ne Novaj
11. Dushkaja e Tendes se Qypit

Tema: Trashëgimia kulturore e trevave shqiptare



Tema: Mjedisi i trevave shqiptare dhe problemet e tij mjedisore



KREU: REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Linja V: Rajonet gjeografike

Tema: Republika e Shqipërisë

Pozita gjeografike e Republikës së Shqipërisë

Republika e Shqipërisë ndodhet në skajin më jugor të gjerësisë mesatare në Hemisferës Veriore, në Evropën Juglindore, në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik, me dalje të gjerë në detet Adriatik dhe Jon. Ajo gjendet midis koordinatave gjeografike 39038' (në jug të Konispolit) dhe 42039' (në veri të Vermoshit) të gjerësisë gjeografike veriore dhe 19016' (në ishullin e Sazanit) dhe 2104' (në fshatin Vërnik të Korçës) të gjatësisë gjeografike lindore. E shtrirë nga veriu në jug me një gjatësi 335 km dhe nga perëndimi në lindje me një gjerësi 150 km, Republika e Shqipërisë ka një sipërfaqe 28748 km². Gjatësia e përgjithshme e kufijve të saj është 1094 km, ku 658 km janë kufij tokësorë, 316 janë kufij detarë, 72 km kufij liqenorë e 48 km kufij lumorë. Republika e Shqipërisë, kufizohet nga veriperëndimi deri në veri me Malin e Zi, nga veriu deri në verilindje me Kosovën, në lindje me Maqedoninë, në juglindje e jug me Greqinë dhe në perëndim laget nga dy detet e Mesdheut (Deti Adriatik dhe Deti Jon). Ka **rëndësi gjeografike, rëndësi strategjike, rëndësi ekonomike dhe rëndësi social-kulturore.**

Republika e Shqipërisë

Hapësira e Republikës së Shqipërisë ndahet në katër rajone të mëdha:

1. Rajoni Verior dhe Verilindor;
2. Rajoni Juglindor;
3. Rajoni Jugor;
4. Rajoni Perëndimor.

Kushtet natyrore të Republikës së Shqipërisë

Trualli i Republikës së Shqipërisë, përbëhet nga një **ndërtim gjeologjik** i shumëllojshëm, me shkëmbinj të moshave e origjinave të ndryshme, të cilët i janë nënshtruar rrudhosjeve, rrafshimeve, thyerjeve dhe diferencimit tektonik. Si rezultat i shumëllojshmërië shkëmbore, nëntoka shqiptare është e pasur me pasuri të shumta minerare.

Relievi i Republikës së Shqipërisë, ka karakter kodrinoro-malor dhe dallohet për shkallën e lartë të copëtimit vertikal dhe horizontal dhe për pjerësinë e madhe të shpateve. Lartësia mesatare e relievit është 708 m mbi nivelin e detit, ajo maksimale arrin në 2751 m (në Korab) dhe më e vogël -8 m (në ish-kënetën e Tërbufit).

Klima e Republikës së Shqipërisë është subtropikale mesdhetare me dimër të shkurtër, të butë e të lagësht dhe verë të gjatë, të nxehtë e të thatë.

Hidrografia është tepër e pasur dhe përfaqësohet me dete, liqene, laguna, lumenj, ujëra nën-tokësore dhe burime të shumtë.

Tokat, ndryshojnë nga njëra zone në tjetrën nga cilësitë morfologjike, kimike, fizike dhe mineralogjike. Ato gjenden në trajtën e tokave zonale (tokat e hirta kafe, e kafenjta, të murme pyjore, livadhore malore) dhe azonale (toka aluvionale, kënetore, të kripura).

Bimësia është e shumëllojshme dhe dallohet edhe për prani të bimëve endemike dhe subendemike. Në Republikën e Shqipërisë rriten 3250 lloje bimësh ku 1% e tyre janë bimë endemike dhe 5 % subendemike. Në drejtim vertikal, bimësia është e ndarë në kate: në katin e shkurreve mesdhetare, të dushkut, ahut e halorëve dhe të kullotave alpine.

Bota shtazore e pasur dhe prezantohet në formën e faunës tokësore dhe ujore.

Tema: Popullsia në Republikën e Shqipërisë

Numri i popullsisë në Republikën e Shqipërisë

Popullsia e Republikës së Shqipërisë **ka ardhur gjithmonë në rritje**. Rritje më të madhe, popullsia ka shënuar nga viti 1955-1989. Kjo lidhet me rritjen e nivelit të lindshmërisë (e cila stimulohej edhe nga politikat shtetërore) dhe me uljen e nivelit të vdekshmërisë. Në Regjistrimin e vitit 2001, numri i përgjithshëm i popullsisë rezultoi 3 069 275 banorë, ndërkohë që nga parashikimet e bëra bazuar në ritmet e shtimit të popullsisë (të deri 1989), ky numër duhet të ishte më i lartë. Numri i popullsisë në vitin 2001 rezultoi më i ulët se parashikimi, për shkak të ndikimit të dy faktorëve:

1. Emigracioni masiv i shqiptarëve pas '90. 2. Ulja e nivelit të lindshmërisë, që erdhi si rezultat i emigrimit kryesisht të moshës së re (fertilë), rritjes së moshës së martesave dhe aplikimit të politikave të planifikimit familjar.

Popullim i hershëm

Objektet e ndryshme arkeologjike dëshmojnë që në epokën e hekurit, territori i Shqipërisë banohej nga ilirët. Ilirët ishin një nga popullsitë e mëdha të Evropës së atëhershme që shtriheshin në gjithë pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik. Në shekujt që pasuan, që nga mesjeta e hershme e deri në shekullin XII, kjo popullsi u quajt arbër, si rezultat i lindjes dhe fuqizimit të formacionit shtetëror të Arbrit (i cili ishte vazhdim i fisit ilir albanoi gjatë antikitetit), ndërsa nga shek. XIII e në vazhdim, ajo u quajt shqiptare.

Popullsia në Republikën e Shqipërisë

Struktura e popullsisë

Në **strukturën e popullsisë sipas moshës**, Republika e Shqipërisë dallohet për peshën e madhe që zënë grupmosha e re dhe grupmosha e punës, në popullsinë e përgjithshme të vendit. Mosha mesatare e popullsisë së veçdit është 29 vjeç.

Në **strukturën e popullsisë sipas gjinisë**, edhe pse tradicionalisht popullsia mashkull ka pasur përqindje më të lartë se ajo femër, në regjistrimin e vitit 2001 u vu re një rritje e lehtë e përqindjes në favor të popullsisë femër (50,1 %), në krahasim me elementin mashkull (49,9 %). Ky ndryshim i raportit lidhet me dukurinë e emigracionit të pas vitit '90 dhe me jetëgjatësinë më të madhe të femrave se sa të meshkujve. Në **strukturën e popullsisë sipas vendbanimeve**, 57.9 % të popullsisë së përgjithshme e përbën popullsia rurale dhe 42.1 % të asaj e përbën ajo qytetare. Karakteristike për Republikën e Shqipërisë është që popullsia urbane ka ardhur vazhdimisht në rritje.

Struktura etnike e popullsisë. Republika e Shqipërisë përbëhet nga popullsi homogjene shqiptare, pra 98 % e popullsisë së përgjithshme përbëhet nga popullsi shqiptare dhe vetëm 2 % pakica kombëtare (greke, maqedonase dhe malazeze). Pjesë e popullsisë janë edhe pakicat gjuhësore arumune e rome.

Struktura fetare e popullsisë. Në Republikën e Shqipërisë, bashkëjetojnë në mënyrë paqësore dy fe: islamike (myslimanë, bektashinj) dhe e krishterë (ortodoksë dhe katolikë), ku pjesa më e madhe i përket besimit islamik.

Shpërndarja e popullsisë

Shpërndarja gjeografike e popullsisë nuk është e njëjtë në të gjithë hapësirën e RSH, pasi është ndikuar prej disa faktorëve:

1. Faktori natyror, që ka dominuar për një periudhë të gjatë kohore, deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore.
2. Faktori demografik, ka qënë faktor i përhershëm i rritjes së dendësisë së popullsisë dhe njëkohësisht ka ndikuar në shpërndarjen e pabarabartë të popullsisë në vend. Në zonat rurale, për vetë natyrën e punëve, numri i lindjeve ka qënë më i lartë se në zonat urbane, megjithëse pas '90, ai ka pësuar ulje.
3. Faktori politiko-ekonomik, ka ndikuar ndjeshëm në periudha të ndryshme. Politika e industrializimit (ndërtimi i objekteve industriale) të vendit dhe hapja e tokave të reja solli përqëndrime të ndryshme të popullsisë midis zonave, megjithëse lëvizja e individit brenda vendit ishte e kontrolluar dhe emigracioni i jashtëm ishte i ndaluar. Pas viteve '90, aplikimi i ekonomisë së tregut, mbyllja e disa sektorëve dhe ndërmarrjeve ekonomike me teknologji të vjetër, lejimi i lëvizjes së lirë të individit dhe emigracioni masiv i shqiptarëve, sollën ndryshime të mëdha në shpërndarjen e popullsisë në vend.

Më tepër informacion, i cili mund ti serviret nxënësve:

Regjistrimi i Përgjithshëm i popullsisë dhe Banesave, INSTAT , 01 Prill 2001

Rrethet	Popullsia	Dendësia	Popullsia urbane	Popullsia rurale	0-14 vjeç	15-64 vjeç	Mbi 65 vjeç
Berat	127837	136.1	45572	82265	36791	82771	8275
Bulqizë	42968	91.6	9987	32981	15113	25462	2393
Delvinë	10765	30.9	4100	6665	2396	6728	1641
Devoll	34641	80.8	6729	27912	8570	22565	3506
Dibër	85699	78.7	14017	71682	29954	50930	4815
Durrës	181662	419.6	113465	68197	52484	115283	13895
Elbasan	221635	161.5	95554	126081	65988	141606	14041
Fier	199082	253.5	76166	122916	57658	126659	14765
Gramsh	35750	51.5	10533	25217	11527	22122	2101
Gjirokastrë	54647	48	22866	31781	14149	35255	5243
Has	19660	50	3215	16445	7837	10873	950
Kavajë	78179	188.7	28149	50030	24956	47002	6221
Kolonjë	17161	21.3	7490	9671	4368	11037	1756
Korçë	142909	81.6	58911	83998	35403	93241	14265
Krujë	63517	190.8	19372	44145	20377	39241	3899
Kuçovë	35338	420.2	18038	17300	9817	22946	2575
Kukës	63786	68	16621	47165	23596	36794	3396
Kurbin	54392	199	23455	30937	17311	33641	3440
Lezhë	67734	141.3	16592	51142	20821	42036	4877
Librazhd	72387	70.7	11550	60837	23526	44612	4249
Lushnjë	143933	202	38336	105597	42139	91845	9949
M e Madhe	36692	66.2	4078	32614	11518	21956	3218
Mallakastër	39529	100.6	9154	30375	11988	25009	2532
Mat	61187	59.5	13948	47239	19977	37054	4156
Mirditë	37056	42.7	9240	27816	11369	22902	2785
Peqin	32964	303.3	7267	25697	10835	20209	1920
Përmet	25780	27.7	9860	15920	6704	16445	2631
Pogradec	70471	97.2	23762	46709	20413	45059	4999
Pukë	34386	33.3	6031	28355	11529	20580	2277
Sarandë	35089	46.9	14553	20536	9025	22128	3936
Skrapar	29845	38.5	13257	16588	8158	19554	2133
Shkodër	185395	94	85798	99597	54045	115572	15778
Tepelenë	32404	39.6	11287	21117	9307	20472	2625
Tiranë	519720	419.6	352581	167139	138619	339764	41337
Tropojë	27947	26.8	7482	20465	9197	16834	1916
Vlorë	147128	91.4	85180	61948	41373	92887	12868

Tema: Ekonomia e Republikës së Shqipërisë

Veçoritë e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore

Gjatë periudhës deri në vitin 1945, ekonomia e Shqipërisë ishte e prapambetur dhe e varur nga të ardhurat që siguroheshin nga bujqësia e blegtoria. Rendimentet në bujqësi ishin të ulëta, kulturat bujqësore ishin të kufizuara në lloje dhe shfrytëzohej jo e gjithë sipërfaqja e tokave të puneshme. Blegtoria dallohej për rendimentin e ulët dhe mbarështim të kufizuar në lloje. Industria përfaqësohej: me zejet e ndryshme që ishin më të përhapura në Tiranë, Shkodër, Korçë, Berat, Gjirokastrë, Krujë etj.; me zonat e nxjerrjes së naftës, gazit e bitumit (në Kuçovë dhe Selenicë) dhe me përpunimin e disa produkteve bujqësore e blegtorale. Përveç tyre, zhvillohej edhe tregëtia, por ishte me kapacitete të ulëta dhe ishte e përqëndruar kryesisht në Tiranë dhe në zonat bregdetare të vendit.

Ekonomia e Republikës së Shqipërisë

Veçoritë e zhvillimit ekonomik në periudhën post-komuniste

Pas vitit 1991 e në vazhdim, Shqipëria u fut në rrugën e zhvillimit të ekonomisë së tregut dhe të vendosjes e zgjerimit të marrëdhënieve politike, ekonomike e shoqërore me vendet perëndimore, duke synuar edhe integrimin në BE. Në vitin 1992 filloi privatizimi i pronës shtetërore, i tokës bujqësore, i bazës blegtorale dhe i gjithë asetëve të tjera të fermave kolektive. Në sektorin bujqësor, raporti midis kërkesës dhe ofertës, solli kufizimin e sipërfaqeve të një sërë kulturave bujqësore. Është ulur sipërfaqja e mbjellë me drithëra, është kufizuar ndjeshëm sipërfaqja me bimë industriale (pambuk, duhan, panxhar sheqeri) dhe është rritur sipërfaqja e mbjellë me bimë foragjere.

Veçoritë e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë gjatë periudhës 1945-1990

Gjatë periudhës 1945 -1991 ekonomia e vendit u mbështet në planifikimet e planeve 5-vjeçare dhe u orientua drejt modeleve ekonomike lindore, të një ekonomie të centralizuar. Të gjitha mjetet e prodhimit u kontrolluan nga shteti, bujqësia dhe industria u bënë pronë shtetërore dhe sipërmarrja private u ndalua rreptesisht. Në bazë të Kushtetutës së Republikës Socialiste të Shqipërisë ndalohej ndihma nga jashtë dhe investimet e huaja dhe zhvillimi mbështetej vetëm në forcat e brendshme. Meqënëse objektivi i qeverisë ishte, që vendi të quhej industrialo-bujqësor, u vu prioritet zhvillimi i industrisë dhe sidomos zhvillimi i industrisë së rëndë dhe bujqësia kaloi në plan të dytë. Pavarësisht prioritetit industrial, ekonomia bujqësore mbante peshën kryesore të ekonomisë, pasi ishte sektori që punësonte pjesën më të madhe të popullsisë dhe që siguronte të ardhurat më të mëdha në buxhetin e shtetit.

Degët e ekonomisë

Ekonomia bujqësore, energjetika, industria e lehtë, industria ushqimore, ndërtimtarja, industria nxjerrëse e mineraleve, industria metalurgjike dhe ajo mekanike, turizmi, transporti, sektori i shërbimeve dhe i tregëtisë dhe artizanati.

Tema: Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Nënrajonit Verior

Pozita gjeografike e Alpeve

Alpet Shqiptare ndodhen në pjesën më veriore të Republikës së Shqipërisë dhe kanë një sipërfaqe prej 2020 km². Ato përfaqësojnë hapësirën më të lartë të Republikës së Shqipërisë dhe krahinën më të vogël natyrore të vendit tonë. Në jugperëndim Alpet kufizohen me Ultësirën e Mbishkodrës dhe në jug me lumin Drin. Në juglindje kufiri ndjek luginën e Valbonës së poshtme dhe të Bushtricës, kalon në Tropojën e vjetër dhe në Qafë Morinë. Në veriperëndim, veri dhe verilindje, kufiri i krahinës përputhet me kufirin politik të RSH.

Nënrajonit Verior

Kushtet natyrore

Ndërtimi gjeologjik: mbizotërojnë gëlqerorët e mesozoikut, por janë të pranishëm edhe terrigjenët e vjetër, fliшет të reja dhe shkëmbinj të magmatikë. Ka struktura tektonike të larmishme. Alpet kanë një *reliev* me kontraste, në formën e një kupole, e cila në pjesën qendrore është më e ngritur dhe ulet gradualisht drejt periferisë, në formë rrezore. **Klima** është malore, me dimër të gjatë e të ftohtë dhe verë të shkurtër e të freskët. **Hidrografia** është e pasur dhe e shumëllojshme. Maksimumi i rrjedhjes, këtu arrihet në pranverë, pasi furnizohet nga shkrrirja e dëborës. **Tokat** më të përhapura janë tokat livadhore malore, tokat e murrme pyjore dhe tokat e kafenjta malore. **Bimësia** karakteristike është ajo e shkurreve, e dushqeve, e ahishteve dhe e halorëve, si dhe e kullotave alpine. Edhe **fauna** është e pasur dhe e shumëllojshme (gjitarë, shpendë, amfibë dhe zvarranikë).

Njësitë kryesore të Alpeve dhe karakteristikat e tyre

Blloku i Jezercës, që ndodhet në qendër të Alpeve dhe qarkohet nga thyerje të fuqishme tektonike. Përbëhet nga shkëmbinj gëlqerorë, maja me lartësi mbi 2000 m dhe të modeluara nga veprimtaria akullnajore. **Malësia e Madhe**, që përbëhet nga blloqe malorë, kurrize malorë, gropa dhe lugina lumenjsh e përrenjsh, ka reliev të modeluar nga veprimi i karstit. **Malësia e Gashit**, që përbëhet prej magmatikëve, ka reliev të ashpër, pyje e kullota të shumta, si dhe për prani të liqeneve akullnajorë. **Nikaj-Mërturi**, që ka lartësi të mëdha, dhe përbëhet prej gëlqerorëve e terrigjenëve. **Lugina e Valbonës**, është një nga luginat më mëdha e më të bukura të Alpeve, që në rrjedhjen e sipërme është një luginë akullnajore. Burimet e saj, zënë fill nga disa burime karstike në rrëzë të shpatit të Qafës së Valbonës. **Lugina e Shalës**, shtrihet në qendër të Alpeve në një reliev me kontraste dhe prani të ngushtimeve. Në formimin e saj ka ndikuar shumë akullzimi i kuaternarit.

Tema: Popullimi dhe ekonomia në Alpet Shqiptare

Popullimi i Alpeve Shqiptare

Në Iliri, Alpet populloheshin nga fisi i labeatëve, ndërsa në mesjetë, lulëzimi i qyteteve u shtri edhe në Alpe. Periudhat në vazhdimësi, u shoqëruan me rritje të numrit të popullsisë dhe me shtim të vendbanimeve urbane dhe rurale. Rritjen dhe dendësinë më të madhe, popullsia e Alpeve e arriti gjatë periudhës 1945-1990, ndërsa pas vitit 1990 numri i popullsisë pësoi rënie. Kjo erdhi sepse pati emigrim të brendshëm dhe të jashtëm. Emigrimi i brendshëm, synoi drej rajoneve më të ulëta, kryesisht drejt fushës së Nënshkodrës dhe rajonit Tiranë-Durrës, ndërsa emigrimi i jashtëm, që përfshiu më tepër moshat e reja, u drejtua drejt Greqisë, Italisë, Anglisë dhe Amerikës.

Popullimi dhe ekonomia në Alpet Shqiptare

Vendbanimet, struktura e popullsisë dhe traditat e saj

Popullsia është e përqëndruar më tepër në tarracat dhe zgjerimet lumore si dhe në shpatet me pjerrësi të vogël. Dendësi më të madhe të popullsisë ka në luginën e Valbonës dhe në atë të Shalës. Në strukturën sipas vendbanimeve, ato rurale zënë përqindjen më të lartë. Vendbanimet janë të vogla dhe të vendosura deri në lartësinë 800 m. Popullsia qytetare zë 12,3 % të rajonit dhe si qendër urbane dallohet qyteti i B.Currit. Në vendbanimet rurale, janë tipike ndërtimet në trajtë kullash dhe me distancë midis tyre. Karakteristike është vendosja e popullsisë në krahina etnografike. Banorët ruajnë mirë traditat e tyre historiko-kulturore. Kjo evidentohet përmes organizimit të shumë festave dhe lojrave të vjetra tradicionale.

Ekonomia e Alpeve dhe trashëgimia natyrore e kulturore e tyre

Turizmi: sidomos turizmit malor, që mund të realizohet në çdo stinë të vitit. **Artizanati:** me prodhimin e veshjeve popullore, sixhadeve, produktet e zbukurimet prej druri dhe veglat muzikore (çifteli, lahutë, sharki). **Blegtoria** është degë e favorizuar që dallohet për rritjen e bagëtisë së imët. **Ekonomia pyjore**, përfaqësohet me disa stabilimente sharre. **Bujqësia:** nuk ka pasur mundësi të shumta zhvillimi për shkak të sipërfaqeve të kufizuara të tokës të punueshme. Kulturat tipike, për të cilat dallohet kjo trevë janë: patatja, gështenja dhe kumbulla. **Mineralet** më të shumta janë: polimetalet, boksitet dhe guri gëlqeror. **Transporti** ka një rrjet të vështirë rrugor.

Tema: Nënrajoni verilindor

Kushtet natyrore

Ndërtimi gjeologjik: Dominojnë shkëmbinj të e ndryshëm magmatikë intruziv e efuziv, sidomos ata ultrabazikë, por edhe shkëmbinj të sedimentarë, të tipit karbonatikë dhe terrigjenë **Relievi**, përbëhet nga vargje malorë, kurrize malorë, malësi, blloqe malorë, male të veçuar, kodra, lugina lumore gjatësore e tërthore dhe gropa. Relievi fillon nga lartësia 100-150 m në disa lugina në perëndim, deri në 2751 m në Korab dhe është shumë i copëtuar. **Hidrografia:** përfaqësohet nga lugina gjatësore dhe

Pozita gjeografike e rajonit

Rajoni Verilindor i Shqipërisë, shtrihet midis luginës së Drinit në veri dhe luginës së Shkumbinit të Mesëm në jug. Kufiri perëndimor, fillon nga kufiri lindor i Fushës së Nënshkodrës, vazhdon përgjatë rrëzës perëndimore të Vargjeve të Skënderbeut dhe zbrit deri në Shkumbinin e Mesëm. Në lindje, rajoni kufizohet prej kufirit politik të RSH me Kosovën dhe Maqedoninë. Rajoni, ka funksion të rëndësishëm lidhës. Pozicioni gjeografik i tij, ndikon për lidhjen midis tyre të të gjitha rajoneve të RSH, por edhe për lidhjen e tyre me trevat shqiptare jashtë kufirit.

Nënrajoni verilindor

Popullimi dhe trashëgimia kulturore

Rajoni është banuar që në lashtësi. Në antikitet hapësira banohej nga albanët, dhe penestët. Kultura e Komanit, që ndodhet në këtë rajon, përfaqëson kulturën e kombit shqiptar të shek VI-VIII, të kalimit gradual nga antikiteti ilir në mesjetën arbërore. Popullsia e rajonit, brez pas brezi, ka pasuruar një trashëgimi kulturore të pasur. Folklori, larmia e veshjeve popullore, gatimet tradicionale, etj., e kanë karakterizuar atë.

Pasuritë natyrore dhe ekonomia

Një nëntokë e pasur: me minerale metalike si bakër dhe krom, por edhe me gurë ndërtimi e zburkimi, mermere, inerte të shtretërve të lumenjve, argjila kaolinike, etj. Rajoni përmban **fondin më të madh pyjor**, qoftë si lëndë drusore ashtu edhe si lëndë zjarri. **Pasuria ujore:** Rajoni verilindor ofron rezervat më të mëdha hidroenergjitike të vendit. **Turizmi.** Rajoni ofron mundësi të shumta për zhvillimin e turizmit të bardhë, ekologjik dhe sporte dimërore. **Ekonomia bujqësore:** kulturat më të përhapura janë patatja, fasulja, molla, dardha, kumbulla, arra, etj., të cilat përbëjnë një burim të rëndësishëm ekonomik për jetën e banorëve.

Dinamika e popullsisë dhe vendbanimet

Rajoni karakterizohet nga një numër i vogël i popullsisë në raport me sipërfaqen e tij dhe nga një shpërndarje të pa-barabartë gjeografike saj. Më të populluara, janë terracat lumore dhe gropat, në të cilat janë përqendruar edhe shumica e vendbanimeve, ndërsa në terrenet malore popullimi është më i pakët. Deri në vitin 1990, popullsia ka ardhur gjithmonë në rritje. Pas këtij viti, mbyllja e minierave në Kalimash, Kurbnesh, Bul-qizë, Batër etj. dhe e industrive përpunuese në Rubik e Klos, u shoqërua me një rënie të numrit të popullsisë. Kjo rënie, erdhi si rezultat i emigrimeve të popullsisë. Popullsia e emigruar, u drejtua kryesisht drejt rajonit Perëndimor (sidomos në rajonin Tiranë-Durrës) dhe jashtë kufijve të vendit. Ritmet e lindjeve edhe pse kanë pësuar ulje, janë të larta krahasuar me rajonet e tjera. Vendbanimet rurale janë në numër më të madh se sa ato urbane.

Njësitë përbërëse të rajonit

Malet e vargjet malorë, malësitë dhe luginat e rajonit sipas veçantive që paraqisin, ndahen në disa njësi përbërëse. Dallohet: Malësia e Gjakovës dhe e Hasit, Vargu malor i Korabit, Lugina e Drinit të Zi, Vargjet e Lurës, Malësia Pukë-Mirditë, Pellgu Klos-Kalivaç, Vargjet e Skënderbeut dhe Malësitë Martanesh, Cermenikë, Gollobordë

Tema: Disa njësi përbërëse të Nënrajonit Verilindor

Malësia e Gjakovës dhe e Hasit: ndahen prej përroit të Skatinës. Këto malësi, janë prekur nga lëvizje neotektonike diferencuese dhe kanë një *ndërtim gjeologjik* të ndryshëm. Malësia e Gjakovës, përbëhet kryesisht nga shkëmbinj magmatikë të tipit ultrabazik, ndërsa ajo e Hasit nga shkëmbinj gëlqerorë. Me këtë përbërje gjeologjike lidhet edhe prania e mineraleve të bakrit dhe të kromit. **Relievi** i Malësisë së Gjakovës, është kryesisht kodrinor, me valëzime të vogla të krijuara nga alternimet e kurrizeve me gropat dhe luginat, që janë prekur nga lëvizje tektonike ngritëse, që kanë krijuar një taban të çrregullt. Malësia e Hasit dallohet për relievin kryesisht malor. Përbëhet nga gropa e Krumës dhe pllaja karstike e Hasit. **Klima** është mesdhetare malore. **Hidrografia** përbëhet nga liqeni artificial i Fierzës, përroi i Krumës dhe burimet tektoniko-karstike. Popullimi në Malësinë e Gjakovës dhe të Hasit është më i dendur se në Alpe. **Popullimi** më i madh dhe vendbanimet, janë përqendruar kryesisht në gropa. Ka më tepër popullsi rurale. Qendrat urbane janë Kruma dhe Fierza. **Ekonomia** bazë është ajo bujqësore. Kultivohen patatat, fasulet, gështenjat, mollët dhe kumbullat. Blegtoria përfaqësohet me bagëtinë e imët, sidomos dhitë.

Vargjet e Lurës

Vargjet e Lurës, përbëhen nga dy vargje paralele, që dallojnë nga njëri tjetri prej *përbërjes gjeologjike dhe formave të relievit*. Vargu lindor, është i përbërë prej shkëmbinjve gëlqerorë dhe ka reliev të copëtuar prej erozionit të degëve të Drinit të Zi e të Matit, ndërsa vargu perëndimor përbëhet nga shkëmbinj ultrabazikë dhe gëlqerorë. Këtu arrihet edhe lartësia më e madhe e vargjeve të Lurës. Më të përhapura janë **tokat** e kafenjta, të murrme pyjore dhe livadhore malore. Një shtrirje të gjerë ka **kati i ahut dhe i kullotave alpine**.

Disa njësi të Nënrajonit Verilindor

Lugina e Drinit të Zi

Ndërtimi gjeologjik: Është një graben i madh, i përbërë nga shkëmbinj sedimentarë që karakterizohet nga zgjerime dhe ngushtime. Lugina ka shpatë të pjerrët e asimetrikë dhe përgjatë rrjedhës dallohen deri në tre nivele terracash lumore. Në këtë luginë ndihet ndikimi i **klimës** kontinentale me amplituda vjetore të mëdha të temperaturës. Popullsia më e madhe është ajo rurale. Ekonomia bazë e kësaj zone është **ekonomia bujqësore:** me drithërat (kryesisht misri), perimet (patatja, fasulja) dhe pemëtaria (mollë, kumbulla, dardha, arra). **Blegtoria** përfaqësohet me rritjen e gjedhit dhe të bagëtisë së imët. Përveç ekonomive tradicionale, buzë Drinit, në fshatin Arren, janë bërë investime nga sipërmarrje private edhe për rritjen e troftës.

Tema: Njësitë e tjera përbërëse të nënrajonit verilindor

Malësia Pukë-Mirditë

Ndërtimi gjeologjik. Masivet malore të malësisë përbëhen kryesisht prej shkëmbinjve magmatikë ultrabazikë, ndërsa gropat përbëhen edhe prej gëlqerorëve dhe terrigjenëve. Relievi. Në pjesën qendrore malore ndërsa pjesët periferike që rrethojnë qendrën e lartë, janë në formën e gropave tektonike. **Klima** është mesdhetare malore, me dimër të ashpër dhe verë të freskët. **Hydrografia** është e pasur e përfaqësohet me lumenjtë Fani i Madh dhe Fani i Vogël e një sërë përrenjsh. **Bimësia.** Malësia është një nga zonat më të pasura me bimësi. Në të gjenden të gjithë katet bimorë. **Popullimi.** Deri në vitet '90, popullsia e kësaj malësie, ka pësuar rritje. Pas vitit '90, numri i popullsisë ra, si rezultat i emigrimeve drejt rajonit perëndimor dhe jashtë vendit. Pjesa më e madhe e popullsisë dhe e vendbanimeve është rurale. **Ekonomia** bazë në këtë malësi, është prerja dhe përpunimi i lëndës drusore, por edhe bujqësia dhe blegtoaria luajnë një rol të rëndësishëm. Kultivohen më tepër misri, foragjeret, patatja, mollët, gështenjat e arrat, si dhe mbarështohet bagëtia e imët e derri. Nëntoka është e pasur me mineral bakri, i cili para vitit '90, nxirrej dhe përpunohej.

Vargjet e Skënderbeut

Vargjet e Skënderbeut, përbëhen nga dy vargje paralele, të ndara midis tyre nga lugina e Vilzës. Përbëhen prej shkëmbinjve magmatikë (mali i Skënderbeut), gëlqerorë (Mali me Gropa), ranorë dhe flishe. Vargu perëndimor është ai Krujë-Dajt, i cili arrin lartësinë më të madhe në malin e Dajtit (1612 m). Vargu lindor është më i lartë se ai perëndimor. Klima është mesdhetare paramalore dhe malore. Në Malin e Dajtit, në lartësinë 900-1100 m, ruhen fragmente të tarracës së dikurshme detare. Mali me Gropa dallohet për veprimtari karstike, nga ku dalin edhe edhe shumë burime ujore, që janë shfrytëzuar për ujë të pijshëm. Vargjet kanë edhe pasuri drusore me vlera ekonomike. Zona njihet gjithashtu për pasuri ekologjike dhe turistike.

Pellgu Klos-Kalivaç

Ndërtimi gjeologjik: Përbëhet nga shkëmbinj magmatikë dhe terrigjenë. Relievi përbëhet nga gropa, kodra të buta dhe lugina. Gropat ndahen midis tyre me anë të pragjeve. Klima e këtij pellgu, dallohet për sasi të konsiderueshme rreshesh, dhe temperatura të larta. Hydrografia është e pasur dhe përfaqësohet me lumenjtë Mat, Fani i Madh, Fani i Vogël, Gjadri dhe një sërë përrenjsh. Bimësia natyrore është e dendur dhe përfaqësohet kryesisht me katin e dushkut.

Disa njësi të tjera të Nënrajonit Verilindor

Malësitë e Martaneshit, Çermenikës, Gollobordës

Malësia e Martaneshit, zë pjesë veriperëndimore të malësisë dhe përbëhet kryesisht nga shkëmbinj magmatikë, por edhe nga gëlqerorë. Ajo përbëhet nga kurrize malore, të copëtuara nga hydrografia dhe është e pasur me pyje pishe e ahu. **Malësia e Çermenikës,** zë pjesën jugore të malësisë, përbëhet kryesisht prej shkëmbinjve terrigjenë dhe ka reliev malor. që lartësohet më tepër në veri dhe verilindje. **Malësia e Gollobordës,** zë lindjen e malësisë dhe përbëhet prej shkëmbinjve gëlqerorë. Në këtë malësi, gropat dhe fushat karstike ndërthuren me lugina të ngushta e të thata karstike. Rrjedhjet sipërfaqësore janë të pakta. **Popullsia** në këto malësi është e pakët, e vendosur në vendbanime rurale. Krijimi i qendrave urbane, është e lidhur me aktivitetin e nxjerrjes dhe përpunimit të mineralit të kromit. **Ekonomia.** Përveç nxjerrjes së mineralit të kromit, ekonomi e rëndësishme është ajo pyjore, ndërsa një pjesë e popullsisë merret me bujqësi dhe blegtoari. Banorët vendas kanë traditë në përpunimin e produkteve blegtorale dhe në mjeshtërinë e ndërtimit.

Tema: Pozita gjeografike, kushtet natyrore dhe njësitë e rajonit juglindor

Pozita gjeografike

Rajoni juglindor zë pjesën juglindore të Republikës së Shqipërisë dhe përbëhet kryesisht nga gropa, fushëgropa, male, malësi dhe lugina. Rajoni kufizohet në veri me rrjedhjen e mesme të Shkumbinit dhe në jug shkon deri në malësinë e Melesinit. Në perëndim kufizohet me Kodrat e Sulovës, luginën e Tomorricës dhe krahinën e Dangëllisë. Në lindje kufizohet me kufirin shtetëror të RSH me Maqedoninë e Greqinë. Ka një pozitë gjeostrategjike, pasi në të kalojnë rrugë automobilitike e hekurudhore, që lidhin rajonin Perëndimor me trevat shqiptare në Maqedoni e Greqi, si dhe me shtetet ballkanike më në lindje.

Kushtet natyrore

Ndërtimi gjeologjik, Rajoni përbëhet nga shkëmbinj magmatikë, por përhapje të konsiderueshme kanë edhe gëlqerorët e terrigjenët. **Relievi** përbëhet nga male të lartë, të kufizuar nga shkëputje tektonike paralele dhe midis tyre gjenden gropa të gjera, të thella dhe në lartësi mbi nivelin e detit.

Në relievet e ulëta, **klima** ka tipare kontinentale, sidomos në pjesën lindore e juglindore të rajonit, ndërsa në relievet e larta bëhet malore.

Hidrografia përbëhet nga disa lumenj e nga një rrjet përrenjsh, si dhe nga Liqeni i Ohrit, i Prespës së Madhe e Prespës së Vogël, e një numër liqenesh akullnajorë në disa kreshta malesh. **Tokat** më të përhapura, janë kryesisht të kafenjtat e të murrmet pyjore. **Bimësia pyjore** është e pasur dhe përfaqësohet me ahun dhe halorët.

Fushëgropat

Fushëgropa e Korçës, e Prrenjastit dhe e Devollit, ndodhen në lartësi mbi nivelin e detit, janë me origjinë gabenore dhe vazhdojnë të ulen në reliev. Dallohen për toka pjellore dhe tipare kontinentale të klimës. Temperatura mesatare vjetore është 10.50C dhe amplituda e temperaturës shkon rreth 200C. Bimësia është e kultivuar. Në to gjenden vendbanimet qytetare dhe një sërë vendbanimesh fshatare.

Rajoni Juglindor

Gropat

Gropa e Pogradecit, e Prespës dhe e Kolonjës, përbëhen nga fusha dhe relievet të larta përreth që vazhdojnë të ngrihen në reliev. Buçimasit dhe rripi bregliqenor perëndimor. Ndahen midis tyre nga pragje. **Gropa e Pogradecit** ka përbërje argjilore, **Gropa e Prespës**, përbëhet prej gëlqerorëve, ndërsa **Gropa e Kolonjës**, përbëhet nga terrigjenë. **Gropa e Kolonjës** është edhe gropa më e lartë midis tyre.

Luginat

Lugina e Devollit të Sipërm, dhe Lugina e Shkumbinit të Sipërm, janë lugina asimetrike me reliev të thyer, me ngushtime dhe me zgjerime.

Malet dhe malësitë. Malësia e Mokrës, përbëhet nga ranorët, argjilat, konglomeratët dhe gëlqerorët. Në pjesën perëndimore ka reliev më të çrregullt, me kontraste e me veprimtari erozive, ndërsa në pjesën lindore, ka reliev më të rregullt. **Malësia e Gorës**, ka reliev më të copëtura dhe më të lartë në pjesën veriore se në atë jugore. **Malësia e Kolonjës**, dallohet për reliev të çrregullt të përbërë nga pllaja e kurrize malorë të copëtuar nga lugina dhe gropa. **Malësitë midis Devollit dhe Osunit të Sipërm**, dallohet për kontraste të relievit. **Malet midis Luginës së Shkumbinit dhe Luginës së Devollit**, shtrihen në veriperëndim të rajonit dhe përbëhen nga masive e vargje malorë. Vargu **Moravë-Mali i Vashës**, shënon dhe lartësinë më të madhe të gjithë rajonit. **Mali i Shebenikut e Jabllanicë-Belica**, përbën nënjesinë më veriore dhe më të madhe të rajonit. Përbëhet nga mali i Shebenikut dhe luginat përreth dhe malet Jabllnicë dhe Belicë. **Mali i Thatë dhe malësitë në juglindje të tij**, kanë të zhvilluar procesin e karstit.

Tema: Popullimi në rajonin juglindor

Rajoni Juglindor përfaqëson një nga vatrat e rëndësishme të qytetërimit prehistorik. Në antikitet, ai është banuar nga fiset ilire të Dasaretëve dhe Enkelejve.

Shpërndarja e popullsisë

Rajoni karakterizohet nga ritme të ulëta të shtimit të popullsisë, të cilat janë përcaktuar nga ulja e numrit të lindjeve dhe fenomeni i emigrimeve (sidomos i moshave të reja). Pavarësisht ritmeve të tyre, emigrimet kanë qënë prezent në periudha të ndryshme (me përjashtim të periudhës 1945-1990) dhe ato kanë qënë të brendshme (drejt Rajonit Perëndimor të vendit) dhe të jashtme (Greqi, SHBA, etj). Popullsia është shpërndarë në mënyrë të pabara-bartë, në varësi të kushteve natyrore dhe të zhvillimit ekonomik të rajonit. Ajo është e përqëndruar kryesisht në fushëgropa, gropa dhe lugina lumore

Popullimi i rajonit

Struktura e popullsisë së rajonit

Në *strukturën e popullsisë sipas moshës* peshën më të madhe të saj e zë popullsia e re, por krahasuar me raportin që kanë grupmoshat në shkallë vendi vihe re se grup-mosha e tretë ka pësuar një rritje të lehtë. Kjo lidhet me uljen e ritmeve të lindjeve të popullsisë dhe emigrimin e moshës së re fertile.

Në *strukturën gjinore* të popullsisë së rajonit, raporti midis përqindjeve që zënë dy grupimet gjinore në popullsinë e përgjithme të tij, është në favor të popullsisë mashkull, e cila përbën 50,6 % kundrejt 49,4 % që zë popullsia femër.

Në *strukturën e popullsisë sipas vendbanimeve*, përqindjen më të lartë e zë popullsia rurale. *Struktura sipas etnisë. Rajoni përbëhet nga popullsi homogjene shqiptare.* Përveç popullsisë shqiptare, në të, gjendet edhe një pakicë kombëtare maqedonase. Ajo është përqëndruar në komunën e Prespës dhe në një fshat të rrethit Devoll.

Karakteristikat e vendbanimeve

Shpërndarja dhe dendësia e vendbanimeve të këtij rajoni, janë përcaktuar nga kushtet natyrore dhe zhvillimi ekonomiko-shoqëror i tij. Fushëgropa e Korçës, e Përrenjasit, gropa e Pogradecit dhe lugina e Devollit të Sipërm dallohen për përqëndrimin më të madh të vendbanimeve urbane dhe rurale të këtij rajoni. Në zonat kodrinore dhe sidomos në malësitë e rajonit, ky përqëndrim ulet ndjeshëm sidomos për vendbanimet urbane.

Tema: Ekonomia e rajonit juglindor

Pasuritë natyrore dhe trashëgimia kulturore si bazë për zhvillimin ekonomik të rajonit

Pozita gjeografike, kushtet natyrore dhe trashëgimia kulturore e rajonit ofrojnë mundësi të shumta për zhvillimin ekonomik të tij. Pozicioni lidhës i Rajonit përmes pikave kufitare e rrugeve lidhese, trashëgimia kulturore e historike e shtrirë pothuajse në të gjithë rajonin prania e fushëgropave, gropave, luginave dhe relievit kodrinor, nëntoka e pasur, kushtet e veçanta klimatike, rezervat hidrike, etj., krijojnë mundësitë e duhura për zhvillimin e degëve të ndryshme të ekonomisë së tij.

Ekonomia e rajonit juglindor

Sektori i parë i ekonomisë

Blegtoria, realizon rreth 50% të të ardhurave familjare dhe dallohet për mbarështimin e gjedhëve, të bagëtisë së imët, të shpendëve, të peshkut dhe të bletëve.

Bujqësia. Rreth 30 % e sipërfaqeve fushore dhe tarracave lumore të rajonit, mbillet kryesisht me grurë e misër, rreth 40% me foragjere, ndërsa pjesa tjetër me perime (qepa, fasulja, patatja, etj) (Devoll, Korçë), me pemë frutore (mollë, dardhë, kumbulla dhe arra) dhe me vreshtari.

Sektori i dytë i ekonomisë

Sektori **industrial përfaqësohet** me: Industrinë ushqimore e cila mbështetet në ndërmarrjet e prodhimit të verës, të birrës, të pijeve alkoolike dhe me punishtet e përpunimit të produkteve bujqësore e blegtorale; **Industrinë e përpunimit të drurit** që bazohet në stabilimentet e përpunimit të lëndës drusore; **Industrinë e materialeve të ndërtimit**, e prezantuar me guroret që shfrytëzojnë gurin gëlqeror e argjilor të zonës dhe me fabrikën e tullave. Sektori i ndërtimit është bërë dinamik dhe i nxitur prej lëvizjeve demografike nga fshatrat në qytet, prej investimeve të emigrantëve dhe rehabilitimit të infrastrukturës publike; **Prodhimin fason**, që prezantohet me ndërmarrjet e prodhimit të rrobave të gatshme (Korçë) etj.

Sektori i tretë i ekonomisë

Turizmi dhe **shërbimet**, janë sektorë të favorizuar prej pasurive natyrore e kulturore të rajonit dhe kanë marrë një zhvillim të madh kohët e fundit. Dallohet turizmi liqenor, kulturor dhe malor. **Tregëtia**, është një sektor i rëndësishëm për punësimin e një pjese të konsiderueshme të popullsisë së rajonit dhe është e përqëndruar në qytetet kryesore të tij. **Artizanati** përbën një degë tradicionale të ekonomisë së rajonit për prodhimin e produkteve prej leshti, metali, druri, poçerisë dhe gurit dekorativ. **Transporti**, përfaqësohet me transportin rrugor dhe hekurudhor (deri në Pogradec), ku më tepër investime janë bërë në atë rrugor.

Tema: Pozita gjeografike, kushtet natyrore dhe njësitë e rajonit jugor

Pozita gjeografike

Rajoni Jugor zë pjesën jugore e jugperëndimore të Republikës së Shqipërisë dhe kufizohet me Rajonin Juglindor, Perëndimor, Në perëndim e jugperëndim rajoni ka dalje në Detin Jon dhe në Gjirin e Vlorës që është pjesë e Detit Adriatik, ndërsa në juglindje kufizohet me kufirin politik të RSH me Greqinë. Rajoni ka një pozitë të rëndësishme gjeografike dhe ekonomike.

Rajoni Jugor

Kushtet natyrore

Ndërtimi gjeologjik i rajonit është i thjeshtë, i përbërë kryesisht nga shkëmbinj gëlqerorë. Në relievet e larta malore gjenden edhe dolomite, ndërsa nëpër lugina dhe kodra të ulta përhapen depozitime të ndryshme terrigjene.

Relievi reflekton shumë qartë ndërtimin gjeologjik të rajonit. Drejtimi mbizotërues i relievit të këtij rajoni është veriperëndim-juglindje, por nuk mungojnë edhe relievet në formë malësie.

Klima shfaqet në formën e klimës mesdhetare fushore, kodrinore dhe malore.

Hidrografia. Rajoni është shumë i pasur me ujëra sipërfaqësorë e nëntokësorë.

Tokat janë kryesisht të hirta kafe e të kafenjta, por ka edhe toka moçalore e të murme pyjore dhe livadhore malore.

Bimësia përfaqësohet nga shkurret mesdhetare sidomos tipit makje. Ajo e varfër dhe fragmentare në dushqe dhe në pyje me drurë të lartë ahu e pishë.

Fauna përfaqësohet nga kafshë të mëdha dhe nga shpendët

Njësitë përbërëse të rajonit jugor

Malësia e Tomorr-Melesinit, dallohet për reliev të çrregullt të përbërë nga male, vargje, kurrize malorë e kodra, të copëtuar prej rrjedhjeve ujore dhe përbëhet nga shkëmbinj gëlqerorë e terigjenë.

Luginës së Vjosës, në sektorin e sipërm fillon e ngushtë dhe e pjerrët, zgjerohet në në grykëderdhjen e Lengaricës, në sektorin e mesëm pret tërthor Vargjet Paralele, në bashkimin me Drinosin, formon një zgjerim të madh, vazhdon drejt veriperëndimit e perëndimit dhe del nga relievet maloro-kodrinore për në relievin fushor të rajonit Perëndimor.

Vargjet Paralele, përbëhen nga shkëmbinj gëlqerorë, ndërsa luginat që i ndajnë ata përbëhen nga terrigjenë.

Lugina e Drinosit. karakterizohet nga një fund i sheshtë dhe dallohet për toka dhe klimë të përshtatshme.

Vargu malor Kurvelesh-Mali i Gjerë-Stugarë-Murganë, ndërtohet nga shkëmbinj gëlqerorë karakterizohet nga një tektonikë e diferencuar. **Lugina e Shushicës** përbëhet nga shkëmbinj të ndryshëm terrigjenë, nëpër të cilët formon disa ngushtime dhe zgjerime. **Vargu Bregdetar Jonik**, përbëhet nga gëlqerorë dhe kanë shpatë të pjerrët që zbrasin drejt detit.

Fushëgropa e Delvinës, përfaqëson një graben dhe karakterizohet nga një reliev i larmishëm.

Tema: Popullimi i rajonit jugor

Lashhtësia e popullimit të rajonit

Rajoni dallohet për një popullim të hershëm prehistorik. Objektet arkeologjike të gjetura në Xarë të rrethit të Sarandës, sjellin prova të banimit të trevave shqiptare që në periudhën e paleolitit të mesëm (100000 deri 30000 vjet p.K.). Në antikitet ky rajon ka qënë i banuar nga fisi ilir i kaonëve. Rajoni ka shënuar rritje të numrit të popullsisë, por me ritme të ndryshme deri në vitet '90. Pas vitit 1991, popullsia e tij pësoi rënie të ndjeshme në numër, si rezultat i emigrimit të një pjese të madhe të popullsisë dhe të uljes së ritmeve të lindjeve., gjë e cila uli ndjeshëm edhe numrin e lindjeve.

Popullimi i rajonit jugor

Shpërndarja gjeografike e popullsisë

Shpërndarja e popullsisë është e pabarabartë dhe e përcaktuar nga kushtet e relievit dhe zhvillimi ekonomik i rajonit. Dendësi më të madhe ka rrethi i Gjirokastrës, ndërsa dendësi më të ulët ka rrethi i Përmetit. Rajoni është prekur edhe nga dukuria e emigrimit, sidomos e pas vitit '90. Emigrimi i brendshëm i popullsisë është drejtuar drejt Rajonit Perëndimor, kryesisht drejt rajonit Tiranë-Durrës, ndërsa emigrimi i jashtëm është drejtuar kryesisht drejt Greqisë dhe Italisë.

Struktura e popullsisë së rajonit

Në **strukturën moshore të popullsisë** së këtij rajoni, peshën më të madhe të saj e zë popullsia e re, por vihet re, që grupmosha e tretë e popullsisë zë një peshë 2 % më të lartë se përqindja që ajo zë në shkallë vendi. Kjo është e lidhur me dukurinë e emigrimit, që karakterizon më tepër moshën e re si dhe me uljen e ritmeve të lindjeve.

Në **strukturën gjinore** të popullsisë së rajonit, vihet re që popullsia mashkull ka një rritje të lehtë krahasuar me popullsinë femër. Në **strukturën e popullsisë sipas vendbanimeve**, popullsia rurale është më e lartë se ajo urbane.

Struktura etnike e popullsisë. Rajoni përbëhet nga popullsi homogjene shqiptare. Përveç popullsisë shqiptare, në të është përqëndruar pjesa më e madhe e pakicës kombëtare greke që jeton në Shqipëri, e vendosur në rrethet Sarandë, Delvinë dhe Gjirokastrë.

Karakteristikat e vendbanimeve

Dendësia më e madhe e vendbanimeve është përqëndruar në rrethet Gjirokastrë, Sarandë dhe Delvinë. Dendësi më të vogël të vendbanimeve kanë rrethet Skrapar, Përmet e Tepelenë. Vendbanimet më të shumta të rajonit, janë ato rurale. Vendbanimet rurale malore janë më të pakta në numër dhe janë të vendosura në malësitë e Tomorrit, të Kurveleshit, në Dangëlli, Zagori, etj.

Midis qendrave urbane dallohen Gjirokastra dhe Saranda.

Tema: Ekonomia e rajonit jugor

Pasuritë natyrore dhe trashëgimia kulturore, bazë për zhvillimin ekonomik të rajonit

Rajoni Jugor ka pasuri të shumta natyrore. Përveç klimës së përshtatshme, ujërave të shumta, bimësisë dhe faunës specifike, këtu gjenden edhe pasuri nëntokësore, inerte për ndërtim, burime minerale e termominerale dhe bimë të rralla medicinale, shpellat e shumta nëntokësore në gëlqerorë, drurët natyrorë industrialë (si valanidhi), etj., mundësojnë zhvillimin

Ekonomia bujqësore

Ekonomia bujqësore është sektori kryesor i ekonomisë së rajonit.

Bujqësia është përqendruar kryesisht në Fushën e Vurgut, të Mursisë, të Dropullit dhe përgjatë luginave të Vjosës e të Drinosit. Kulturat kryesore që kultivohen janë: drithrat e bukës, pemëtaria, vreshtaria, bostani. **Blegtoria**, dallohet kryesisht për mbarështimin e bagëtisë së imëta. **Peshkimi**, është i përqendruar përgjatë Rivierës, në Sarandë dhe në liqenin e Butrintit.

Ekonomia e rajonit jugor

Industria

Energjetika, përfaqësohet me dy HEC-e në lumin Bistrica. **Industria e lehtë e ushqimore**, është një degë tradicionale e rajonit. Industria e lehtë është përqendruar në qytetin e Gjirokastrës dhe përfaqësohet me **prodhimin fason**, në formën e ndërmarrjeve të përbashkëta shqiptaro-greke të prodhimit të rrobave të gatshme e të këpucëve. Industria ushqimore dallohet për prodhimin e pijeve alkolike, joalkoolike, për ambalazhimin e ujit të pijshëm, për përpunimin e produkteve bujqësore, prodhimin dhe ambalazhimin e vajit të ullirit, konservimin e reçelave dhe glikove, si dhe për përpunimin e produkteve blegtorale. **Industria e materialeve të ndërtimit** bazohet në nxjerrjen e përpunimin e materialeve inerte për ndërtim, në prodhimin e tullave, të nxjerrjes dhe përpunimit të pllakave të gurit dekorativ, në prodhimin e gëlqerës, etj.

Turizmi, transporti dhe shërbimet

Turizmi: Peshën kryesore e zë turizmi blu, ndërsa turizmi kulturor ka marrë një zhvillim më të madh kohët e fundit. **Transporti** përfaqësohet me atë tokësor dhe detar. Peshën kryesore në transportin e mallrave dhe njerëzve, e zë transporti rrugor. **Artizanati** përbën një degë tradicionale të ekonomisë së rajonit, e përfaqësuar me prodhimin e produkteve prej leshi, me-tali e druri.

Tema: Pozita gjeografike, kushtet natyrore dhe njësitë e rajonit perëndimor

Pozita gjeografike

Rajoni Perëndimor zë pjesën perëndimore dhe veriperëndimore të Republikës së Shqipërisë. Ai shtrihet nga Hani i Hotit në veri deri në qytetin e Vlorës në jug, me një gjatësi 200 km. Në perëndim laget nga deti Adriatik, ndërsa në verilindje, në lindje dhe në jug kufizohet me Rajonin Verior e Verilindor, Rajonin Juglindor dhe atë Jugor. Rajoni ka një pozitë tepër të favorshme strategjike, gjeografike dhe ekonomike. Kjo lidhet me daljen e gjerë të tij në Adriatik, hapësirën e madhe fushore, rezervat e lëndëve djegëse, përqëndrimin e qendrave më të mëdha urbane e ekonomike dhe mundësinë e komunikimit që ka ky rajon ka, me të gjitha rajonet e tjera të vendit që e rrethojnë. Koncepti strategjik “Porta e Ballkanit”, që përmendet për trevat shqiptare, i ka nyjet fillestare lidhëse në këtë rajon.

Rajoni Perëndimor

Kushtet natyrore

Ndërtimi gjeologjik. Trualli i rajonit është krijuar nga depozitimet lumore që nga fundi i pliocenit e në vazhdim dhe formën e plotë e mori gjatë kuaternarit, kur doli plotësisht mbi ujë. Pjesa fushore e rajonit përbëhet nga argjila, rëra, zhavore etj, ndërsa zonat kodrinore përbëhen nga ranorë, konglomerate, argjila dhe më pak nga gëlqerorë. Nëntoka e tij është e pasur në rezerva naftë, gazi natyror e qymyrguri. **Relievi** përbëhet kryesisht prej fushave, por janë të pranishme edhe kodrat dhe vargjet kodrinore. **Klima** është tipike mesdhetare me verë të nxehtë e të thatë e dimër të butë e të lagësht. Ajo ndikohet nga masat ajrore që vijnë nga Adriatiku. **Hidrografia** është shumë e pasur dhe përfaqësohet rrjedhjet e poshtme të lumenjve më të mëdhenj të vendit (Drinit, Matit, Ishmit, Erzenit, Shkumbinit, Semanit dhe Vjosës) dhe me lumenj që rrjedhin tërësisht apo pjesërisht brënda rajonit (Buna, Kiri, Gjadri, Droja, Gjanica, etj.) Pjesë e hidrografisë janë edhe liqenet (i Shkodrës dhe të Dumresë), lagunat (e Kune-Vainit, e Patokut, e Karavastasë, e Nartës), ujërat nëntokësore artezianë dhe një numër i pakët burimesh. **Tokat** më të përhapura janë ato të hirta kafe. **Bimësia** natyrore është e kufizuar, pasi është zëvendësuar nga bimësia e kultivuar. **Fauna**, është gjithashtu e varfër. Rajoni dallohet sidomos për shpendët ujorë dhe shpendët e tokës.

Njësitë përbërëse të rajonit perëndimor

Rajoni Perëndimor ndahet në dy njësi të mëdha: Ultësira e Shkodrës dhe Fushat e kodrat midis Lezhës dhe Vlorës.

Ultësira e Shkodrës, është formuar nga një fundosje tek-tonike dhe përbëhet nga Ultësira e Mbishkodrës dhe ajo e Nënshkodrës. **Fushat e kodrat midis Lezhës dhe Vlorës.** Kjo njësi përbëhet nga : fushat dhe kodrat midis Lezhës, Durrësit e Tiranës; fusha e Myzeqesë; fusha e Elbasanit; zona kodrinore midis Erzenit të Mesëm dhe Shkumbinit të Mesëm; pllaja Dumre-Darsi, kodrat e Sulovës dhe kodrat e Mallakastrës.

Zona kodrinore midis Erzenit të Mesëm dhe Shkumbinit të Mesëm, përbëhet kryesisht nga shkëmbinj terrigjenë, por edhe gëlqerorë dhe ka një reliev të copëtuar prej degëve të Erzenit dhe Shkumbinit. Pllaja Dumre-Darsi përbëhet nga kodrat e Darsisë dhe pllaja karstike e Dumresë. Kodrat e Sulovës, përbëhen prej terrigjenësh e gëlqerorësh dhe kanë reliev të çrregullt të copëtuar nga disa përrenj. Kodrat e Mallakastrës janë grumbulli kodrinor më i madh i rajonit, i përbërë kryesisht prej terrigjeneve, por edhe gëlqerorëve në lartësitë më të mëdha të këtij grumbulli.

Tema: Popullimi në rajonin perëndimor

Popullimi ne Rajonin Perëndimor

Rajoni Perëndimor është populluar që në prehistori. Gjurmët e para të zbuluara mbi popullimin në të, i përkasin paleolitit të mesëm. Rajoni dallohet për praninë e shumë qendrave të vjetra urbane, disa prej të cilave lindën që nga mesi i shek IV. para Krishtit. Gjatë shekujve në vazhdim, shumë qendra urbane të tij si Bylisi, Lisi, Dyrrahu, Apolonia, Antipatrea, Skodra, etj., përmes zhvillimit të aktivitetit të tyre zejtar, tregtar dhe bujqësor, u rritën vazhdimisht në numër. Rajoni është banuar kryesisht nga fisi ilir i taulantëve dhe ai i albanëve.

Shpërndarja gjeografike

Popullsia e Rajonit Perëndimor, ka pësuar vazhdimisht rritje në numër, por ritmet rritjes së popullsisë nuk kanë qënë të njëjta. Popullsia ka shënuar rritje gjatë periudhës 1945-1990, si rezultat i përqëndrimit më të madh në këtë rajon, të shërbimeve, të objekteve industriale dhe të aktivitetit bujqësor. Ritmet më të larta të popullimit shënohen pas vitit '90, kur sëbashku me ndryshimet e mëdha politike, në Shqipëri u bë e mundur lëvizja e lirë e individit. Edhe pse një pjesë e popullsisë së këtij rajoni emigroi jashtë vendit (kryesisht në Itali, Greqi, etj),

Karakteristikat e vendbanimeve

Rajoni Perëndimor dallohet për numrin më të madh të vendbanimeve urbane dhe për prezencën e vendbanimeve më të mëdha në shkallë vendi.

Tirana është kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë dhe qendra më e madhe ekonomike, administrative, politike, sociale dhe kulturore e saj.

Struktura e popullsisë

Në **strukturën e popullsisë sipas moshës**, rajoni dallon për peshën e madhe që zë popullsia e re, krahasuar edhe me rajonet e tjera të vendit. Kjo është e lidhur me ardhjet drejt tij të popullsisë së re, për mundësitë më të mëdha të shkollimit dhe të punësimit që ky rajon ofron për këto grupmosha. Në **strukturën e popullsisë sipas gjinisë**, popullsia femër përbën 50.32% të popullsisë së rajonit, ndërsa popullsia mashkull përbën 49.68 % të saj. Në **strukturën e popullsisë sipas vendbanimeve**, përqindja e popullsisë qytetare kundrejt popullsisë së përgjithshme të rrethit varion nga 66.84 % në rrethin e Tiranës në 22.04 % në rrethin e Peqinit. Në **strukturën etnike të popullsisë**, rajoni përbëhet nga popullsi homogjene shqiptare. Përveç popullsisë shqiptare, në këtë rajon jeton edhe një pakicë kombëtare malazeze që është e përqëndruar kryesisht në disa fshatra të vegjël në zonën e Vrakës, në veri të qytetit të Shkodrës. Pjesë e popullsisë së rajonit janë edhe pakicat gjuhësore arumune e rome.

Tema: Ekonomia e rajonit perëndimor

Zhvillimi ekonomik i Rajoni Perëndimor, favorizohet nga një sërë burimesh natyrore, kulturore, si dhe nga një potencial i madh njerëzor. Burimet natyrore të këtij rajoni përfaqësohen me: rezervat e mëdha cilësore të lëndëve djegëse; me rezervat e materialeve të ndërtimit; me sipërfaqet e gjera të tokave bujqësore, që dallohen për cilësinë shumë të mirë të tyre dhe mundësojnë kultivimin e të gjitha kulturave bujqësore; me klimën e ngrohtë mesdhetare, që mundëson sidomos zhvillimin e ekonomisë bujqësore dhe të turizmit; me daljen e gjerë në Adriatik, si bazë për zhvillimin e tregëtisë dhe të lidhjes me rajonin e më gjerë; me praninë e plazheve të ulët ranorë, në të cilët zhvillohet turizmi blu dhe me ujërat e bollshëm të lumenjve që mundësojnë ujitjen e vazhdueshme të fushave të kësaj ultësire.

Rajoni Perëndimor dallohet edhe për praninë e një rrjeti të gjerë qendrash e objekteve arkeologjike, historike e kulturore, me anë të të cilave prezantohet identiteti ynë kombëtar dhe favorizohet zhvillimi i turizmit kulturor.

Ekonomia e rajonit perëndimor

Ekonomia bujqësore

Rajoni jep pjesën më të madhe të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale në shkallë vendi.

Bujqësia, është e zhvilluar në të gjithë rajonin. Aktualisht struktura e kulturave bujqësore është në favor të perimeve, zarzavateve, bostanit, ullinjve dhe foragjereve, por vazhdon tradita e prodhimit të drithrave të bukës. Për shkak të mungesës së tregut dhe konkurrencës së produkteve të importit, është kufizuar shumë sipërfaqja e kultivuar me bimë industriale. **Blegtoria**, dallohet për rritjen e gjedhit, të bagëtisë së imët, të derrit dhe të shpendëve. **Peshkimi** është degë e rëndësishme, e zhvilluar në qytetet bregdetare të vendit, në Liqenin e Shkodrës dhe në laguna.

Industria

Energjëtika përfaqësohet me nxjerrjen e përpunimin e naftës, të bitumit dhe prodhimin e energjisë elektrike nga TEC-et. **Industria metalurgjike** dhe ajo **mekanike** përfaqësohet me uzinat e shkrirjes e të prodhimit të hekurit për ndërtim, uzinat mekanike të industrisë nxjerrëse të naftës si dhe me disa fabrika të vogla private të prodhimit të tubave e të përpunimit të aluminit. **Industria e lehtë**, përfaqësohet kryesisht me sipërmarrjet fasone të veshmbathjeve, rrobave të gatshme dhe të këpucëve. **Industria ushqimore**, përfaqësohet me fabrikat: e prodhimit të vajit ushqimor, të prodhimit të vajit të ullirit, të përpunimit të qumështit, të përpunimit të produkteve të mishit, të prodhimit të vezëve, të miellit, të prodhimit të pijeve alkolike, të prodhimit të pijeve joalkolike, të konservimit të frutave dhe zarzavateve dhe të konservimit të prodhimeve të detit. **Ndërtimtaria**, përfaqësohet me fabrikat e prodhimit të çimentos, me linjat e prodhimit të materialeve inerte, me linjat e prodhimit të betonit dhe të parafabrikateve, me linjat e prodhimit të materialeve të ndërtimit, me fabrikat e të prodhimit të tullave.

Turizmi, tregëtia, transporti

Turizmi, përfaqësohet me turizmin blu dhe atë kulturor. Ai është i zhvilluar kryesisht përgjatë gjithë bregdetit, në Krujë, Apoloni, Berat, etj. **Tregëtia** është një degë e rëndësishme e ekonomisë, pasi në të punësohet një pjesë e madhe e popullsisë së rajonit.

Transporti. Rajoni i ka të zhvilluara të gjitha degët e transportit, atë automobilistik, hekurudhor, detar dhe ajror. investime.

KREU VIII. REPUBLIKA E KOSOVËS

Tema: Pozita gjeografike dhe veçoritë fiziko-gjeografike të Republikës së Kosovës

Pozita gjeografike, madhësia, kufijtë dhe rajonizimi i Republikës së Kosovës Republika e Kosovës zë një pozitë gjeografike qendrore në Gadishullin Ballkanik.

Kufizohet në jugperëndim me Shqipërinë, në veriperëndim me Malin e Zi, në verilindje me Serbinë dhe jug me Maqedoninë. Me Republikën e Shqipërisë, ajo ka kufi politik, por jo etnik. Republika e Kosovës, ka një pozicion gjeografik tepër të favorshëm në Gadishullin e Ballkanit. Ajo mundëson kalimin nga pjesët perëndimore të trevave shqiptare, drejt rajoneve të brendshme ballkanike. Një mundësi komunikimi dhe zhvillimi për Republikën e Kosovës ka krijuar ndërtimi i “Rrugës së Kombit”. Përmes saj Kosova krijon dalje në bregdet dhe pjesa perëndimore e trevave shqiptare lidhet me pjesët e brendshme të Gadishullit Ballkanik.

Republika e Kosovës

Veçoritë fiziko-gjeografike

Ndërtimi gjeologjik. Trualli i Republikës së Kosovës ka një ndërtim gjeologjik kompleks dhe të larmishëm. Pjesa më e madhe e truallit përbëhet prej strukturës së albanideve. Vetëm në lindje, ka një shtrirje më të ngushtë, struktura e vjetër e Rodopeve. Formacionet gjeologjike, janë të shumëllojshme dhe të formuar në periudha të ndryshme gjeologjike. Shumëllojshmëria e shkëmbinjve, kushtëzon edhe prezencën e pasurive të shumta minerare.

Relievi. Format kryesore të relievit të Republikës së Kosovës janë malet dhe fushëgropat. Malet zënë rreth 63 % të relievit ndërsa fushëgropat rreth 37 % të tij. Lartësia mesatare mbi nivelin e detit është 810 m. Pika më e ulët e relievit ndodhet në luginën e Drinit të Bardhë në 270 m, ndërsa më e larta është Gjeravica me 2656 m lartësi. Lartësitë më të mëdha mbërrijnë në Bjeshkët e Namuna, Pashtrik, Koritnik, Kopaonik, etj. Fushëgropat, janë të formave të ndryshme. Ato zënë pothuajse pjesën qendrore të Kosovës dhe në një trajtën e një mozaiku rrethohen nga malet. Në brendësi, fushëgropat ndahen midis tyre prej maleve të ulët, ndërsa në rrethina, ato qarkohen nga male të lartë. **Klima,** është mesatare kontinentale, por në jug të Fushës së Dukagjinit, shfaqen elementë të klimës mesdhetare.

Hidrografia. Republika e Kosovës, ka një rrjet të zhvilluar lumor që derdhen në tre dete (Detin Adriatik, Detin e Zi dhe Detin Egje).

Tokat. Tipat më të përhapura të tokave janë: humusore, humusore silikate, toka të hirta acide skeletore, toka të kuqe në të purpurt, toka aluviale dhe toka shkëmbore.

Bimësia. Republika e Kosovës ka rreth 1800 lloje bimësh, ndër të cilat, rreth 200 lloje janë endemike dhe subendemike.

Kosova ka edhe një **botë** të pasur **shtazore**. Në të gjenden rreth 230 lloje të egra kurrizorësh.

Tema: Popullsia e Republikës së Kosovës

Popullsia e Republikës së Kosovës

Popullim i hershëm në trojet e tyre

Territori i Republikës së Kosovës është një trevë e banuar brez pas brezi nga shqiptarët. Është populluar shumë herët, që në epokën e paleolitit të mesëm dhe u rrit e u konsolidua gjatë neolitit. Në shekullin XIII deri në mesin e shekullit XIV, Dardania ra nën sundimin serb. Shtirja e shtetit serb në drejtim të Kosovës, u shoqërua me vendosjen aty të kolonëve të rinj, të sjellë nga territoret e Serbisë së mirëfilltë (Rashës). Politika serbe e asaj kohe, për asimilimin e popullsisë shqiptare, ndeshi në rezistencën e popullsisë shqiptare autoktone. Lufta e popullsisë shqiptare në Kosovë dhe mbështetja e dhënë nga forcat e NATO-s, bëri që në 18 qershor 1999, Kosova të çlirohej nga pushtimi e administrimi serb. Përpjekjet për realizimin e aspiratave shumëshekullore për liri e pavarësi të mbështetura edhe nga faktori ndërkombëtar, u finalizuan në 17 shkurt 2008, me krijimin e shtetit të pavarur të Kosovës.

Analiza e strukturës së popullsisë

Struktura etnike: popullsia e përgjithshme e Republikës së Kosovës (sipas vlerësimeve të ESK-së) përbëhet nga 92 % shqiptarë dhe pjesa tjetër pakica etnike serbe (5,3 %), boshnjake e malazeze (1,2 %), rome (1.1 %) dhe turke (0,4 %).

Struktura sipas grupmoshës: Popullsia e Republikës së Kosovës është shumë e re, me një moshë mesatare 23 vjeç. **Struktura sipas gjinisë:** Në raportin meshkuj femra të përbërjes së popullsisë, dominon elementi mashkull. Lindin më shumë meshkuj sesa femra, por jetëgjatësia është më e lartë tek femrat se sa tek meshkujt.

Struktura sipas vendbanimeve: Në popullsinë e përgjithshme, popullsia rurale zë përqindje më të lartë se ajo urbane. Megjithatë, popullsia urbane, që pas Luftës së Dytë Botërore e në vazhdim, ka pësuar rritje në vazhdimësi.

Numri i popullsisë dhe shpërndarja e saj

Regjistrimet e përgjithshme të popullsisë së Kosovës datojnë që nga viti 1921. Regjistrimet e bëra në vitet 1921 dhe 1931, kanë dhënë informacion vetëm për numrin e përgjithshëm të popullsisë dhe për përkatësinë fetare të saj. Ato nuk japin të dhëna për etnicitetet dhe strukturën e tyre në këtë popullsi. Struktura etnike e popullsisë për herë të parë është evidentuar në regjistrimin e vitit 1948. Regjistrimi i fundit i popullsisë është bërë në vitin 1981. Numri i popullsisë dhe struktura etnike e saj gjatë regjistrimeve ka pësuar ndryshime, pasi është varur prej **shtimit natyror dhe lëvizjeve mekanike të popullsisë**. Nga të dhënat në vite, vihet re që popullsia shqiptare ka ndjekur një tendencë rritjeje graduale, ndërsa etnitë e tjera, kanë pësuar luhataje në numër. **Shtimi natyror i popullsisë** në Republikën e Kosovës është 12.5 o/oo. Niveli i lindshmërisë është 15.7 o/oo dhe i vdekshmërisë 3.2 o/oo. Ecuria e shtimit natyror ka pësuar ndryshime. Në vitet 90-të, dinamika e popullsisë u ndikua shumë nga niveli i lartë **i emigrimit**.

Republika e Kosovës është rajoni me dendësinë më të madhe të popullsisë në të gjitha trevat shqiptare. Ajo gjithashtu bën pjesë në vendet me dendësi të lartë në rajon.

Faktorët që kanë ndikuar në shpërndarjen e popullsisë janë:

Faktori natyror, ekonomik, social, politik.

Tema: Ekonomia e Republikës së Kosovës

Ekonomia në Republikën e Kosovës

Republika e Kosovës, është një trevë me pasuri të mëdha ujore, minerare (metalike e jometalike), energjetike, pyjore etj. Megjithatë, stadi i zhvillimit të saj ekonomik shpesh, nuk i është përgjigjur mundësive dhe shkallës së përdorimit të këtyre pasurive natyrore. Kjo sepse, zhvillimi ekonomik i saj, ka qenë i varur nga faktorë historikë, politikë e shoqërorë. Zhvillimi ekonomik ka qenë ngushtësisht i lidhur me përpjekjet e vazhdueshme për ruajtjen e identitetit kombëtar dhe me politikat ekonomike që janë zbatuar në këtë trevë, kur ajo ishte pjesë e Federatës Jugosllave. Edhe pse ishte rajoni me pasuri të shumta natyrore, mbeti krahina më e prapambetur në ish-Federatën Jugosllave. U konsiderua si burim i lëndëve të para dhe u bënë pak investime në zhvillimin e industrisë përpunuese. Sot, ekonomia ende po përpiqet të rimëkëmbet, por procesi i privatizimit është i ngadalshëm. Aktualisht, 30% të produktit bruto të vendit i jep bujqësia, 60% industria e tregëtia dhe 10% turizmi.

Ekonomia bujqësore

Aktualisht pesha e *bujqësisë* në prodhimin e brendshëm bruto ka pësuar rënie, por është ende sektori me të cilin punësohet rreth 60% të popullsisë së përgjithshme. Është e organizuar kryesisht mbi bazën e ekonomive familjare. Kulturat që kultivohen më tepër janë: drithërat (misri, gruri, elbi) e foragjeret, bimët industriale (duhani), perimet, patatja, vreshtat, pemëtaria, etj. *Blegtoria*, ka mundësi shumë të mira për zhvillim, por pas luftës, ka pësuar rënie. Sipërfaqet pyjore përbëhen kryesisht nga ahu, dushku dhe më pak nga halorë.

Sektori industrial

Industria ushqimore: përfaqësohet nga sipërmarrje të vogla dhe të mesme. Përfshin përpunimin e ambalazhimit e perimeve, të pemëtarisë, të produkteve blegtorale, të verës, të birrës e pijeve joalkolike. *Industria e nxjerrjes dhe e përpunimit të mineraleve* (qymyrguri, plumbi, zinku, nikelit, magneziti etj.), mbështetet mbi rezervat e mëdha të tyre. *Energjetika* mbështetet mbi rezervat e linjtit. *Industria e materialeve të ndërtimit* përfaqësohet me prodhimin e çimentos, gëlqeres, pllakave të qeramikës, të gurit ndërtimor etj. *Industria e përpunimit të drurit* mbështetet në sipërfaqet e mëdha pyjore.

Tregëtia, turizmi, artizanati dhe transporti

Tregëtia, aktualisht është bërë një nga degët parësore në ekonominë e Kosovës. Kjo sepse, ajo përfshin një numër të madh të bizneseve, të të punësuarve dhe të investimeve.

Turizmi, mbështetet mbi turizmin malor e kulturor, parqet nacionale e të gjuetisë, shërbimit të hotelierisë dhe pranisë së qendrave urbane e rrugëve të rëndësishme në Kosovë.

Zejtaria përfaqësohet me disa nga zeje të vogla tradicionale si farkëtaria, zdrukhtaria, punime leshi, të filigramit, argjendarie, etj.

Transporti, realizohet kryesisht përmes rrugëve automobilistike, ajrore dhe më pak prej hekurudhave.

Tema: Rajonizimi i Republikës së Kosovës

Njësitë përbërëse të Republikës së Kosovës

Në hapësirën territoriale të Republikës së Kosovës, nga perëndimi në lindje elementët natyrorë shfaqin veçanti. Pjesa perëndimore e kësaj hapësire, krahasuar me atë lindore, ka një përbërje gjeologjike më të re në moshë. Në të gjendet maja më e lartë e Kosovës dhe pika më e ulët e saj, si dhe është e pranishme klima mesdhetare. Pjesa lindore e Kosovës, ndodhet në lartësi më të madhe mbi nivelin e detit. Ka përbërje gjeologjike më të vjetër dhe nëntokë të pasur me minerale metalorë e jo metalorë. Klima është kontinentale dhe fushat ndahen midis tyre nga zona kodrinore malore. Në varësi të kushteve natyrore është bërë edhe shpërndarja e vendbanimeve, popullimi i tyre dhe natyra e ekonomisë së vendit. Pra, mbi bazën e veçantive që shfaqin elementët natyrorë, Republika e Kosovës ndahet në dy rajone të mëdha fiziko-gjeografikë: **Rajoni Lindor** (Fusha e Kosovës) dhe **Rajoni Perëndimor** (Rrafshi i Dukagjinit). Kufirin gjeografik midis tyre e krijojnë kodrat e Drenicës. Aty gjendet edhe vija ujëndarëse midis pellgut të Adriatikut dhe pellgut të Detit të Zi e Detit Egje.

Rajonit Lindor të Kosovës

Rajoni Lindor ose Fusha e Kosovës, është hapësira me sipërfaqen më të madhe në Kosovë. Ai shtrihet nga Kopaoniku në veri, deri në Malin e Zi të Shkupit në jug. Në perëndim kufizohet me kodrat e Drenicës, ndërsa në lindje me malësinë e Gollakut dhe rrjedhën e sipërme të Moravës Jugore. Në përbërje të rajonit hyjnë:

- zona malore e përfaqësuar me malin e Kopaonikut, malin e Rogoznës dhe malësinë e Siriniqit;
- zona kodrinore e Drenicës, e Novobërdë-Gollakut, Kollashinit të Ibrit dhe Mali i Zi i Shkupit.
- zona fushore, që përbëhet nga fusha e Kosovës, fusha e Llapit dhe ajo e Moravës;

Rajoni perëndimor

Rajoni Perëndimor, ose Lugu i Dukagjinit, ka një shtrirje gjatësore që prej malit Mokna në veri, deri në malet e Sharrit në jug. Në perëndim kufizohet nga Bjeshkët e Namuna, ndërsa në lindje nga Kodrat e Drenicës. Në përbërje të këtij rajoni hyjnë: zona fushore e Dukagjinit dhe zonat kodrinoro-malore që pothuajse e qarkojnë këtë zonë fushore.

KREU IX. TREVAT E TJERA SHQIPTARE JASHTË KUFIRIT

Trevat shqiptare jashtë kufirit

Trevat shqiptare në Serbi

Medvegja, Presheva dhe Bujanovci janë tre komuna shqiptare, që ndodhen në jug të Republikës së Serbisë dhe janë nën administrimin e saj. Trevat shqiptare në Serbi, kanë një pozitë gjeografike qendrore në Gadishullin Ballkanik. Pozicioni i favorshëm gjeostrategjik i tyre, lidhet me faktin që fusha pjellore e këtyre trevave është pjesë e luginës Moravë-Vardar. **Relievi**, ka një fizionomi të përbërë nga një reliev kodrinoro-malor dhe fushëgropa tektonike. **Ndërtimi gjeologjik**. Trevat shqiptare në Serbi, bëjnë pjesë në zonën e rrudhosjes së masivit të Rodopeve dhe përbëhen nga shkëmbinj metamorfikë e sedimentarë të paleozoitit e të neogjenit. **Klima** ndikohet ndjeshëm prej masave ajrore të ftohta që vijnë nga lugina e Moravës dhe atyre më të ngrohta që vijnë përmes luginës së Vardarit. **Hidrografia** përfaqësohet me lumenj dhe burime termominerale.

Popullsia dhe vendbanimet

Hapësira territoriale e këtyre tri komunave, që herët, ka qënë e banuar në mënyrë të pandërprerë nga popullsia shqiptare. Pavarësisht nga pushtimet e huaja në periudha të ndryshme historike dhe politikave e përdorura, popullsia vendëse e kësaj treve, përgjatë shekujve ka treguar vazhdimisht qëndrueshmëri dhe ka ruajtur vazhdimësinë etno-kulturore shqiptare.

Popullsia dallohet për shtim të lartë natyror dhe në shtrukturalitetin e popullsisë sipas moshës, mbizotëron popullsia me moshë të re. Numri më i madh i popullsisë është në komunën e Bujanovcit, por dendësinë më të madhe e ka popullsia e Preshevës (129 banorë/km²). Në këto komuna, shumicën e popullsisë, rreth 62 %, e përbëjnë shqiptarët. Pjesëmarrje më të lartë të popullsisë shqiptare ka komuna e Preshevës me 85 % dhe më të ulët komuna e Medvegjës me 26.8%.

Karakteristikë për popullsinë e këtyre komunave

Trevat shqiptare në pjesën perëndimore të Republikës së Maqedonisë

Këto treva shqiptare shtrihen në perëndim të Republikës së Maqedonisë dhe janë bërë pjesë përbërëse e saj. Janë treva të banuara nga një popullsi e lashtë autoktone. Në antikitet kanë qënë të banuara nga fiset ilire të peonëve, linkestëve, desaretët etj. Popullsia maqedonase ka ardhur dhe është vendosur në këto treva, rreth shekullit VI p.K., gjatë dyndjes së sllavëve të Jugut.

Ndërtimi gjeologjik: Në pjesën perëndimore të këtyre trevave mbizotërojnë shkëmbinj të paleozoikut, ndërsa në pjesën lindore të tyre shkëmbinj të masivit të vjetër të Rodopeve. Mbizotërojnë strukturat horst-graben. Nëntoka është e pasur me pasuri minerale (linjit, hekur). **Relievi** është kodrinoro malor me prezencë të fushëgropave që përshkohen nga rrjeti lumor. Fushëgropat më të mëdha janë: e Pellagonisë, e Pollogut, e Shkupit, e Prespës, dhe e Dibrës. **Klima**, është kontinentale. **Hidrografia**, përfaqësohet nga lumenj dhe liqene. **Bimësia** është e pasur dhe e shumëllojshme.

Shifrat zyrtare të regjistrimit të popullsisë në vitin 2002, publikojnë se në Republikën e Maqedonisë jetojnë 509.083 shqiptarë që përbëjnë 25, 17% të popullsisë së përgjithshme. Përqëndrimin më të madh, popullsia shqiptare e ka në pjesën veriore dhe veriperëndimore të këtyre trevave.

Trevat shqiptare jashtë kufirit (vazhdim)

Trevat shqiptare jashtë kufirit

Trevat shqiptare në Mal të Zi

Në përbërje të trevave shqiptare në Mal të Zi hyjnë Ulqini, Tivari, Tuzi, Plava, Guçica, Rozhaja, Hoti, Gruda, Kraja, Anamali dhe Shpuza. U shkëputën nga trangu etnogeografik shqiptar dhe u përfshinë në përbërje të Malit të Zi në vitin 1913, nga vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër. Ato shtrihen në veriperëndim dhe në veri të RSH. Në perëndim trevat kanë dalje në Detin Adriatik. Hapësira nga Ulqini deri në Bjeshkët e Namuna, është e populluar në vazhdimësi nga popullsi autoktone shqiptare, ndërsa trevat e Plavës dhe të Rozhajës janë të rrethuara nga vendbanime të populluara nga joshqiptarë. Përveç pjesës bregdetare të Ulqinit dhe të Tivarit, pjesa më e madhe e këtyre trevave është kryesisht malore. **Ndërtim gjeologjik:** trualli përbëhet nga shkëmbinj gëlqerorë të mesozoikut. **Relievi** është kryesisht malor, por janë të pranishme edhe disa fusha të vogla (në pjesën jugore e juglindore të komunës së Ulqinit dhe në një sipërfaqe të gjerë në zonën e Tuzit). **Klima** që mbizotëron në këto treva është mesatare mesdhetare në pjesët bregdetare dhe mesdhetare malore në komunat që ndodhen mbi kufirin verior të RSH. **Hidrografia**, përfaqësohet me Liqenin tektoniko karstik të Shkodrës dhe liqenin akullnajor të Plavës. Lumenjtë e këtyre trevave janë të shkurtër dhe malorë. **Bimësia** është e tipit mesdhetar. Në trevat shqiptare në Mal të Zi, shqiptarët përbëjnë 7.09% të popullsisë së përgjithshme të kësaj republike. Rreth gjysma e gjithë popullsisë shqiptare të trevave tona në Mal të Zi, jeton në komunën e Ulqinit. Një ndikim shumë të madh në strukturën dhe dinamikën e popullsisë shqiptare në Mal të Zi, ka emigrimi i popullsisë.

Trevat shqiptare në Greqi

Në përbërje të trevave shqiptare në Greqi hyjnë Çamëria, Follorina, Kosturi dhe Grebenea. Ato shtrihen në pjesën veriperëndimore të Greqisë së sotme dhe kanë dalje të gjerë në detin Jon, gjë që i bën ato të dallohen për pozitë të favorshme gjeografike. Sipas ndarjes së sotme administrative të Greqisë, pjesa më e madhe e tokave shqiptare, krahina e Çamërisë përfshihet në rajonin e Epirit. Ai përbëhet nga katër prefektura: e Thesprotisë, e Prevezës, e Artës dhe e Janinës. Prefektura e Follorinës, Kosturit dhe Grebenesë janë pjesë e rajonit të Maqedonisë Perëndimore. Kanë një **ndërtim gjeologjik** të përbërë nga shkëmbinj gëlqerorë dhe trualli i tyre preket vazhdimisht nga aktiviteti sizmik. **Relievi** është kodrinoro-malor dhe lartësohet më tepër në lindje të trevave. **Klima**, në pjesët perëndimore është tipike mesdhetare, sepse ndikohet ndjeshëm nga masat ajrore që vijnë nga Mesdheu. **Hidrografia**, përbëhet nga lumenj të shkurtër, me regjim mesdhetar të prurjeve dhe me karakter malor, sidomos në rrjedhjet e tyre të sipërme. **Tokat** më të përhapura janë tokat e hirta kafe, të murrme pyjore dhe livadhore malore. **Bimësia**, është tipike mesdhetare. **Bota shtazore**, është e e tipit mesdhetar, me specie të shumëllojshme. Dendësia mesatare e popullsisë shqiptare në këto treva është 31 banorë/km². Për dendësi më të madhe, dallohet krahina e Çamërisë me 40 banorë/km². Bujqësia dallohet për kultivimin e ullinjve, agrumeve, vreshtave e drithërave. **Blegtoria** dallohet për mbarështimin e bagëtisë së imët. **Industria** përfaqësohet me disa njësi përpunuese të prodhimeve blegtorale e bujqësore. **Turizmi** dhe shërbimet janë të favorizuar nga bukuritë natyrore bregdetare dhe nga trashëgimia e pasur kulturore e historike. **Artizanati**, dallohet për prodhimin e produkteve artizanale të leshit dhe të lëkurës. **Transporti**, përfaqësohet me atë rrugor dhe detar.

IV. PËRSËRITJE

Përsëritja

Përsëritja sistematike dhe periodike është e domosdoshme për përvetësimin e lëndës, pasi përmes tyre sistemohen njohuritë e marra gjatë kapitullit. Por shpesh, tërësia e njohurive dhe e koncepteve të kapitullit, nuk arrin të përsëritet brenda një ore mësimore. Kështu, për të realizuar sa më mirë objektivat e vëna për kapitullin përkatës, mund të aplikojmë edhe një përsëritje në formë konsultimi. Për këtë, mund të orientojmë nxënësit që të përgatitisin që më parë në fletoren e tyre:

1. evidentimin e koncepteve dhe të njohurive më të rëndësishme;
2. hartimin e strukturës së kapitullit (lidhjet ndërmjet koncepteve dhe lidhjet shkak-pasojë);
3. krijimin e lidhjeve midis njohurive të marra më parë me ato të kapitullit që duhet të përsëritet.

Kjo punë e bërë nga nxënësit diskutohet në klasë, duke realizuar ndërkohë edhe këmbim eksperiencash dhe idesh midis tyre.

Përsëritje 1

Tema: Hapësira gjeografike e trevave shqiptare dhe kushtet natyrore të tyre

Çështjet rreth të cilave do të zhvillohet përsëritja:

1. Analizo pozitën gjeografike të trevave shqiptare dhe vlerësoni rëndësinë e saj.
2. Cila është përbërja territoriale e trevave shqiptare?
3. Pse ka pësuar vazhdimisht ndryshime harta politike e trevave shqiptare?
4. Analizo ndryshimet që pësoi harta politike e trevave shqiptare gjatë periudhës: a. Ilire; b. Romake; c. Bizantine; d. Osmane; e. Pas vitit 1913;
5. Cila është harta e sotme politike e trevave shqiptare?
6. Cila është perspektiva e trevave shqiptare, kur RSH dhe vendet në të cilat janë përfshirë trevat shqiptare të jenë pjesë e BE? Mbro përgjigjen me argumenta.
7. Analizo pozicionin gjeologjik të trevave shqiptare dhe vlerësoni rëndësinë e tij .
8. Evidento etapat kryesore të formimit të Albanideve.
9. Identifiko llojet e shkëmbinjve që përbëjnë truallin shqiptar.
10. Listo zonat që përbëjnë sektorin e brendshëm dhe të jashtëm të Albanideve.
11. Pse janë të larmishme strukturat tektonike të trevave shqiptare? Argumentoni përgjigjen.
12. Analizo shpërndarjen e rezervave të: a. lëndëve djegëse; b. mineraleve metolorë; c. mineraleve jometolorë në trevat shqiptare.
13. Cila është natyra e relievit të trevave shqiptare?
14. Analizo se si kanë ndikuar faktorët në formimin e relievit të trevave shqiptare.
15. Si ndikon relievit mbi dukuritë e tjera natyrore dhe mbi popullimin e natyrën e ekonomisë së trevave shqiptare?
16. Si ndahet relievi sipas lartësisë mbi nivelin e detit?

17. Cilat janë veçoritë dalluese të relievit të trevave shqiptare?
18. Analizo veçoritë e sistemeve kryesore (malet, kodrat, fushat, fushëgropat, lugjet, dhe luginat) të trevave shqiptare.
19. Çfarë tipare e karakterizojnë klimën e trevave shqiptare?
20. Analizo ndikimin e tërësisë së faktorëve që ndikojnë në formimin e klimës së trevave shqiptare.
21. Cilët janë elementët e klimës së trevave shqiptare?
22. Përcakto tipet e klimave që karakterizojnë trevat shqiptare.
23. Cilët tregues e bëjnë të dallueshme ndarjen e klimës në disa tipe?
24. Krahaso midis tyre tipet e klimave që karakterizojnë trevat shqiptare (a. mesatare mesdhetare; b. mesatare kontinentale; c. malore) dhe evidento ndryshimet që kanë ato midis tyre.
25. Evidento disa veçori të përgjithshme të hidrografisë së trevave shqiptare.
26. Analizo veçoritë dalluese të deteve që lagin trevat shqiptare.
27. Analizo veçoritë dalluese të liqeneve të trevave shqiptare.
28. Listo disa veçori të përgjithshme të lumenjve që përshkojnë trevat shqiptare.
29. Analizo veçoritë dalluese të lumenjve që derdhen në: Detin Adriatik; Detin Jon; Detin Egje; Detin e Zi.
30. Cilët janë faktorët që ndikojnë në pasuritë e mëdha nëntokësore e burimet në trevat shqiptare?
31. Si ndahen ujërat nëntokësorë të trevave shqiptare?
32. Krahaso midis tyre, ujërat nëntokësorë të trevave shqiptare dhe përcakto të përbashkëtat dhe dallimet midis tyre.
33. Analizo faktorët që ndikojnë mbi larminë e tokave në truallin e trevave shqiptare.
34. Evidento veçoritë e tokave zonale që formohen në truallin e trevave shqiptare.
35. Evidento veçoritë e tokave jozonale që formohen në truallin e trevave shqiptare.
36. Analizo se si ndikojnë faktorët natyror dhe human në shkallën e lartë të degradimit e të shkretirizimit të tokave në trevat shqiptare.
37. Cilët janë faktorët që ndikojnë mbi larminë e botës së gjallë në hapësirën e trevave shqiptare?
38. Analizo veçoritë dalluese të brezave të bimësisë në trevat shqiptare.
39. Analizo larminë e botës shtazore në mjedise të ndryshme të trevave shqiptare

Përsëritje 2

Tema: Sistemet humane dhe ndërveprimi shoqëri-mjedis

Çështjet rreth të cilave do të zhvillohet përsëritja:

1. Analizo mënyrën e organizimit administrativ të trevave shqiptare duke evidentuar ndryshimet që vihen re, në periudha të ndryshme historike të tyre.
2. Cili ka qënë roli i faktorëve të ndryshëm që kanë ndikuar në organizimin administrativ të trevave shqiptare gjatë periudhave të ndryshme historike?
3. Si ka evoluuar numri i popullsisë në trevat shqiptare?
4. Çfarë dinamike ka popullimi në trevat shqiptare?
5. Analizo shpërndarjen e popullsisë në trevat shqiptare

6. Analizo strukturën e popullsisë së trevave shqiptare.
7. Cilët faktorë kanë ndikuar mbi dukurinë e migrimeve në popullsinë e trevave shqiptare?
8. Evidento dinamikën e migracionit të brendshëm të shqiptarëve.
9. Evidento dinamikën e migracionit të jashtëm të shqiptarëve.
10. Analizo pasojat e emigracionit të qytetarëve të RSH, në periudhën pas vitit '90.
11. Si kanë evoluuar tipet e vendbanimeve në trevat shqiptare gjatë shekujve?
12. Analizo tipet e qyteteve dhe të fshatrave në hapësirën e trevave shqiptare.
13. Çfarë potenciale natyrore ofrohen në favor të zhvillimit ekonomik të trevave?
14. Si ndikon potenciali human në zhvillimin ekonomik të trevave?
15. Si ndikojnë faktorët historiko-shoqërorë në zhvillimin ekonomik të trevave?
16. Analizo zhvillimin e secilit prej sektorëve të ekonomisë së trevave shqiptare.
17. Ç'është trashëgimia natyrore?
18. Ç'janë zonat e mbrojtura dhe si klasifikohen ato?
19. Analizo kategoritë e zonave të mbrojtura në trevat shqiptare.
20. Ç'është trashëgimia kulturore dhe në çfarë trajtash paraqitet ajo në trevat shqiptare?
21. Evidento disa site shqiptare që janë pjesë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore botërore.
22. Vlerëso rëndësinë e pasurisë kulturore të trevave shqiptare për zhvillimin turistik të tyre.
23. Analizo gjendjen aktuale të ujërave, të tokës dhe të ajrit në hapësirën shqiptare.

Përsëritje 3

Tema: Republika e Shqipërisë

Çështjet rreth të cilave do të zhvillohet përsëritja:

1. Analizo rëndësinë e pozitës gjeografike të Republikës së Shqipërisë.
2. Evidento kushtet natyrore të Republikës së Shqipërisë.
3. Listo rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë.
4. Cila është origjina e popullsisë së Republikës së Shqipërisë?
5. Evidento numrin e popullsisë në Republikën e Shqipërisë.
6. Analizo shpërndarjen gjeografike të popullsisë së Republikës së Shqipërisë.
7. Analizo strukturën e popullsisë së Republikës së Shqipërisë.
8. Cilat janë veçoritë kryesore të ekonomisë së Shqipërisë: a. deri në Përfundim të Luftës së Dytë Botërore; b. gjatë periudhës 1945-1990; c. gjatë periudhës post-komuniste.
9. Analizo zhvillimin aktual të ekonomisë së Republikës së Shqipërisë, duke evidentuar peshën që zë secila prej degëve të saj.
10. Cila është pozita gjeografike e Alpeve Shqiptare?
11. Analizo kushtet natyrore të Alpeve Shqiptare.
12. Përcakto njësitë kryesore përbërëse të Alpeve dhe evidento të përbashkëtat dhe ndryshimet midis tyre.

13. Cilat janë veçoritë e popullimit e të vendbanimeve në Alpet Shqiptare?
14. Cila është natyra e zhvillimit ekonomik të këtij nënrajonit?
15. Evidento veçantinë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Alpeve Shqiptare dhe vlerëso resurset që ofrojnë këto treva për zhvillimin ekonomik të tyre.
16. Cila është pozita gjeografike e rajonit verilindor dhe ku qëndron rëndësia e saj?
17. Evidento mozaikun natyror të Rajonit Verilindor dhe vlerëso ofertat potenciale natyrore që ofron për zhvillim.
18. Si paraqitet dinamika e popullimit të Rajonit Verilindor?
19. Analizo veçoritë natyrore dhe kushtet e popullimit të: Malësisë së Gjakovës dhe të Hasit; Vargut të Korabit; Luginës së Drinit të Zi; Vargjeve të Lurës; Malësisë Pukë-Mirditë; Pellgut Klos-Kalivaç, Vargjeve të Skënderbeut dhe Malësive Martanesh, Çermenikë, Gollobordë.
20. Krahaso midis tyre tri malësitë: Martanesh, Çermenikë e Gollobordë dhe përcakto të përbashkëtat e dallimet midis tyre.
21. Në çfarë raporti qëndrojnë midis tyre kushtet natyrore dhe zhvillimi ekonomik i rajonit verilindor?
22. Cila është pozita gjeografike e Rajonit Juglindor dhe ku qëndron rëndësia e saj?
23. Evidento kushtet natyrore të rajonit Juglindor.
24. Analizo veçoritë e secilës nënnjësi përbërëse të Rajonit Juglindor.
25. Cili është historiku i popullimit të Rajonit Juglindor dhe si paraqitet shpërndarja gjeografike e popullsisë në të?
26. Analizo dinamikën e popullsisë së Rajonit Juglindor, duke u mbështetur në faktorët që kanë ndikuar në të.
27. Analizo strukturën e popullsisë në Rajonin Juglindor.
28. Çfarë natyre kanë vendbanimet e këtij rajoni?
29. Analizo mundësitë që i ofrohen zhvillimit ekonomik të Rajonit Juglindor dhe natyrën e zhvillimit ekonomik të tij.
30. Cila është pozita gjeografike e Rajonit Jugor dhe ku qëndron rëndësia e pozitës gjeografike të rajonit jugor?
31. Analizo kushtet natyrore të Rajonit Jugor.
32. Evidento njësitë përbërëse të Rajonit Jugor dhe përcakto të veçantat për secilin prej tyre.
33. Cilat janë veçoritë e popullimit të Rajonit Jugor dhe si paraqitet shpërndarja gjeografike e popullsisë në të?
34. Analizo strukturën e popullsisë së rajonit dhe evidento veçantitë që ai paraqet.
35. Çfarë karakteristika kanë vendbanimet në Rajonin Jugor?
36. Çfarë resurse ofrohen në favor të zhvillimit ekonomik të Rajonit Jugor?
37. Analizo degët e ekonomisë së rajonit dhe përcakto peshën e secilës prej tyre duke e parë të lidhur me perspektivat e mundshme të zhvillimit ekonomik të tij.
38. Cili është pozicionin gjeografik i Rajonit Perëndimor dhe ku qëndron rëndësia e pozicionit gjeografik të tij?
39. Evidento popullimin e hershëm të Rajonit Perëndimor dhe shpërndarjen gjeografike të popullsisë në këtë rajon.
40. Çfarë karakteristika kanë vendbanimet e Rajonit Perëndimor?

41. Analizo strukturën e popullsisë së Rajonit Perëndimor dhe argumento ndryshimet që ai paraqet krahasuar me rajonet e tjera të Republikës së Shqipërisë.
42. Çfarë resurse ofrohen në favor të zhvillimit ekonomik të Rajonit Perëndimor?
43. Analizo degët e ekonomisë së Rajonit Perëndimor dhe krahaso natyrën e zhvillimit ekonomik të tij me rajonet e tjera të vendit.

Përsëritje 4

Tema: Republika e Kosovës dhe trevat e tjera jashtë kufirit të Republikës së Shqipërisë

Çështjet rreth të cilave do të zhvillohet përsëritja:

1. Pse pozita gjeografike e Republikës së Kosovës është e favorshme?
2. Çfarë veçori fiziko-gjeografike ka Republika e Kosovës?
3. Analizo veçoritë e popullimit në Republikën e Kosovës, gjatë periudhave të ndryshme historike.
4. Cila është dinamika e popullsisë në Republikën e Kosovës?
5. Si është shpërndarë popullsia në Republikën e Kosovës?
6. Analizo strukturën e popullsisë sipas: përbërjes etnike, moshore, gjinore dhe sipas vendbanimeve.
7. Evidento veçoritë e zhvillimit të ekonomisë së Republikës së Kosovës.
8. Çfarë zhvillimi ka ekonomia bujqësore në Republikën e Kosovës?
9. Analizo nivelin e zhvillimit të sektorit industrial, sipas nëndegëve të tij.
10. Evidento peshën që zë turizmi, tregëtia dhe transporti në Republikën e Kosovës.
11. Diferenco nga pikëpamja rajonale Republikën e Kosovës dhe përcakto se nga çfarë elementësh dallojnë dy rajonet e saj.
12. Analizo tiparet fiziko-gjeografike, natyrën e popullimit dhe të ekonomisë së rajonit Perëndimor të Kosovës.
13. Analizo veçoritë fiziko-gjeografike, natyrën e popullimit dhe të ekonomisë së Rajonit Lindor të Kosovës.
14. Përcakto pozitën gjeografike dhe statusin politik të trevave shqiptare në Serbi.
15. Analizo veçoritë natyrore të trevave shqiptare në Serbi, të popullimit dhe të ekonomisë së tyre.
16. Përcakto pozitën gjeografike dhe përbërjen e trevave shqiptare në perëndim të Republikës së Maqedonisë.
17. Për çfarë kushte natyrore dallohen trevat shqiptare në perëndim të Republikës së Maqedonisë?
18. Si paraqitet popullimi dhe ekonomia në trevat shqiptare në perëndim të Republikës së Maqedonisë?
19. Çfarë pozicioni gjeografik dhe përbërje territoriale, kanë trevat shqiptare në Mal të Zi?
20. Për çfarë kushte natyrore dhe popullimi dallohen trevat shqiptare në Mal të Zi?
21. Çfarë pozicioni gjeografik kanë trevat shqiptare në Greqi?
22. Analizo veçoritë fiziko-gjeografike, kushtet natyrore dhe natyrën e popullimit të trevave shqiptare në Greqi.

V. Disa modele pyetjesh që mund të përdoren gjatë minitesteve ose në testimet e kapitujve

1. Pozita gjeografike e trevave shqiptare **ka rëndësi:**

_____ : sepse _____
_____ : sepse _____
_____ : sepse _____

2. **Argumento**, pse trevat shqiptare vlerësohen si “*porta e Ballkanit*”. _____

3. Ilirët shtriheshin që nga _____ në veri deri tek _____
në jug dhe që nga _____ në lindje deri në _____
në perëndim.

4. Iliria e Jugut u nda në katër provinca në periudhën:

1. e paleolitit të vonë
2. mesjetës së vonë
3. e vonë antike
4. e rilindjes

5. Në shek IX, territoret shqiptare u organizuan mbi bazë

1. themash
2. provincash
3. principatash
4. sanxhakësh

6. Në shek XV, trevat shqiptare u ndanë mbi bazë:

1. themash
2. provincash
3. principatash
4. sanxhakësh

7. Konferenca e Ambasadorëve në Londër, përcaktoi:

1. Kosovën si shtet të pavarur
2. Shqipërinë si shtet të pavarur
3. kufijtë etnikë të trevave shqiptare
4. kufijtë politikë të trevave shqiptare

8. Argumento:

a. Si paraqitet statusi i sotëm politik i trevave shqiptare jashtë kufirit politik të RSH?

b. A ka lidhje midis pozitës gjeografike dhe ndryshimeve që ka pësuar vazhdimisht harta politike e trevave shqiptare? _____

c. Pse është një shans për zgjidhjen e pengesave kufitare të popullsisë së trevave shqiptare përfshirja e trevave shqiptare si pjesë e Komunitetit Evropian? _____

9. Trualli shqiptar i përket teknogjenezës _____ dhe përbëhet nga struktura gjeologjike që quhen _____.

10. Albanidet, bëjnë pjesë në degëzimin:

1. verior mesdhetar të sistemit të rrudhosur alpin.
2. jugor mesdhetar të sistemit të rrudhosur alpin.
3. lindor mesdhetar të sistemit të rrudhosur alpin.
4. përëndimor mesdhetar të sistemit të rrudhosur alpin.

11. **Argumento** lidhjen midis drejtimit të evolucionit gjeologjik të Albanideve dhe moshës e llojit të shkëmbinjve që mbizotërojnë në sektorët e tyre.

12. **Listo** zona gjeotektonike që hyjnë në përbërje të sektorit të brendshëm të albanideve:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

13. **Listo** zona gjeotektonike që hyjnë në përbërje të sektorit të jashtëm të albanideve:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

14. Plotëso mendimin: Strukturat e Albanideve u krijuan gjatë ____ etapave kryesore: gjatë etapës _____ dhe gjatë etapës _____.

Gjatë etapës _____ u krijuan: _____

Gjatë etapës _____ u krijuan: _____

15. Përcakto: Pse trevat shqiptare dallohen për rezerva të mëdha të pasurive minerare? _____

16. Argumento: Pse pasuritë minerare përbëjnë një bazë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të trevave shqiptare? _____

17. a. Cilat janë tipat e relievit të trevave shqiptare? _____

b. Çfarë veçori ka secili prej tyre? _____

18. Përcakto: Cila është natyra e klimës së trevave shqiptare?

_____ Pse është e tillë? (cilët faktorë ndikojnë që ajo të jetë e tillë?) _____

19. Cilët janë faktorët që ndikojnë në hidrografinë e pasur të trevave shqiptare?

20. Krahaso midis tyre detet që lagin trevat shqiptare dhe evidento të përbashkëtat dhe dallimet.

21. Krahaso midis tyre liqenit tektonikë të trevave shqiptare dhe evidentit të përbashkët dhe dallimet.

22. Në tabelën e mëposhtme:

- gruponi lumenjtë sipas deteve në të cilët derdhen
- gruponi lumenjtë sipas gjatësisë së tyre
- vendosni disa veçori dalluese të tyre

Lumenjtë sipas deteve në të cilët derdhen	Lumenjtë sipas gjatësisë së tyre	Disa veçori dalluese të lumenjve

23. Argumento: Pse trevat shqiptare dallohen për larmi të botës bimore dhe shtazore? _____

24. Vendos, në tabelën e mëposhtme:

- a. mënyrën e organizimit administrativ të trevave shqiptare në periudha të ndryshme historike;
- b. faktorët që kanë ndikuar në format e ndryshme të organizimit administrativ të trevave shqiptare.

Organizimi administrativ i trevave shqiptare në periudhën e fiseve ilire:		Faktorët e ndryshëm që kanë ndikuar në organizimin administrativ të trevave shqiptare gjatë periudhave të ndryshme historike:
Organizimi administrativ i trevave shqiptare gjatë pushtimit romak:		
Organizimi administrativ i trevave shqiptare gjatë pushtimit bizantin:		
Organizimi administrativ i trevave shqiptare gjatë pushtimit osman:		
Organizimi administrativ i trevave shqiptare pas 1913-s:		

25. Cilët faktorë kanë ndikuar në shtrirjen gjeografike dhe numrin e popullsisë në trevat shqiptare gjatë periudhave të ndryshme historike: _____

26. Analizo: a. shpërndarjen gjeografike të popullsisë në hapësirën e trevave shqiptare:

b. strukturën e popullsisë shqiptare sipas:
Moshës _____

Gjinisë _____

Përbërjes kombëtare _____

Besimit fetar _____

27. Përcakto veçoritë e migrimit të popullsisë së trevave shqiptare:

a. Migrimi i brendshëm: _____

b. Migrimi i jashtëm: _____

28. Cilët janë: a. faktorët që kanë ndikuar në migrimin e brendshëm e të jashtëm të popullsisë së trevave shqiptare: _____

b. A ka ndikuar migrimi i jashtëm e i brendshëm në popullimin e trevave shqiptare?: _____

29. Argumento: Si kanë evoluar tipet e vendbanimeve në trevat shqiptare gjatë shekujve?

30. Klasifiko: a. vendbanimet urbane të trevave shqiptare: _____

b. vendbanimet rurale të trevave shqiptare: _____

31. Vlerëso: a. burimet natyrore që janë në favor të zhvillimit ekonomik të trevave shqiptare: _____

b.rolin e faktorëve historiko-shoqëror në zhvillimin ekonomik të trevave shqiptare:

32. Si paraqitet zhvillimi i ekonomisë në trevat shqiptare? _____

33. Listo dhe analizo degët përbërëse të ekonomisë bujqësore: _____

34. Listo dhe analizo degët kryesore përbërëse të industrisë së trevave shqiptare:

35. Listo dhe analizo degët që përbëjnë sektorin e tretë të ekonomisë së trevave shqiptare:

36. Argumento: Pse turizmi është tepër i favorizuar në zhvillim? _____

37. Përcakto: a. Kuptimin e konceptit trashëgimi natyrore të trevave shqiptare:

b. Kuptimin e konceptit trashëgimi kulturore të trevave shqiptare: _____

c. Kuptimin e **zonës së mbrojtur**: _____

38. Listo kategoritë e zonave të mbrojtura të përcaktuara nga IUCN dhe jep një disa përfaqësues për secilën kategori:

• _____ janë _____
Të tilla janë: _____

• _____ janë _____
Të tilla janë: _____

• _____ janë _____
Të tilla janë: _____

• _____ janë _____
Të tilla janë: _____

• _____ janë _____
Të tilla janë: _____

• _____ janë _____
Të tilla janë: _____

39. Plotëso: a. Koordinatat gjeografike të Republikës së Shqipërisë: _____

b. Sipërfaqen e RSH: _____, gjatësinë (në vijë ajrore) veri-jug: _____, gjatësinë (në vijë ajrore) perëndim-lindje _____.

c. Gjatësinë e përgjithshme të kufijve të Shqipërisë: _____

40. Vlerëso pozitën gjeografike të RSH: _____

41. Evidento kushtet natyrore të Republikës së Shqipërisë: _____

42. Përcakto: rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë: _____

43. Analizo: a. ecurinë e numrit të popullsisë në RSH: _____

- b. Strukturën sipas moshës: _____
- c. Struktura sipas gjinisë: _____
- d. Struktura sipas përbërjes kombëtare: _____
- e. Struktura sipas vendbanimeve: _____
- f. Struktura sipas besimit fetar: _____

44. Evidento: disa veçori të zhvillimit ekonomik të Republikës së Shqipërisë: _____

45. a. Përcakto: pozicionin gjeografik të Alpeve Shqiptare: _____

b. Pse Alpet Shqiptare janë reliev i kontrasteve të mëdha? _____

46. Çfarë veçori dalluese kanë Alpet Shqiptare: a. në klimë _____

b. në hidrografi _____

c. në toka _____

d. në botëbimore dhe shtazore _____

e. në përbërje gjeologjike _____

47. Përcakto: a. natyrën e popullimi në Alpet Shqiptare _____

b. veçoritë e vendbanimeve të Alpeve Shqiptare: _____

c. natyrën e ekonomisë së Alpeve Shqiptare _____

48. Vlerëso pozitën gjeografike të Rajonit Verilindor _____

49. Analizo: kushtet natyrore të Rajonit Verilindor: a. ndërtimi gjeologjik _____

b. relievi _____

c. hidrografia _____

e. bimësia _____

50. Listo njësitë përbërëse të Rajonit Verilindor: _____

51. Përcakto: a. Natyrën e popullimit të Rajonit Verilindor: _____

b. natyrën e zhvillimit ekonomik të Rajonit Verilindor: _____

52. Vlerëso pozitën gjeografike të Rajonit Juglindor _____

53. Analizo: kushtet natyrore të Rajonit Juglindor: **a.** ndërtimi gjeologjik _____

b. relievi _____

c. hidrografia _____

e. bimësia _____

54. Listo njësitë përbërëse të Rajonit Juglindor: _____

55. Përcakto: **a.** Natyrën e popullimit të Rajonit Juglindor: _____

b. natyrën e zhvillimit ekonomik të Rajonit Juglindor: _____

56. Vlerëso pozitën gjeografike të Rajonit Jugor _____

57. Analizo: kushtet natyrore të Rajonit Jugor: **a.** ndërtimi gjeologjik _____

b. relievi _____

c. hidrografia _____

e. bimësia _____

58. Listo njësitë përbërëse të Rajonit Jugor: _____

59. Përcakto: a. Natyrën e popullimit të Rajonit Jugor: _____

b. natyrën e zhvillimit ekonomik të Rajonit Jugor: _____

60. Vlerëso pozitën gjeografike të Rajonit Perëndimor _____

61. Analizo: kushtet natyrore të Rajonit Perëndimor: **a.** ndërtimi gjeologjik _____

b. relievi _____

c. hidrografia _____

e. bimësia _____

62. Listo njësitë përbërëset të Rajonit Perëndimor: _____

63. Përcakto: a. Natyrën e popullimit të Rajonit Perëndimor: _____

b. natyrën e zhvillimit ekonomik të Rajonit Perëndimor: _____

64. Përcakto: pozitën gjeografike të Republikës së Kosovës: _____

65. Vlerëso: pozitën gjeografike të Republikës së Kosovës: _____

66. Analizo: kushtet natyrore të Republikës së Kosovës. **a.** përbërja gjeologjike: _____

b. relievi: _____

c. klima: _____

d. hidrografia: _____

e. bimësia: _____

f. bota shtazore: _____

67. Evidento: rajonet gjeografike të Republikës së Kosovës dhe vendos përbri njësitë përbërëse të tyre :

Rajoni _____ përbëhet nga: _____

Rajoni _____ përbëhet nga: _____

68. Vlerëso: kushtet natyrore që ofrojnë rajonet gjeografike të Republikës së Kosovës:

Rajoni

perëndimor: _____

Rajoni Lindor: _____

69. Analizo: a. ecurinë e numrit të popullsisë shqiptare në Republikën e Kosovës:

b. faktorët që ndikuar në ecurinë e numrit të popullsisë: _____

c. strukturën e popullsisë sipas moshës: _____

d. strukturën sipas gjinisë: _____

e. strukturën sipas vendbanimit: _____

f. strukturën sipas përbërjes kombëtare: _____

70. Përcakto: natyrën e zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës. _____

71. Evidento: fizionominë (natyra e ekonomisë, popullimit dhe e vendbanimeve) që ka Rajoni Perëndimor i Republikës së Kosovës në pjesët e ulëta të tij. **Listo** qendrat kryesore të këtij rajoni: _____

72. Evidento: fizionominë (natyra e ekonomisë, popullimit dhe e vendbanimeve) që ka Rajoni Perëndimor i Republikës së Kosovës në pjesët kodrinore-malore të tij. _____

73. Evidento: fizionominë (natyra e ekonomisë, popullimit dhe e vendbanimeve) që ka Rajoni Lindor i Republikës së Kosovës në zonën fushore. **Listo** qendrat kryesore. _____

74. Evidento: fizionominë (natyra e ekonomisë, popullimit dhe e vendbanimeve) që ka Rajoni Lindor i Republikës së Kosovës në pjesët kodrinore dhe malore. **Listo** qendrat kryesore. _____

75. Përcakto: a. Pozicionin gjeografik të trevave shqiptare në Serbinë Jugore. _____

b. Statusin politik të tyre. _____

76. Vlerëso: pozicionin gjeografik të trevave shqiptare në Serbinë Jugore: _____

77. Evidento: kushtet natyrore të trevave shqiptare në Serbinë Jugore. **a.** relievi: _____

b. klima: _____

c. hidrografia: _____

78. Analizo fizionominë (natyra e ekonomisë, popullimit dhe e vendbanimeve) që kanë trevat shqiptare në Serbinë Jugore: _____

79. Përcakto: a. Pozicionin gjeografik të trevave shqiptare në perëndim të Republikës së Maqedonsë _____

b. Statusin politik të tyre. _____

80. Vlerëso: pozicionin gjeografik të trevave shqiptare në perëndim të Republikës së Maqedonsë _____

81. Evidento: kushtet natyrore të trevave shqiptare në perëndim të Republikës së Maqedonsë. _____

a. relivi: vi: _____

b. klima: _____

c. hidrografia: _____

82. Analizo fizionominë (natyra e ekonomisë, popullimit dhe e vendbanimeve) që kanë trevat shqiptare në perëndim të Republikës së Maqedonsë _____

83. Përcakto: a. Pozicionin gjeografik të trevave shqiptare në Mal të Zi. _____

b. Statusin politik të tyre. _____

84. Vlerëso: pozicionin gjeografik të trevave shqiptare në Mal të Zi: _____

85. Evidento: kushtet natyrore të trevave shqiptare në Mal të Zi. **a. relievi:** _____

b. klima: _____

c. hidrografia: _____

86. Analizo fizionominë (natyra e ekonomisë, popullimit dhe e vendbanimeve) që kanë trevat shqiptare në Mal të Zi: _____

87. Përcakto: a. Pozicionin gjeografik të trevave shqiptare në Greqi. _____

b. Statusin politik të tyre. _____

88. Vlerëso: pozicionin gjeografik të trevave shqiptare në Greqi: _____

89. Evidento: kushtet natyrore të trevave shqiptare në Greqi. a. relievi: _____

b. klima: _____

c. hidrografia: _____

90. Analizo fizionominë (natyra e ekonomisë, popullimit dhe e vendbanimeve) që kanë trevat shqiptare në Greqi: _____
